REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI ALEKSANDER MOISIU
FAKULTETI I BIZNESIT
DEPARTAMENTI I TURIZMIT

Nr.234 prot

Durrës, më 23 /03 /2023

**Lënda : Raport i Vlerësimit të brendshëm për programin e ciklit të dytë të studimit Master Profesional Guidë Turistike Shqiptare**

**Drejtuar:** **DEKANIT TË FAKULTETIT TË BIZNESIT**
**PROF. DR. SHKËLQIM FORTUZI**

*I nderuar Z. Dekan,*

Në kuadër të procesit të akreditimittë programeve të studimit , Grupi i vlerësimit të brendshëm në programin e studimit Master Profesional Guidë Turistike Shqiptare, ju përcjellim raportin e vlerësimit të brendshëm dhe evidencat mbështetëse për këtë program studimi.

Duke ju falenderuar,

Grupi i Vlerësimit të Brendshëm:

1. Arlind Kasa — Koordinator i programit te studimit
2. Gentian Ruspi — Staf Akademik me kohë të plotë
3. Dorina Xheraj — Staf Akademik me kohë të plotë
4. Violeta Aliaj — Staf Akademik me kohë të plotë
5. Arjana Isaku — Studente e Programit
6. Spiro Paco — Koordinator Institucional I IAL-së për ASCAL
7. Marsida Dyrmishi — Specialist DKSC

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU", DURRËS**

**FAKULTETI I BIZNESIT**

# RAPORTI I VLERËSIMIT TË BRENDSHËM

Programi i Studimit të Ciklit të Dytë
Master Profesional "Guidë Turistike Shqiptare"
i Institucionit të Arsimit të Lartë "Aleksandër Moisiu"

Grupi i Vlerësimit të Brendshëm:

1. Dr. Arlind Kasa (kryetar)
2. Dr. Violeta Aliaj (anetare)
3. Dr. Gentian Ruspi (anetar)
4. Dr. Dorina Xheraj (anetare)
5. Arjana Isaku ( studente)
6. Marsida Dyrmyshi ( specialiste, Sektori Kurikules, Cilesise dhe Standardeve)
7. Spiro Paco (drejtor i Drejtorise se Kurikules, Cilësisë dhe Standardeve)

Shkurt 2023

# PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË BRENDSHËM

## Përshkrim përmbledhës

Universiteti "Aleksandër Moisiu" i themeluar në vitin 2005, është një institucion relativisht i ri i Arsimit të Lartë në vend, por njëkohësisht ndër më të rëndësishmit duke luajtur rol të vecantë në formimin e specialistëve dhe kërkuesve nga fushat e edukimit, ekonomisë, juridike, IT dhe specialistë profesionalë të formuar pranë Shkollës së Lartë Profesionale. Edukimi në nivel të lartë cilësor dhe transmetimi i dijeve është jo vetëm përgjegjësi e institucionit, por njëkohësisht përgjegjësi morale e qytetare përballë formimit të profesionistëve të së ardhmes, komunitetit e mbarë shoqërisë.

Departamenti i Turizmit, si një ndër njësitë bazë të Fakultetit të Biznesit ofron një program studimi të ciklit Bachelor Manaxhim Turizëm sipas profileve Manaxhim Turizëm Arkeologjik, Manaxhim Turizëm Kulturor dhe Manaxhim Hotel Restorant , një program të ciklit 2 vjecar " Guidë Turistike " dhe dy programe të ciklit të dytë Master Profesional "Guidë Turistike Shqiptare" dhe "menaxhim i Sipermarrjeve Turistike". Programi i ciklit të dytë të studimit Master Profesional "*Guidë Turistike Shqiptare*" i hapur gjatë vitit akademik 2018-2019 me Urdhër Nr. 653, të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Nr. 10580 Prot, datë 11.10.2018. Mbështetur në Ligjin 80/2015, ky program studimi është i përfshirë në proçesin e akreditimit, në përputhje me Standardet Shtetërore të Cilësisë dhe Kodin e Cilësisë në Arsimin e Lartë.

Vlerësimi i këtij programi studimi nga grupi i vlerësimit të brendshëm (GVB) është fokusuar në 6 fusha kryesore, si:

1. Ofrimi i programit të studimit dhe përputhshmëria e tij me interesat kombëtare, misionin dhe vizionin;
2. Mënyra e organizimit, drejtimit dhe administrimit të programit të studimit;
3. Në nivel të mësimdhënies e mësimnxënies, vlerësimit të studentëve dhe kompetencat e fituara prej tyre;
4. Mbështetja e programit të studimit me burimet e nevojshme njerëzore, financiare, infrastrukturore dhe logjistikën e nevojshme për realizimin e tij;
5. Politikat dhe proçedurat që ndiqen për mbështetjen e studentëve;
6. Sigurimi i cilësisë së programit të studimit

Nga analiza e kryer për vlerësimin e brendshëm të cilësisë, GVB konkludon që programi i ofruar në ciklin e dytë të studimit "*Guidë Turistike Shqiptare*", përmbush plotësisht (100%) standardet; në fushën e organizimit, drejtimit dhe administrimit përmbush plotësisht (100%) standardet; në mësimdhënie, mësimnxënie, vlerësimin dhe kompetencat përmbush plotësisht (100%); në burimet për realizimin e programit të studimit përmbush plotësisht (100%) standardet; në lidhje me studentët dhe mbështetjen e tyre përmbush plotësisht (100%); dhe në sigurimin e cilësisë së programit të studimit përmbush plotësisht (100%) standardet.

Në përfundim, nga analiza e kryer për vlerësimin e brendshëm të cilësisë, GVB konkludon që programi i ciklit të dytë të studimit Master Profesional "*Guidë Turistike Shqiptare*" ofruar nga Departamenti i Turizmit pranë FB, i përmbush plotësisht standardet për t'u akredituar.

## PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË BRENDSHËM:

Raporti i Vlerësimit të Brendshëm (RVB) për programin e ciklit të dytë të studimit Master Profesional "*Guidë Turistike Shqiptare*" është përgatitur nga grupi i vlerësimit të brendshëm (GVB), i ngritur me Vendim Dekanati, shkresa Nr.86 Prot, dt.7.02.2023, "Për ngritjen e grupeve të punës për akreditimin e programeve të studimit, Grupit të Vlerësimit të brendshëm", të Fakultetit Biznesit, në përputhje me dispozitat ligjore të MAS, ASCAL dhe Statutin e UAMD-së.

Përbërja e GVB është percaktuar mbi bazën e disa kritereve që lidhen me aftësitë dhe kompetencat profesionale të tyre në mësimdhënëse dhe kërkim shkencor, në integritetin dhe aftësitë e tyre për një analizë dhe vlerësim të paanshëm të dokumentacionit dhe informacionit të nevojshëm për kryerjen e proçesit të akreditimit. Në përbërjen e grupit është i përfshirë një studente në përputhje me kuadrin përkatës ligjor.

GVB për realizimin e procesit të vlerësimit të këtij programi studimi është bazuar në kërkesat ligjore të Ligjit Nr. 80/2015 "*Për arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë*", aktet ligjore e nënligjore përkatëse, udhëzimet dhe manuale të ASCAL-it, Statutin dhe Vendimet e Senatit Akademik të UAMD-së.

GVB në mbledhjen e informacionit, përpunimin e tij dhe hartimin e RVB, ka operuar duke ndarë ndërmjet anëtarëve të grupit të punës detyrat dhe përgjegjësitë duke synuar arritjen e përfundimeve objektive e reale në funksion të vlerësimit të cilësisë të këtij programi studimi.

GVB ka mbledhur dhe analizuar të dhëna dhe informacione të nevojshme në nivel institucioni, fakulteti dhe departamenti, për të realizuar procesin e vlerësimit të programit të studimit, të cilat në mënyrë përshkruese janë pasqyruar sipas rubrikave të fushave të përcaktuara në RVB dhe të dhënat mbështetëse, dokumentacioni bazë, të kërkuara për procesin e akreditimit të programit të studimit janë pasqyruar në formë Aneks-i bashkëlidhur, referuar modelit të hartuar nga ASCAL në përputhje me kërkesat ligjore për sigurimin e cilësisë në IAL-të. RVB i strukturuar në gjashtë fusha operacionale me standarde dhe kriteret përkatëse, mbi bazën e të cilave, referuar dhe në dokumentacionin mbështetës faktik, është bërë vlerësimi i përmbushjes të standardeve të cilësisë ndaj programit të ofruar.

**Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në "Guidë Turistike Shqiptare"**

## I. OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT

| **Standardi I.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. | **PO.** Universiteti dhe Fakulteti Biznesit si një ndër njësitë kryesore të tij, ofrojnë programe studimi në përputhje me kërkesat dhe nevojat e shoqërisë në ndryshim dhe zhvillim[1 2 3 4 5 6 7]. Programi i studimit Master Profesional GTSH që ofrohet nga institucioni respekton interesat kombëtare, gjë e cila shprehet në misionin dhe qëllimin e tij. Ky program, që synon të formojë ekspertë dhe specialistë të mirëfilltë në fushën e udhërrëfyesëve turistikë të pajisur me shprehitë dhe aftësitë e interpretimit të vlerave të trashëgimise natyrore krahas dhe ato kulturore e shpirtërore të vendit tonë,[8] nuk bie ndesh me interesat kombëtare por nxit pasurimin dhe promovimin e vlerave të tyre.<br>UAMD pavarësisht se është një institucion relativisht i ri në tregun akademik shqiptar ka ndjekur një politikë për ruajtjen e konsolidimin e trashëgimisë së tij akademike, kulturore dhe shkencore[9]. Në hierarkinë e vlerave të Fakultetit të Biznesit, si një prej Njësive Kryesore qëndron dimensioni njerëzor dhe vullnetarizimi, mendimi dhe veprimi intelektual, aktiviteti i përbashkët dhe punë e frytshme vullnetare që nxisin të mirën kombëtare [10 11 12].<br>Programi i studimit Master Profesional GTSH, shpreh qartazi që në mënyrën e hartimit të tij mbështetjen në përvojën akademike e kulturore, ndaj kërkesave të kohës dhe perspektivës së zhvillimit të vendit dhe synon ruajtjen dhe zhvillimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare[13]. |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë. | **PO.** UAMD, në përputhje me misionin, vizionin dhe qëllimin e tij, ofron një numër të madh programesh akademike studimi të cilat përbëjnë dhe fushën e veprimtarisë së tij.[14]<br>Misioni i Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës dhe i Fakultetit të Biznesit si një ndër Njësitë Kryesore të Universitetit, është rritja në mënyrë të vazhdueshme dhe arritja e standarteve akademike më të larta bashkëkohore kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe përkrahja e |

[1] *Aneks 1 Mendimi i Dekanit*
[2] *Aneks 2 Statuti i UAMD, Neni 2, pika 1; Neni 3; Neni 4*
[3] *Aneks 3 Plani Strategjik i Zhvillimit UAMD (2016-2020, Pika 1 dhe 2*
[4] *Aneks 3.1 Plani Strategjik i Zhvillimit UAMD (2020-2025 Pika 1 dhe 2*
[5] *Aneks 3.2 Plani i Zhvillimit Strategjik te FB, Pika A-E*
[6] *Aneks 4 Plani Strategjik i zhvillimit të Programit të Studimit MP-GTSH*
[7] *Aneks 4.1 Plani Strategjik i zhvillimit të DT, Pika A-C*
[8] *Aneks 7 Rregullore e programit të studimit MP, GTSH, Kreu I, Neni 6*
[9] *Aneks 2 Statuti i UAMD, Neni 4*
[10] *Aneks 2 Statuti i UAMD, Neni 3*
[11] *Aneks 52 Kodi i Etikës UAMD, Kreu I, Neni 2,3, Kreu II, neni 4, Pika 1*
[12] *Aneks 5 Rregullore e UAMD, Kreu I, Neni 3*
[13] *Aneks 1 Mendimi i Dekanit*
[14] *Aneks 3.1 Plani Strategjik i Zhvillimit UAMD (2020-2025, Pika 4*

| | |
|---|---|
| | aspiratave arsimore dhe arritjet e cilitdo që kërkon të përfitojë nga arsimi i lartë [15] [16] [17]<br>Programi i studimit Master Profesional GTSH, plotëson kriteret në hartimin e tij dhe ofrohet në përputhje me qëllimet, misionin dhe fushën e veprimtarisë së e UAMD-së , e të FB [18]. |
| **Kriteri 3.** Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të Strategjisë për Zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademik të Institucionit. | **PO**. Programi i studimit Master Profesional GTSH është hartuar dhe ju ofrohet studentëve në përputhje dhe në zbatim të Planit Strategjik të Zhvillimit të Institucionit, UAMD-së. Drejtimet strategjike të zhvillimit të UAMD-së shprehen në Statutin e Universitetit[19] dhe, në vazhdimësi ndërvite, duke filluar nga Plani Strategjik i zhvillimit të Institucionit 2016-2020[20] si edhe në Plani i Ri Strategjik të Zhvillimit të Institucionit, 2020 - 2025[21], i cili,ky i fundit, evidenton vizionin për arsimin e lartë në përgjigje të sfidave e të detyrave që burojnë nga procesi i Bolonjës.<br>Statuti dhe rregullorja e UAMD-së, rregulloret e Fakultetit të Biznesit dhe Departamentit të Turizmit, si dhe rregullorja e programit të studimit Master Profesional GTSH përcaktojnë qartë drejtimet prioritare akademike të institucionit dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit. Në këtë kuptim përmbatja e programit të studimit Master Profesional GTSH është në përputhje me kuadrin ligjor përcaktues në fuqi.[22] [23] [24] [25] [26] [27] [28] [29][30] |
| **Kriteri 4.** Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar. | **PO.** Mbështetur në Planin strategjik të zhvillimit të UAMD në nivel institucioni, mbi të cilin DT është mbështetur për hapjen e programit të studimit Master Profesional GTSH si dhe për përmirësimin në vijimësi të programeve të studimeve që mbulon ky Departament, programi i studimit MP GTSH, është hartuar në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesin kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit.[31] [32] [33] [34] [35] [36]<br>Programi i studimit Master Profesional GTSH është hartuar dhe ofrohet në përputhje me nevojat e zhvillimit ekonomik lokal dhe kombëtar. Ky program mundëson pajisjen me njohuri dhe kompetenca profesionale për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm të burimeve |

---

*[15] Aneks 3 Plani Strategjik i Zhvillimit UAMD (2016-2020, Pika A-C*
*[16] Aneks 3.2 Plani Strategjik i Zhvillimit të Fakultetit Biznesit, A-C*
*[17] Aneks 4.1 Plani Strategjik i Zhvillimit të DT, Pika A-C*
*[18] Aneks 7 Rregullore e Programit të Studimit MP GTSH, Kreu I, Neni 1,neni 6.*
*[19] Aneks 2 Statuti i UAMD; Neni 3,4.*
*[20] Aneks 3 Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD (2016-2020, Pika A-C*
*[21] Aneks 3.1 Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD (2020-2025, Pika 4*
*[22] Aneks 2 Statuti i UAMD, Neni 4, pika 2,3 neni 57, pika 1,2*
*[23] Aneks5 Rregullore UAMD, Kreu I, neni 1 e 2*
*[24] Aneks 6 Rregullore e Fakultetit te Biznesit, Kreu I, neni 1 e 2, kreu III, Neni 34, pika 2*
*[25] Aneks 53.1 Ligji 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Kreu II, Neni 7/dh,e*
*[26] Aneks 59 VKM 41 datë 24.1.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë"*
*[27] Aneks 60 Udhëzimin e MASR 1 datë 14.01.2020 "Për dokumentacionit dhe procedurave për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e Institucioneve të Arsimit të Lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si edhe për ndarjen apo bashkimin e institucioneve të larta"*
*[28] Aneks 61 VKM 531, datë 11.9.2018 "Për miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë";*
*[29] Aneks 61.1 VKM 824, datë 24.12.2021,Për Miratimin E Kodit të Cilësisë së Arsimit Të Lartë"*

*[30] Aneks 57 Vendim i MASR per hapjen e programmit te studimit MP GTSH.*
*[31] Aneks 55 Strategjia Kombetare per Shkencen, Teknologjine dhe Inovacionin ( 2018-2022, VKM 710, date 1.12.2017*
*[32] Aneks 53 Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit 2018-2022*
*[33] Aneks 3 Plani Strategjik i Zhvillimit UAMD (2016-2020, , Pika 8*
*[34] Aneks 3.1 Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD (2020-2025,, Pika 7*
*[35] Aneks 3.2 Plani Strategjik i Zhvillimit të Fakultetit Biznesit, Misioni e Vizioni;*
*[36] Aneks 4.1 Plani i Zhvillimit Strategjik të Departamentit të Turizmit, Objektivat e synuara/2;*

| | |
|---|---|
| | njerëzore në turizëm dhe për të mirëmenaxhuar ofertën e kërkesën e tregut turistik.[37] [38] Nëpërmjet këtij programi studimi synohen të plotësohen nevojat e tregut të punës në nivel lokal, kombëtar dhe më gjerë. Për këtë arsye zbatimi dhe administrimi i këtij programi studimi është ndër prioritetet e Departamentit të Turizmit me ambicjen për të marë në konsideratë plotësimin e nevojave të tregut të punës, duke formuar specialistë të guidës turistike në përputhje dhe me strategjitë prioritare të zhvillimit ekonomik kombëtar, sikundër është turizmi. Ky program është hartuar në përshtatje me kërkesat e tregut të punës dhe me zhvillimin ekonomik të vendit dhe nuk bie ndesh me interesat dhe programet të ofruara nga Institucione të tjera të Arsimit të lartë.[39] [40] [41] Programi i studimit Master Profesional në GTSH i ofruar nga DT është i ngjashëm me programe studimi të ofruar nga institucione ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimin e studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar. Studentët e këtij programi mund të kryejnë mobilitet në kuadrin e projekteve dhe programeve ndërkombëtare me të cilat Universiteti "Aleksandër Moisiu" ka marrëveshje.[42], [43], [44] Studimet universitare pranë Departamentit të Turizmit në FB, janë hartuar dhe implementohen në përqasje me rregullat dhe parimet e Hapësirës Europiane të Arsimit të Lartë. Diplomat ofrohen në dy gjuhë (shqip dhe anglisht) dhe vlerësimi shprehet sipas Sistemit Europian të Transferimit të Krediteve (ECTS) dhe Sistemit Amerikan të Krediteve, për të krijuar lehtësi lexueshmërie, transferimi dhe vazhdimi të studimeve universitare pranë institucioneve arsimore të Arsimit të Lartë brenda vendit, rajonit e më gjerë.[45] [46] [47] [48] Programi i studimit i ofruar është bashkëkohor, në përputhje me nevojat e tregut të punës, të territorit, të shoqërisë dhe të studentit, pasi përcaktimi i fushave prioritare të studimit janë të identifikuara në interesat e zhvillimin rajonal, kombëtar e më gjerë.[49] |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

**Standardi I.2**

**Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.**

| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Institucioni demonstron se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e | **PO.** UAMD është institucion publik i arsimit të lartë që ushtron aktivitetin e tij nga viti 2005, i krijuar me VKM nr. 801, datë |

[37] *Aneks 4 Plani Strategjik i Zhvillimit të Programit të Studimit MP GTSH*
[38] *Aneks 16 Studim i tregut të Punës para hapjes së Programit të Studimit GTSH*
[39] *Aneks 4 Plani Strategjik i Zhvillimit të Programit të Studimit MP GTSH*
[40] *Aneks 53 Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit 2018-2022,Kapitulli I*
[41] *Aneks 3.2 Plani Strategjik i Zhvillimit të FB, pika A-C*
[42] *Aneks 63 Plani Mësimor i programit të studimit MP GTSH i riorganizuar në20% i miratuar nga Senati*
[43] *Aneks 58 Programe të përafërta studimi të ngjashme me programin e MP GTSH që ofrohen nga institucione ndërkombëtare të arsimit të lartë*
[44] *Aneks 34 Marëveshje bashkepunimi të Fakultetit Biznesit*
[45] *Aneks 2 Statuti i UAMD, kreu VI,Neni 72/1; Neni 74, neni 76/5;*
[46] *Aneks 5 Rregullore e UAMD, Kreu III, Neni 41/1-4; neni 45/1; Neni 56/1; Neni 60/1; Neni 61/3 ;*
[47] *Aneks 15 Modeli i diplomës, Urdhër Aprovimi nga MASR*
[48] *Aneks 15.1 MP GTSH Suplementi i diplomes*
[49] *Aneks 3.1 Plani i zhvillimit strategjik të UAMD 2020-2025*

| | |
|---|---|
| duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë. | 20.05.2005 "Për Hapjen e Universitetit Alekandër Moisiu", Durrës. Në këto vite, UAMD ka pësuar rritje dhe transformime cilësore dhe sasiore, horizontale dhe vertikale. Sot institucioni numëron mbi 100 programe studimi në të tri ciklet, rreth njëzet mijë student dhe mbi 300 punonjës si personel akademik me kohë të plotë të organizuar në gjashtë njësi kryesore.[50]<br>Një nga njësitë kryesore është FB pjesë e të cilit është Departamenti i Turizmit, njësia bazë e ofrimit të këtij programi studimi. Departamenti ka rreth 12 vjet që ofron ekspertizën e tij akademike në 3 programe studimi Bachelorit, në 2 programe studimi Master Profesional dhe 1 program studimi 2-vjecar.<br>DT ka një staf akademik prej 9 lektorësh me ngarkesë të plotë mësimore e cila mbulon të gjitha programet e studimit që zhvillohen në DT. Në këtë kuptim mund të themi se FB dhe DT dëshmojnë se kanë përvojë, kapacitete dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e programit të studimit Master Profesional GTSH, përkrahur dhe asistuar dhe nga personeli ndihmës akademik.[51] [52] [53] [54] [55] |
| **Kriteri 2.** Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. | **PO.** Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit GTSH është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, FB,[56] përgjegjës për këtë program, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e europiane.[57]<br>Emërtimi, organizimi dhe struktura e programit të studimit Master profesional GTSH është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit, si program i ciklit të dytë të studimeve, Master Profesional, i ngritur mbi programin e ciklit të parë bachelor Menaxhim Turizëm sipas profileve Menaxhim Hotel Restorant, Menaxhim Turizëm Kulturor dhe Menaxhim Turizëm Arkeologjik. Programi ka objektiva të përcaktuara qartë për formimin e studentëve, të cilat përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të tij.[58] [59] [60] [61] [62] [63] [64] [65] [66] |
| **Kriteri 3.** Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e | **PO.** Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit Master Profesional GTSH është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë DT, përgjegjëse për këtë program[67] [68] [69] [70] |

[50] *Aneks 97.1 Raporti vjetor i UAMD per vitin akademik 2019-2020*
[51] *Aneks 20 CV e Stafit Akademik të Departamentit të Turizmit*
[52] *Aneks 22 CV e Stafit Ndihmës Akademik*
[53] *Ankes 43 Të dhënat për aktivitetet dhe kërkimin shkencor për stafin e DT*
[54] *Ankes 65 Fushat e Studimit të lektorëve të Departamentit te Turizmit*
[55] *Aneks 108 Orari mesimor 2020-2021*
[56] *Aneks 6 Rregullore e Fakultetit te Biznesit, Kreu II, neni 15; Seksioni kerkimi Shkencor, Neni 26*
[57] *Aneks 31 Të dhëna për Kodifikimin e programit të studimit mbështetur në LAL 80/2015*
[58] *Aneks 2 Statuti i UAMD, Neni 4/2,3; neni 57/1,2,3; Neni 58/2,3; Neni 63/1,4 ;*
[59] *Aneks 3 Plani i Zhvillimit Strategjik te UAMD 2016-2020, Pika 8;*
[60] *Aneks 3.1 Plani strategjik i zhvillimit UAMD ( 2020 – 2025, Pika 7*
[61] *Aneks 3.2 Plani i Zhvillimit Strategjik ne Fakultetit e Biznesit, Pika Misioni e Vizioni*
[62] *Aneks 4.1 Plani i Zhvillimit Strategjik të Departamentit të Turizmit, Hyrja,*
[63] *Aneks 5 Rregullore e UAMD, Kreu I, Neni 1, Neni 2, Kreu III, Neni 40/1,2,3; Neni 41/1,2,3,4; neni 42/1, neni 45/1,3;*
[64] *Aneks 6 Rregullore e Fakultetit te Biznesit, Kreu I, neni 1,2,3 kreu III, Neni 34, Neni 35/1,2,3,4;*
[65] *Aneks 7 Rregullore e programit të studimit MP GTSH, Kreu I-VIII*
[66] *Aneks 14 Dosja e plote e aplikimit te programit te studimit MP GTSH*
[67] *Aneks 6.1 Rregullore e Departamentit Turizmit, Kreu I,neni 2 ,*
[68] *Aneks 7 Rregullore e Master Profesional GTSH, Kreu I,Neni 1; Neni 5;*
[69] *Aneks 6 Rregullore e Fakultetit te Biznesit, , Kreu II, neni 15; Seksioni kerkimi Shkencor, Neni 26;*
[70] *Aneks 7 Rregullore e Master Profesional GTSH,Kreu I, Neni 5, Neni 6;*

| | |
|---|---|
| kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje. | sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit, sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e europiane. Hartimi dhe zbatimi i programit të studimit është në përputhje me kodifikimin e programit të studimit sipas klasifikimeve kombëtare mbështetur në Ligjin nr. 80/2015 dhe direktivave e udhëzimeve kombëtare e Europiane.[71] [72] [73] |
| **Kriteri 4.** Në rastet kur institucioni ofron program "Master profesional" në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere. | N/A |
| **Kriteri 5.** Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit. | **PO.** Studentet e MP GTSH janë përfshirë në trajnime profesionale nga lektorë të departamentit në bashkëpunim me institucione mbështetëse.[74] |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | X |

| **Standardi I.3**<br>**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre. | **PO.** Departamenti i Turizmit për mbarëvajtjen e punës në drejtim të zbatimit të programit mësimor në Master profesional GTSH ka siguruar marrëdhënie bashkëpunimi brënda fakultetit me departamente të tjera për të mundësuar realizimin efektiv të objektivave që ka ky program studimi, në përputhje me kuadrin ligjor përkatës në fuqi.[75] [76] [77] Realizimi i marrëdhënieve të bashkëpunimit ka qënë i nevojshëm për mbulimin e lëndëve e moduleve që përbëjnë kurrikulën e këtij programi studimi dhe që zhvillohen nga lektorë jashtë departamentit[78]. |
| **Kriteri 2.** Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj. | **PO.** Për realizimin e objektivave të programit të studimit si dhe procesit mësimor e formues të studentëve, UAMD dhe FB si njësi kryesore e UAMD ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brënda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.[79] [80] [81] |
| **Kriteri 3.** Për realizmin e programeve të | **PO.** Në kuadër të realizimit të programit të studimit Master Profesional |

[71] *Aneks 61 VKM 531, datë 11.9.2018, "Për miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë".*
[72] *Aneks 31 Të dhëna për Kodifikimin e programit të studimit mbështetur në LAL 80/2015*
[73] *Aneks 61.1 VKM 824, datë 24.12.2021,Për Miratimin E Kodit të Cilësisë së Arsimit Të Lartë"*
[74] *Aneks 33 Tabele permbledhese me studentet e trajnuar*
[75] *Aneks 2 Statuti i UAMD,kreu I, Neni 5, pika 4/a,d;*
[76] *Aneks 5 Rregullore e UAMD, Kreu II, neni 27, pika F;*
[77] *Aneks 6 Rregullore e Fakultetit te Biznesit, seksioni I, Neni 24, pika 3/a;*
[78] *Aneks 24 Të dhëna tabelare për personelin akademik në programin e studimit.*
[79] *Aneks 2 Statuti I UAMD, Neni 5, pika 4,c*
[80] *Aneks 34 Marreveshjet e Bashkepunimit te Fakultetit te Biznesit*
[81] *Aneks 129 Marreveshjet e bashkepunimit UAMD*

| | |
|---|---|
| studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve. | GTSH, UAMD dhe FB ka nënshkruar disa marrëveshje institucionale në nivel lokal dhe kombëtar si dhe biznese e kompani private që operojnë në fushën e turizmit.[82] Qëllimi i nënshkrimit të këtyre bashkëpunimeve ndër të tjera është dhe realizimi i aftësimit praktik profesional të studenteve pranë këtyre institucioneve ose kompanive.[83] Fakulteti i Biznesit dhe Departamenti i Turizmit kanë vendosur marrëdhënie bashkëpunimi, në funksion të realizimit të programit të studimit lidhur me kryerjen dhe mbikqyrjen e praktikave profesionale me bashki e njësi administrative, si dhe me aktorë të bizneseve private të fushës, me qëllim mundësimin e realizimit të aftësimit praktik të studentëve drejtpërdrejtë në kontakt me funksionet profesionale menaxhuese, administruese e drejtuese, për fitimin e shprehive praktike të punës, njëkohësisht për të siguruar edhe mbikqyrjen e tyre gjatë kryerjes së praktikës në terren.[84] [85] |
| **Kriteri 4.** Në mënyrë periodike njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit. | **PO**. Programi i studimit Master Profesional GTSH është në vitin e katër të funksionimit të saj. Departamenti në analizën vjetore të punës të programit të studimit ka analizuar edhe përfitimet që vijnë nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.[86] [87]<br>Në kuadër të bashkëpunimeve janë realizuar aktivitete të stafit akademik dhe studentëve. Gjithashtu janë realizuar aktivitete on -line informuese krahas dhe leksione të përbashkëta.[88] [89] |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

## II.ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

**Standardi II.1**

**Programi i studimit "Master Profesional" organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore .**

| Kriteret | Vlerësimi |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Elementët që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në | **PO.** Programi i studimeve Master Profesional GTSH është i strukturuar në përputhje me Ligjin për arsimin e lartë nr. 80/2015[90], dhe aktet e tjera ligjore[91, 92, 93, 94, 95, 96] e nënligjore[97, 98, 99]. |

[82] *Aneks 34.1 Tabelë përmbledhëse me institucionet bashkëpunuese të UAMD*
[83] *Aneks 10.3 Rregullore Praktike ne Fakultetin e Biznesit*
[84] *Aneks 10.3 Rregullore Praktike ne Fakultetin e Biznesit*
[85] *Aneks 64 Shembull i kryerjes së praktikave profesionale në programin MP GTSH*
[86] *Aneks 38 Analiza vjetore e Departamentit të Turizmit 2021-2022*
[87] *Aneks 38. 1 Analiza për Programin e Studimit MP GTSH*
[88] *Aneks 35 Raport analitik mbi përfitimet nga marëdhëniet e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve*
[89] *Aneks 107 Relacion mbi leksionet e hapura nga lektore te huaj*
[90] *Aneks 53.1 Ligji . 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencorë në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë*

| | |
|---|---|
| kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). | Struktura e programeve të studimit shprehet në ndërtimin e Planit Mësimor të detajuar dhe të miratuar dhe të Kurrikulës së programit të studimit[100,101]. Zbatimi i këtij programi studimi bëhet në përputhje me përcaktimet e Rregullores së Programit të Studimit[102].<br>Programi i studimit është i organizuar në lëndë e module të cilat, në Kurrikulën e Programit dhe Planin Mësimor shprehen nëpërmjet ngarkesës mësimore në orë mësimore që përmban çdo lëndë/modul. Veprimtaritë formuese janë të vlerësuara në kredite ECTS sipas ligjit të Arsimit të lartë 80.2015, neni 75, pika 6, ku secila veprimtari formuese ka kreditet e saj[103].<br>Elementët që përbëjnë strukturën e programit të studimit janë të organizuar në lëndë/module, pesha e të cilave vlerësohet me kredite, sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS)[104].<br>Mësimi organizohet me orë mësimore, ku çdo orë mësimore në këtë program studimi zgjat 50 minuta. Totali i orëve që bën studenti, në auditor dhe si punë e pavarur, konvertohet në kredite, ku 1 ECTS = 25 orë mësimore punë e studentit. Sasia e krediteve shprehen në programin mësimor për secilën lëndë të ndarë sipas aktiviteteve leksion, seminare, punë laboratorike dhe praktika.<br>Organizimi i programit të studimit (1 vit, 2 semestra, javë etj.).<br>• 1 vit akademik ka 30 javë mësimore në auditor<br>• 1 Semestër ka 15 javë mësimore në auditor<br>• 1 ECTS 25 orë mësimore punë të studentit<br>• 1 orë mësimore zgjat 50 minuta.<br><br>Plani mësimor është i detajuar sipas Veprimtarive Formuese sipas Simboleve A, B, C, D, E dhe F (sipas VKM Nr. 41, datë 24.1.2018), "Për Elementët e Programeve të Studimit" dhe i përmbahet këtij akti nënligjor[105,106].<br>Ndarja e lëndëve dhe moduleve në planin mësimor i përgjigjet plotësisht këtyre kategorive të përcaktuara[107,108]. Në planin mësimor të këtij program studimi përcaktohen lëndët/modulet e programit të ndara sipas |

[91] *Aneks 59. VKM, 41, datë 24.1.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë".*
[92] *Aneks 59.1. Vendim . 879, Datë 18.12.2019 Për Disa Ndryshime Dhe Shtesa Në Vendimin . 41, Datë 24.1.2018, Të Këshillit Të Ministrave.*
[93] *Aneks 60. Udhëzimin e MASR 1 datë 14.01.2020 "Për dokumentacionit dhe procedurave për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e Institucioneve të Arsimit të Lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si edhe për ndarjen apo bashkimin e institucioneve të larta".*
[94] *Aneks 61. VKM 531 date 11.09.2018 Per miratimin e Kodit te Cilesise se Arsimit te Larte;;*
[95] *Aneks 61.1 VKM .824, date 24.12.2021 Per miratimin e Kodit te Cilesise se Arsimit te Larte;*
[96] *Aneks 62. VKM . 418 datë 10.05.2017 "Për standartet, kriteret dhe proçedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e programeve të studimit.*
[97] *Aneks 5 Rregullorja e UAMD Kreu III.*
[98] *Aneks 6 Rregullore e Fakultetit të Biznesit, Kreu III*
[99] *Aneks 6.1. Rregullore e Departamentit Turizmit, Kreu III*
[100] *Aneks 14 Aplikimi MP GTSH*
[101] *Aneks 14.1 Riorganizimi MP GTSH, 2020*
[102] *Aneks 7 Rregullore e programit te studimit MP GTSH*
[103] *Aneks 53.1 Ligji . 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencorë në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë*
[104] *Aneks 14 Aplikimi MP GTSH.*
[105] *Aneks 19. Silabuset e lendeve ne fazen e Aplikimit fillestar*
[106] *Aneks 67 Silabuset e reja me ndryshimet pas riorganizimit mbi 20% MP GTSH*
[107] *Aneks 14 Aplikimi MP GTSH.*
[108] *Aneks 14.1 Riorganizimi MP GTSH, 2020*

| | |
|---|---|
| | kategorive të veprimtarive formuese:<br>• Simboli A – Lëndë Bazë 10% me 6 kredite ECTS me 1 lëndë<br>• Simboli B – Lëndë Karakterizuese 40% me 24 kredite ECTS me 4 lëndë<br>• Simboli C – Lëndë Ndërdisiplinore/Integruese 23% me 14 kredite ECTS me 2 lëndë<br>• Simboli D – Lëndë Plotësuese 10% me 6 kredite ECTS me 2 lëndë<br>• Simboli E – Lëndë Detyrime Përmbyllëse 17% me 10 kredite ECTS Mikroteza<br>Ky kategorizim i lëndëve/moduleve në planin mësimor dhe organizimi i kurrikulkës së studimit në vite e semestra i shërben plotësisht formimit profesional të studentëve në këtë program studimi. |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit *"Master profesional`* synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionesh e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale. | **PO.** Synimi i këtij programi studimi është formimim dhe aftësimin i studentëve në specialistin e Guidës Turistike në territorin e shtetit Shqiptar[109,110].<br>Programi përmban lëndë dhe module të cilat kanë karakter shumëdisiplinor, gjë e cila i shërben formimit të gjithanshëm të studentëve në profesionin e guidave turistike, zhvillimi i të cilave shprehet në rregulloren e programit të studimeve[111],[112].<br>Në kurrikulën e programit MP GTSH lëndët janë të ndara në disiplina të formimit karakterizues, që përbëjnë aspektin kryesorë të formimit profesional në program, në lëndë që bëjnë pjesë në disiplina të formimit të thelluar, lëndë të karakterit integrues, lëndë karakterizuese specifike dhe në praktikën mësimore sipas programit të modulit. Synimi i organizimit në këtë mënyrë të lëndëve është formimi profesional i studentëve dhe krijimi i mundësisë që të orientohen drejt një kategorie specifike profesioni në fushën e turizmit, siç është profesioni i Guidierit Turistik në Shqipëri.[113,114].<br>Programi MP GTSH ofron njohuri të mira në fushën e punësimit në turizëm sepse bazohet mbi parimet akademike të kësaj fushe. Këto parime akademike janë të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të FB[115] dhe Rregulloren e programit të studimit në MP GTSH[116]. Njohuritë e fituara gjatë ndjekjes së këtij program studimi jep dhe rrit mundësitë për karrierë profesionale në profesionin e Guidës Turistike Shqiptare, në nivel rajonal dhe kombëtarë.<br>Duke zhvilluar aftësi teknike, ndërpersonale dhe konceptuale në profesionin e guidës, programi bën të mundur punësimin e të diplomuarve në biznese të llojeve dhe dimensioneve të ndryshme të industrisë së turizmit, si: pranë agjensive turistike të sektorit privat, Agjensia Kombëtare e Turizmit (AKT), Shoqata Shqiptare e Turizmit (ATA), Shoqata Kombëtare e Guidave Turistike të Shqipërisë (NATGA), Guida profesionale pranë Drejtorive Rajonale të Kulturës Kombëtare (DRKK), Unioni Turistik Shqiptar (UTSH), në biznese private të Agjensive Turistike, si Freelance, në Parqe Arkeologjike Shqiptare, në Muzet Arkeologjik, Histori, Natyrorë etj., si guida në |

109 *Aneks 6. Rregullore e Fakulteti Biznesit, Kreu III.*
110 *Aneks 6.1, Rregullore e Departamentit të Turizmit*
111 *Aneks 7. Rregullore e programit te studimit MP GTSH*
112 *Aneks 5. Rregullorja e UAMD Kreu III*
113 *Aneks 59. VKM, 41, datë 24.1.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë"*
114 *Aneks 59.1. Vendim . 879, Datë 18.12.2019 Për Disa Ndryshime Dhe Shtesa Në Vendimin . 41, Datë 24.1.2018, Të Këshillit Të Ministrave*
115 *Aneks 6. Rregullore e Fakulteti Biznesit, Kreu III, Neni 33, Neni 47, Neni 48.*
116 *Aneks 7. Rregullore e programit te studimit MP GTSH*

| | |
|---|---|
| | monumente të Kategorisë I dhe II etj.<br>Ky program ofron një informacion bashkëkohor në profesionin e Guidës Turistike[117] gjë e cila shprehet në rinovimin e syllabuseve dhe pasurimin e tyre me literaturë të përditësuar të viteve të fundit, e cila pasqyron njohuritë dhe zbulimet e reja të kësaj fushe akademike dhe transmetimin e tyre tek studentët në auditor[118,119].<br>Qëllimi final i programit është formimi i specialistëve guidier me njohuritë e nevojshme për të kuptuar në mënyrë kritike teoritë dhe parimet akademike në fushën që ata do të punësohen në të ardhmen, duke plotësuar mungesën e sotme të Guidave Turistike në tregun e punës në Shqipëri.<br>Programi i studimit MP GTSH ka si synim të pajis studentët me dijet e nevojshme profesionale dhe aftësimin e tyre për zgjidhjen e problemeve në fushën e turizmit, veçanërisht në profesionin e Guidës Turistike Shqiptare. Kuadri formues për këtë specialitet synon të ofrojë njohuri dhe kompetenca në realizimin e objektivave të njohjes së destinacioneve turistike arkeologjike, historike, natyrore, kulturore, detare, mjeksore etj. Në mënyrë që të menaxhohen turet turistike me turistë, të krijohet paketa turistike, të rritet komunikimi me turistët, tu shërbej dhe japi informacione turistëve gjatë turit, duke synuar rritjen e interesit dhe të kënaqësisë së vizitës së një turisti.<br>Në këtë program studimi synohet rritja e njohurive përtej asaj që kanë fituar në ciklin e parë të studimeve, gjë e cila iu jep mundësi studentëve të jenë origjinalë në zhvillimin e ideve dhe zbatimin e tyre. Studentët që ndjekim MP GTSH do të fitojnë kompentenca në zbatimin e njohurive të marra dhe kapacitetin e tyre për zgjidhjen e probleme në mjedise të reja e brenda konteksteve më të gjëra (ose shumëdisiplinore) që lidhen me fushën e studimit të tyre.<br>Kjo gjë pasqyrohet edhe në syllabuset e lëndëve që përbëjnë programin e studimit[120],[121][122]. Syllabuset janë bashkohore dhe do të japin informacion në një nivel të avancuar njourish, aftësish dhe kompetenca në fushën profesionale që janë të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme gjatë ushtrimit të profesionit në punë si Guidë Turistike. Syllabuset e lëndëve që përbëjnë këtë program studimi, në ndërtimin e tyre, e cila pasqyrohet tek temat e leksioneve që trajtohen gjatë zhvillimit të tij, transmetojnë një nivel të avancuar informacioni në këtë drejtim[123,124]. |

[117] *Aneks 7. Rregullore e programit te studimit MP GTSH*
[118] *Aneks 59. VKM, 41, datë 24.1.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë" , KAPITULLI " Syllabuset, pjesa e përmbledhjes dhe rezultateve të të nxënit dhe pjesa "Literatura bazë dhe ndihmëse"*
[119] *Aneks 59.1. Vendim . 879, Datë 18.12.2019 Për Disa Ndryshime Dhe Shtesa Në Vendimin . 41, Datë 24.1.2018, Të Këshillit Të Ministrave*
[120] *Aneks 6. Rregullore Fakulteti Biznesit, Kreu III, Neni 33, Neni 47, Neni 48.*
[121] *Aneks 6.1. Rregullore Departamenti Turizmit*
[122] *Aneks 7. Rregullore e programit te studimit MP GTSH*
[123] *Aneks 59. VKM, 41, datë 24.1.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", Syllabuset, pjesa e përmbledhjes dhe rezultateve të të nxënit dhe pjesa "Literatura bazë dhe ndihmëse".*
[124] *Aneks 59.1. Vendim . 879, Datë 18.12.2019 Për Disa Ndryshime Dhe Shtesa Në Vendimin . 41, Datë 24.1.2018, Të Këshillit Të Ministrave*

| | |
|---|---|
| **Kriteri 3** Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse. | **PO.** Ndërtimi i programit të studimit MP GTSH është organizuar në mënyrë të tillë që çdo student realizon në semestrin e dytë praktikën profesionale[125,126,127], mbasi ka përmbyllur të gjitha detyrimet e mëparshme dmth që çdo student merr me notë kaluese të gjitha lëndët e kurrikulës[128],[129]. Praktika profesionale vlerësohet me 6 kredite (kjo e përcaktuar në programin e studimit)[130],[131],[132],[133] e cila mbrohet përpara një komisioni vlerësimi i krijuar çdo vit nga Përgjegjësi i Njësisë Bazë. Mbas përfundimit të praktikës dhe mbrojtjes së saj, në semestrin e dytë duhet të mbroj përpara një komusioni të krijuar nga Përgjegjësi i Njësisë Bazë detyrimet përmbyllëse ose mbrojtjen e Tezës së Diplomës, e cila vlerësohet me 10 Kredite ose 17% të totalit të krediteve të programit (kjo e përcaktuar në programin e studimit)[134],[135],[136],[137],[138],[139], brenda hapsirës që parashikon VKM 41, 2018, Shtojca 1, Tabela 1: Veprimtaritë Formuese. |
| **Kriteri 4.** Programet e ciklit të dytë "Master" në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve "Master", sipas fushave përkatëse të formimit. | NA |
| **Kriteri 5.** Programi i studimit "Master " në mësuesi, organizohen me 120 kredite dhe duhet te permbajne 25% të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psikopedagogjik.Programet master që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kënë së paku 80% të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme. | NA |
| **Kriteri 6.** Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në | **PO.** Bazuar në VKM nr. 41, Dt. 24.01.2018, në planin mësimor të programit të studimit, lëndët e programit të studimit janë të ndara sipas kategorive të veprimtarive formuese përkatëse, si dhe në semestra[140] të tij. |

[125] *Aneks 5.Rregullorja e UAMD, Kreu III , Neni 45.*
[126] *Aneks 6. Rregullore Fakulteti Biznesit.*
[127] *Aneks 6.1. Rregullore Departamenti Turizmit*
[128] *Aneks 10.2 Rregullore e Mikrotezës dhe Praktikës Profesionale në FB*
[129] *Aneks 10.3. Rregullore e Praktikës në Fakultetin e Biznesit*
[130] *Aneks 5. Rregullorja e UAMD.*
[131] *Aneks 7, Rregullore e programit te studimit MP GTSH.*
[132] *Aneks 15, Modeli i diplomës dhe urdheri i aprovimit nga MASR*
[133] *Aneks 15.1 MP GTSH Suplementit të Diplomës*
[134] *Aneks 5.Rregullorja e UAMD.*
[135] *Aneks 6. Rregullore Fakultetit të Biznesit*
[136] *Aneks 6.1. Rregullore e Departamentit të Turizmit*
[137] *Aneks 7, Rregullore e programit te studimit MP GTSH.*
[138] *Aneks 15, Modeli i diplomës dhe urdheri i aprovimit nga MASR*
[139] *Aneks 15.1 MP GTSH Suplementit të Diplomës*
[140] *Aneks 14. Aplikimi MP GTSH*

| | |
|---|---|
| përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin. | Programi i studimit MP GTSH përmban të gjithë elementët që përbëjnë strukturën e një programi studimi sipas përcaktimeve në aktet ligjore[141], [142] e nënligjore në fuqi[143], [144], [145], [146] të shtetit shqiptar.<br>Organizimi i këtij programi studimi, i cili pasqyrohet edhe në dokumentacionin e programit të studimit, mbështetet në hartimin e dokumentacionet themelore të tij që janë:<br>-Kurrikula mësimore[147], [148];<br>-Plani mësimor[149], [150];<br>-Programet mësimore (Syllabuset) të lëndëve/moduleve përbërëse[151], [152];<br>-Rregullorja e programit të studimit[153].<br>Programi i studimit MP GTSH është i hartuar në përputhje me përcaktimet ligjore për veprimtaritë formuese të tij duke i grupuar lëndët dhe modulet[154], [155], [156] sipas kategorive përkatëse dhe duke i shprehur në ngarkesën mësimore me raportin e orëve dhe me kredite. Veprimtaritë formuese, që përbëjnë edhe pjesën kryesore të programit të studimit janë detajuar në program konform përcaktimeve ligjore. Në hartimin e kurrikulës të këtij programi studimi lëndët janë të grupuara\organizuara sipas legjislacionit shqiptarë në fuqi, ku ato grupohen në:<br>• Lëndë të Simbolit A ose Bazë të Detyrueshme[157], [158];<br>• Lëndë të Simbolit B ose Karakterizuese\Përgatije për Disiplinës Shkencore[159], [160];<br>• Lëndë të Simbolit C ose Ndërdisiplinore\Integruese, Ndërdisiplina, profile dhe grup lëndë me zgjedhje[161], [162];<br>• Lëndë të Simbolit D ose Plotësuese\ Gjuhë e Huaj, njohuri Informatike[163], [164];<br>• Lëndë të Simbolit E ose Detyrime Përmbydhëse[165], [166]; |

*[141] Aneks 59. VKM, 41, datë 24.1.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", Syllabuset, pjesa e përmbledhjes dhe rezultateve të të nxënit dhe pjesa "Literatura bazë dhe ndihmëse".*
*[142] Aneks 59.1. Vendim . 879, Datë 18.12.2019 Për Disa Ndryshime Dhe Shtesa Në Vendimin . 41, Datë 24.1.2018, Të Këshillit Të Ministrave*
*[143] Aneks 5. Rregullorja e UAMD, Kreu III.*
*[144] Aneks 6. Rregullore e Fakultetit të Biznesit, Kreu III.*
*[145] Aneks 6.1. Rregullore e Departamentit të Turizmit*
*[146] Aneks 7. Rregullore e programit te studimit MP GTSH*
*[147] Aneks 14. Aplikimi MP GTSH.*
*[148] Aneks 14.1 Riorganizimi MP GTSH, 2020*
*[149] Aneks 14. Aplikimi MP GTSH.*
*[150] Aneks 14.1 Riorganizimi MP GTSH, 2020*
*[151] Aneks 59. VKM, 41, datë 24.1.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", Syllabuset, pjesa e përmbledhjes dhe rezultateve të të nxënit dhe pjesa "Literatura bazë dhe ndihmëse".*
*[152] Aneks 59.1. Vendim . 879, Datë 18.12.2019 Për Disa Ndryshime Dhe Shtesa Në Vendimin . 41, Datë 24.1.2018, Të Këshillit Të Ministrave*
*[153] Aneks 7. Rregullore e programit te studimit MP GTSH.*
*[154] Aneks 5. Rregullorja e UAMD , Kreu III , Neni 45.*
*[155] Aneks 6. Rregullore e Fakultetit të Biznesit, Kreu III, Neni 33.*
*[156] Aneks7, Rregullore e programit te studimit MP GTSH*
*[157] Aneks 59, VKM, 41, datë 24.1.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë".*
*[158] Aneks 59.1. Vendim . 879, Datë 18.12.2019 Për Disa Ndryshime Dhe Shtesa Në Vendimin . 41, Datë 24.1.2018, Të Këshillit Të Ministrave*
*[159] Aneks 59, VKM, 41, datë 24.1.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë".*
*[160] Aneks 59.1. Vendim . 879, Datë 18.12.2019 Për Disa Ndryshime Dhe Shtesa Në Vendimin . 41, Datë 24.1.2018, Të Këshillit Të Ministrave*
*[161] Aneks 59, VKM, 41, datë 24.1.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë".*
*[162] Aneks 59.1. Vendim . 879, Datë 18.12.2019 Për Disa Ndryshime Dhe Shtesa Në Vendimin . 41, Datë 24.1.2018, Të Këshillit Të Ministrave*
*[163] Aneks 59, VKM, 41, datë 24.1.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë".*
*[164] Aneks 59.1. Vendim . 879, Datë 18.12.2019 Për Disa Ndryshime Dhe Shtesa Në Vendimin . 41, Datë 24.1.2018, Të Këshillit Të Ministrave*

| | |
|---|---|
| | Në këtë program studimi janë vendosur një raport i drejtë mes mësimit teorik dhe formimit praktik, duke u fokusuar kryesisht në aspektet praktike, për një formim më të mirë të studentëve dhe një thellim të njohurive tyre në fushën e turizmit në profesionin e Guidës Turistike. Po kështu hartimi i kurrikulës ka pasur në fokus rritjen e nivelit të njohurive të studentëve, ofrimin e mundësive për një aftësim më profesional të tyre, dhe një qasje me nevojat e tregut shqiptarë për guidier profesionistë. |
| **Kriteri 7.** Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind. | **PO.** Programi i studimit GTSH është një program që ofrohet në fushën e turizmit me specifikë të ngushtë në fushën e udhërëfyesit turistik. Ky program studimi nuk ka një program të ngjashëm të tij që ofrohet nga institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë dhe si rrjedhim nuk ka ngjashmëri deri në masën 70% të saj me asnjë nga programet MP të guidës turistike.[167] Programe studimi të ngjashme MP në fushën e Guidës Turistike ofrohen edhe nga Universitete të ndryshme në vendet e OECD[168]. |
| **Kriteri 8.** Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit | **PO.** E gjithë struktura e programit të studimit MP GTSH është ndërtuar dhe shkon në pajtim me Ligjin për Arsimit e Lartë (80/2015)[169],[170] dhe Direktiva 2015/36 EC e Parlametit Europian dhe KE[171],[172].<br>I gjithë kodifikimit këtij programi studimi është realizuar sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e europiane. Hartimi dhe zbatimi i programit të studimit është në përputhje me kodifikimin e programit të studimit sipas kodifikimeve kombëtare mbështetur në Ligjin nr. 80/2015 dhe direktivave e udhëzimeve kombëtare e Europiane.[173],[174],[175]<br>Të gjitha lëndët që zhvillohen në këtë program studimi janë të Kodifikuara nga instancat e ligjshme përkatëse shtetërore në Shqipëri. Secila lëndë ka kodin e vet përkatës, që e dallon nga lëndët e tjera të programit dhe të çdo progami tjetër studimi. |
| **Kriteri 9.** Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi. | **PO.** Programi i studimit ofrohet si një program studimi vetëm i Departamentit të Turizmit në Fakultetin e Biznesit - Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës. Në politikat e institucionit është prioritet krijimi i programeve të përbashkëta midis institucioneve të arsimit të lartë vendas dhe të huaj. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

[165] *Aneks 59, VKM, 41, datë 24.1.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë".*
[166] *Aneks 59.1. Vendim . 879, Datë 18.12.2019 Për Disa Ndryshime Dhe Shtesa Në Vendimin . 41, Datë 24.1.2018, Të Këshillit Të Ministrave*
[167] *Aneks 58.1. Programe studimi të ngjashme me MP GTSH që ofrohen nga Insitucionet e Arsimit të Lartë në Shqipëri*
[168] *Aneks 58. Programe të përafërta studimi të ngjashme në institucionet ndërkombëtare me MP GTSH*
[169] *Aneks 53.1. Ligji i Arsimit te larte . 80, 2015*
[170] *Aneks 31. Kodifikimi programeve të studimit*
[171] *Aneks 53.1. Ligji i Arsimit te larte . 80, 2015*
[172] *Aneks 31. Kodifikimi programeve të studimit.*
[173] *Aneks 53.1. Ligji i Arsimit te larte . 80, 2015*
[174] *Aneks 61. VKM 531 date 11.09.2018, Per miratimin e Kodit te Cilesise se Arsimit te Larte*
[175] *Aneks 61.1 VKM .824, date 24.12.2021 , Per miratimin e Kodit te Cilesise se Arsimit te Larte*

| **Standardi II.2** | |
|---|---|
| **Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.** | |
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin. | **PO.** Programi i studimit për ciklin e dytë të studimeve MP GTSH ofrohet nga Departamenti i Turizmit me cilësinë e njësisë bazë pranë njësisë kryesore - Fakultetit të Biznesit, duke përmbushur të gjitha detyrimet ligjore dhe nënligjore lidhur me organizimin dhe strukturën akademike të tyre, të përcaktuara në aktet nënligjore[176] dhe rregulloret e programit të studimit MP GTSH [177,178,179,180]<br>Fakulteti i Biznesit dhe Departamenti i Turizmit, përgjegjëse për zbatimin e programit të studimit MP GTSH, përmbushin të gjitha detyrimet ligjore në lidhje me numrin e personelit akademik që ato kanë dhe në lidhje me shkallën e kualifikimit të personelit akademik.[181], [182], [183]<br>Fakulteti i Biznesit ka në përbërjen e tij 64 punonjës akademikë, nga të cilat 4 janë personel akademik me titull Prof. Dr; 10 personel akademik me titull Prof. Assoc.; 44 personel akademik me gradë shkencore Dr.; 6 personel akademik me gradën MSc.[184]<br>Departamenti i Turizmit si njësia bazë që ofron programin e studimit MP GTSH ka në përbërjen e tij 9 anëtare ku 8 me gradën shkencore Dr. dhe 1 me gradën Msc.[185]<br>Departamenti i Turizmit drejtohet nga përgjegjësi i departamentit, i cili ndjek në vazhdimësi zhvillimin, zbatimin e programit dhe kontrollin e tij. Gjithashtu, Përgjegjësi i Njësisë Bazë drejton të gjithë veprimtarinë mësimore dhe shkencore në departament dhe kryerjen e praktikave profesionale në përputhje me objektivat e caktuara në program[186]. Përgjëgjësi i departamentit informohet rregullisht për ecurinë e programit dhe arritjen e objektivave të tij nga koordinatori i programit dhe njëkohësisht informon departamentin dhe dekanin e FB për ecurinë dhe problematikat në lidhje me ecurinë e programit.[187]<br>Përgjegjësi i drejtpërdrejtë për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programit është koordinatori i programit [188]. Koordinatori i Programit të studimit përgjigjet për përmbushjen e misionit të Masterit Profesional GTSH dhe ka përgjegjësi të drejtpërdrejtë për veprimtarinë e gjithanshme të tij[189].<br>UAMD ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional në vitin 2022 përpara aplikimit për akreditimin e programit[190] të studimit Master Profesional GTSH.<br>Rregullore e FB përcakton që FB harton politika dhe proçedura për sigurimin e brendshëm të cilësisë. FB përdor instrumente të përshtatshme |

[176] *Aneks 2. Statuti i UAMD, Kreu V neni 45, neni 46, neni 47.*
[177] *Aneks 5. Rregullore e UAMD*
[178] *Aneks 6. Rregullore e Fakultetit të Biznesit, Kreu II, Neni 19.*
[179] *Aneks 6.1. Rregullore e Departamentit Turizmit*
[180] *Aneks 7. Rregullore e programit te studimit MP GTSH*
[181] *Aneks 5. Rregullore e UAMD*
[182] *Aneks 6. Rregullore e Fakultetit të Biznesit, Kreu II, Neni 19.*
[183] *Aneks 6.1. Rregullore e Departamentit Turizmit*
[184] *Aneks 23. Të dhëna tabelare për personelin akademik në Njësinë Kryesore dhe Njësinë Përgjegjëse*
[185] *Aneks 24. Të dhëna tabelare për personelin akademik në programin e studimit*
[186] *Aneks 7. Rregullore e programit të studimit MP GTSH, Kreu II, Neni 12*
[187] *Aneks 2. Statuti i UAMD, Kreu 6, Neni 63*
[188] *Aneks 36. Vendim Koordinatoret e programeve te studimit Bch dhe MP, 2021*
[189] *Aneks 7. Rregullore e programit të studimit MP për GTSH, Kreu II, Neni 11*
[190] *Aneks 5. Rregullorja e UAMD , Kreu III. https://ascal.al/sq/bord-i akreditimit/vendimet/vendimet e mbledhjes-24-mars-2022*

| | |
|---|---|
| | për sigurimin e cilësisë. Kjo Njësi Kryesore ka njësinë e tij të sigurimit të brendshëm të cilësisë akademike, e cila monitoron në mënyrë të vazhdueshme dhe vlerëson periodikisht rezultatet e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore që ofrohen nga Njësitë Bazë, nga të cilat ajo përbëhet[191]. Standardet për sigurimin e cilësisë që hartohen nga FB, janë në përputhje me Kodin e Cilësisë të hartuar nga ASCAL dhe MASR[192]. |
| **Kriteri 2. .** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik / administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.. | **PO.** Fakulteti i Biznesit si njësi kryesore, pjesë e të cilit është Departamenti i Turizmit, përmbushin të gjithë detyrimet ligjore dhe nënligjore lidhur me angazhimin e personelit akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, siç është i përcaktuar në aktet nënligjore[193] dhe rregulloret e studimit[194],[195].<br>Departamenti i Turizmit, i cili është njësia përgjegjëse për zbatimin e këtij program studimi, përmbush të gjithë detyrimet ligjore dhe nënligjore lidhur me organizimin dhe strukturën akademike dhe ndihmëse të tij për realizimin e proçeseve mësimore laboratorike dhe praktika mësimore[196], [197].<br>Pranë njësisë kryesore zhvillohen projekte kërkimore ku përfshihen edhe studentët si dhe projekte të mobiliteteve apo te shkembimit të cilat shërbejne për zgjerimin e njohurive nëpërmjet shkëmbimit të studentëve e të stafit akademik[198],[199]. |
| **Kriteri 3.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. | **Po.** Departamenti i Turizmit ka të emëruar një kordinator për programin e studimit Master Profesional GTSH, i cili është zgjedhur nga asambleja e departamentit dhe emëruar nga Përgjegjësi i Departamentit[200] . Detyrat detyrimet e tij janë të përcaktuara qartë në Rregulloren e Programit të Studimit[201]. Departamenti i Turizmit nëpërmjet koordinatorit të tij raporton në mënyrë periodike dokumentacione me informacionin e plotë në lidhje me programin e studimit Master Profesional [202],[203] GTSH bazuar në Statutin e UAMD[204] rregulloren e FB[205] dhe ne Ligjin 80/2015 për Arsimin e Lartë[206] dhe aktet e tjera nënligjore në fuqi[207],[208]. |
| | |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

[191] *Aneks 6. Rregullore e Fakultetit të Biznesit, Kreu III, Neni 33.*
[192] *Aneks 8. Rregullore e NJSBC Kreu III Neni 11.*
[193] *Aneks 2. Statuti i UAMD, Kreu V neni 52.*
[194] *Aneks 6. Rregullore e Fakultetit të Biznesit, Kreu II, neni 22.*
[195] *Aneks 6.1. Rregullore e Departamentit Turizmit*
[196] *Aneks 7. Rregullore e programit të studimit MP GTSH.*
[197] *Aneks 22. CV e Stafit Ndihmës Akademik*
[198] *Aneks 124. Praktikë thirrje për mobilitete.*
[199] *Aneks 126 Praktikë për mobilitet të personelit të UAMD*
[200] *Aneks 36. Vendimi për emërimin e Koordinatorit të programit të studimit.*
[201] *Aneks 7. Rregullore e programit te studimit MP në GTSH, Kreu II, neni 11.*
[202] *Aneks 7 Rregullore e programit te studimit, Raport i vleresimit.*
[203] *Aneks 36 Vendimi për emërimin e Koordinatorit të programit të studimit.*
[204] *Aneks 2. Statuti i UAMD.*
[205] *Aneks 6 Rregullore e Fakultetit të Biznesit, Kreu II, Neni 16.*
[206] *Aneks 53.1. Ligji i Arsimit te larte . 80, 2015*
[207] *Aneks 59. VKM .41 datë 24.01.2018 "Për elementët e programit të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë*
[208] *Aneks 59.1. Vendim . 879, Datë 18.12.2019 Për Disa Ndryshime Dhe Shtesa Në Vendimin . 41, Datë 24.1.2018, Të Këshillit Të Ministrave*

| **Standardi II.3**<br><br>**Programi i studimit MP është i detajuar, informues, i strukturuar dhe i organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit. | **PO.** Fakulteti i Biznesit dhe Departamenti i Turizmit, përgjegjëse për zbatimin e këtij programi studimi të ciklit të dytë Master Profesional GTSH disponojnë të gjithë informacionin e nevojshëm për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit që kërkohet nga ligji[209]. Ky aspekt pasqyrohet mjaft qartë në Statutin e UAMD[210], Rregulloren e UAMD[211], Rregulloren e Studimeve në nivel Fakulteti[212], në Rregulloren e programit të studimit GTSH[213] dhe në nivel departamenti[214].<br>Programi i studimit Master Profesional GTSH është i organizuar konform përcaktimeve ligjore në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore[215].[216] Programi i studimit është i organizuar dhe i ndarë në lëndë e module, praktika e aktivitete formuese gjë e cila pasqyrohet në planin mësimor e kurrikulën e studimeve[217],[218]. |
| **Kriteri 2.** . Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit. | **PO.** Plani mësimor buron nga kurrikula e programit e zbërthyer nëpërmjet syllabuseve të lëndëve/moduleve përkatëse. Ai është një dokument zyrtar dhe ligjor i cili përgatitet nga Departamenti i Turizmit, Njësia Bazë ku zhvillohet ky program studimi, miratohet nga Dekani i Fakultetit të Biznesit dhe Rektori i UAMD-së dhe është i detyrueshëm për zbatim për të gjithë studentët, stafin akademik, ndihmës akademik dhe administrativ[219],[220].<br>Në planin mësimor pasqyrohet në mënyrë të detajuar informacioni për emërtimin e lëndëve/moduleve, numrin e krediteve për secilën lëndë apo modul, semestri në të cilin zhvillohet lënda, raporti i orëve (leksione/seminare), detyrimet e modulit (seminare, ushtrime, projekte kursi, detyra kursi, detyra kontrolli), vlerësimi i studentit, periudha e kontrollit të dijeve, mënyra e vlerësimit të dijeve dhe mënyra e zhvillimit të provimit (me shkrim, me gojë, ose me shkrim dhe me gojë). Në të pasqyrohet ngarkesa mësimore, orët që kryhen në auditor, orët jashtë auditorit, frekuentimin, ndjekjen e programit dhe aftësimin praktik të studentëve. I gjithë ky informacion, i cili disiplinon të gjithë veprimtarinë mësimore në kuadër të zbatimit të këtij programi studimi është pjesë e dosjes së plotë të programit të studimit[221],[222]. |

[209] *Aneks 53.1. Ligji i Arsimit te larte . 80, 2015*
[210] *Aneks 2. Statuti i UAMD*
[211] *Aneks 5. Rregullorja e UAMD*
[212] *Aneks 6. Rregullore e Fakultetit të Biznesit, Kreu III, 29, 30*
[213] *Aneks 7. Rregullore e programit te studimit MP GTSH*
[214] *Aneks 6.1. Rregullore e Departamentit Turizmit*
[215] *Aneks 6. Rregullore e Fakultetit të Biznesit, Kreu III.*
[216] *Aneks 7. Rregullore programit të studimit MP GTSH..*
[217] *Aneks 14. Aplikimi MP GTSH.*
[218] *Aneks 14.1. Riorganizimi MP GTSH, 2020*
[219] *Aneks 14. Aplikimi MP GTSH*
[220] *Aneks 14.1. Riorganizimi MP GTSH, 2020*
[221] *Aneks 14. Aplikimi MP GTSH.*
[222] *Aneks 14.1. Riorganizimi MP GTSH, 2020*

| | |
|---|---|
| | Zbatimi i elementëve të planit mësimor është përgjegjësi e stafit akademik të programit të studimit dhe shprehet në ngarkesën e plotë mësimore që ai duhet të kryejë në zbatim të detyrimeve ligjore në fuqi[223], [224], [225], [226].<br>Mësimi organizohet me orë mësimore, ku çdo orë mësimore në këtë program studimi zgjat 50 minuta. Totali i orëve që bën studenti, në auditor dhe si punë e pavarur, konvertohet në kredite, ku 1 ECTS = 25 orë mësimore punë e studentit. Sasia e krediteve shprehen në programin mësimor për secilën lëndë të ndarë sipas aktiviteteve leksion, seminare, punë laboratorike dhe praktika.<br>Organizimi i programit të studimit (1 vit, 2 semestra, javë etj.).<br>• 1 vit akademik ka 30 javë mësimore në auditor<br>• 1 Semestër ka 15 javë mësimore në auditor<br>• 1 ECTS 25 orë mësimore punë të studentit<br>• 1 orë mësimore zgjat 50 minuta. |
| **Kriteri 3.** Programi i studimit përmban informacionin e nevojshëm për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. | **PO.** Programi i studimit Master Profesional GTSH zbaton Rregulloren e Studimeve të Universitetit UAMD-së[227], Rregulloren e Brendshme të Fakultetit të Biznesit[228], Rregullore e Departamentit të Turizmit[229] dhe Rregulloren e programit të studimit Master Profesional GTSH[230]. Në këto rregullore ndodhen të gjitha informacionet e nevojshme që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Studentëve që ndjekin këtë program studimi i vendosen këto rregullore në dispozicion sapo fillon proçesi mësimorë, në orën e parë, nga stafi akademik.<br>Programi i studimit është i hapur dhe transparent me publikun. Për ta bërë atë sa më atraktiv për studentët me qëllim tërheqjen e tyre, ai përdor politika marketingu që lidhen më rritjen e transparencës përballë publikut[231]. |
| **Kriteri 4.** Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminaret apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara | **PO.** Kurrikula e programit të studimit Master Profesional në GTSH i përgjigjet misionit dhe objektivave të Departamentit të Turizmit. Përputhshmëria e ndërtimit të kurrikulës me këto synime evidentohet në objektivat e detajuara që ka secila kategori e grup lëndësh dhe e lëndëve të veçanta që përbëjnë programin, të cilat dallohen për nivelin e lartë e bashkëkohor të informacionit që sjellin për studentët si dhe në një renditje logjike të tyre në funksion të formimit të studentëve sipas profilit përkatës, duke mos krijuar përsëritje të tyre, por duke dhënë një informacion të detajuar për destinacionet arkeologjike, kulturore, natyrore që vizitohen nga turistët, për menaxhimin e tureve dhe grupeve turistike[232], [233].<br>Plani mësimor i programit të studimit, i hartuar për zbatimin e |

[223] *Aneks 23. Të dhëna Tabelore për Personelin Akademik në Njësinë Kryesore dhe në Njesinë Përgjegjëse*
[224] *Aneks 24. Të dhëna tabelare per personelin akademik të programit të studimit*
[225] *Aneks 25. Të dhëna tabelare për personelin akademik*
[226] *Aneks 93. Udhezimi29,dt.10.9.2018 i MASR , "për ngarkesën mësimore vjetore"..*
[227] *Aneks 5. Rregullorja e UAMD , Kreu III, neni 56,57*
[228] *Aneks 6. Rregullore e Fakultetit të Biznesit, Kreu III neni 42, 43, 44.*
[229] *Aneks 6.1. Rregullore e Departamentit Turizmit*
[230] *Aneks 7. Rregullore e programit të studimi MP GTSH.*
[231] *Aneks 51. Politika e marketing-ut të programit të studimit.*
[232] *Aneks 5. Rregullorja e UAMD, Kreu III, neni 60,61,62,63,68,69,70.*
[233] *Aneks 6. Rregullore e Fakultetit të Biznesit, Kreu III, nga neni 46 deri te neni 55.*

| | |
|---|---|
| | kurrikulës modern nga stafi akademik dhe studentët, mbështetet në programet lëndore ose Syllabuset[234], [235]. Syllabuset përmbajnë informacione të përgjithshme për studentin si: [236], [237]<br>• Titulli i lëndës/modulit<br>• Emrin e titullarit që e zhvillon<br>• Ngarkesën në orë dhe kredite<br>• Tipologjinë e lëndës (kategorinë)<br>• Vitin dhe semestrin kur zhvillohet lënda<br>• Llojin e lëndës<br>• Programin mësimor të cilit i përket<br>• Kodin e lëndës/modulit<br>• Adresën elektronike të titullarit të lëndës.<br>• Përmbledhje dhe rezultatet e të nxënit, koncepte themelore mbi të cilat ndërtohet lënda<br>• Temat e lëndës, ndarë në javë sipas semestrit, praktikat, seminaret apo orët e laboratorit<br>• Format e kontrollit të dijeve (masën e frekuentimit dhe mënyrat e kontrollit të vazhdueshëm, mënyrën dhe peshën e vlerësimit), shoqëruar në fund nga burimet e literaturës bashkëkohore e të përditësuar në mbështetje të programit të lëndës[238], [239].<br>Syllabuset, me të gjithë elementët e mësimit që përmbajnë janë hartuar në përputhje me formatet ligjore të përcaktuara[240], [241]. Syllabuset e lëndëve hartohen nga titullari i lëndës/modulit, shqyrohet në departament dhe miratohet nga përgjegjësi i departamentit dhe dekani i Fakultetit të Biznesit. Në fillim të çdo semestri, pedagogu që zhvillon modulin harton planin kalendar të ndarë në javë dhe orë mësimore sipas planit mësimor të miratuar[242], [243].<br>Dosja e plotë e programit të studimit në GTSH përmban të gjitha informacionet e detajuara për programet lëndore/syllabuset të cilët përmbajnë të gjithë elementët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit, formatuar në përputhje me formatet e miratuara nga aktet nënligjore[244], [245]. |
| **Kriteri 5.** Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe në anglisht. | **PO.** Programi i studimit Master Profesional në GTSH është viti i tretë që zhvillon proçesin mësimor dhe përmban syllabuset bashkohore që prej vitit akademik 2018-2019, qe ne fazen e aplikimit e deri në vitin aktual akademik 2022-2023[246], [247], [248], [249], [250]. Gjatë këtyre viteve, kurikula ka pësuar ndryshime |

[234] Aneks 59. VKM .41 datë 24.01.2018 "Për elementët e programit të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë, pika 2.8 Syllabuset.

[235] Aneks 59.1. Vendim . 879, Datë 18.12.2019 Për Disa Ndryshime Dhe Shtesa Në Vendimin . 41, Datë 24.1.2018, Të Këshillit Të Ministrave

[236] Aneks 19. Silabuset e lendeve ne fazen e aplikimit fillestar

[237] Aneks 67. Silabuset e reja me ndryshimet pas riorganizimit nën 20% MP GTSH

[238] Aneks 19. Silabuset e lendeve ne fazen e Aplikimit fillestar

[239] Aneks 67. Silabuset e reja me ndryshimet pas riorganizimit nën 20% MP GTSH

[240] Aneks 19. Silabuset e lendeve ne fazen e Aplikimit fillestar

[241] Aneks 67. Silabuset e reja me ndryshimet pas riorganizimit nën 20% MP GTSH

[242] Aneks 14. Aplikimi MP GTSH

[243] Aneks 14.1. Riorganizimi MP GTSH, 2020

[244] Aneks 19. Silabuset e lendeve ne fazen e Aplikimit fillestar

[245] Aneks 67. Silabuset e reja me ndryshimet pas riorganizimit nën 20% MP GTSH

[246] Aneks 5. Rregullorja e UAMD

[247] Aneks 6. Rregullore e Fakultetit të Biznesit, Kreu III , Neni 33.

[248] Aneks 6.1. Rregullore e Departamentit Turizmit

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | deri në masën 20% në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore[251],[252]. | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | X |

| | |
|---|---|
| **Standardi II.4**<br><br>**Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.** | |
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve. | **PO.** Masteri Profesional në GTSH u ofron studentëve mundësinë e thellimit dhe zhvillimit të dijeve si dhe aftësive praktike e profesionale në fushën e guidave turistike. Njohja me burimet natyrore, kulturore, arkeologjike bashkëngjitur me njohuritë menaxhuese dhe marketuese të destinacioneve turistike, krijon premisa për guida më të specializuara në territorin shqiptar. Praktikat mësimore dhe terminologjia në gjuhën e huaj, pajisin studentin me njohuritë e nevojshme për të konkurruar në tregun turistik[253].<br>Programi Master Profesional në GTSH ofron njohuri të mira në fushën e turizmit duke rritur mundësitë për karrierë profesionale si guidë në terren, si guidë pranë një Tour Operatori apo agjencie turistike.<br>Duke zhvilluar aftësi teknike, ndërpersonale dhe konceptuale bën të mundur punësimin e të diplomuarve në biznese të llojeve dhe dimensioneve të ndryshme të industrisë së turizmit, si: pranë agjensive turistike të sektorit privat, në Muze Historik dhe Arkeologjik, në Parqe Arkeologjike dhe Natyrore, në tur qytetesh, Freelance, Agjensia Kombëtare e Turizmit (AKT), Shoqata Shqiptare e Turizmit (ATA), Shoqata Kombëtare e Guidave Turistike të Shqipërisë (NATGA), Guida profesionale pranë Drejtorive Rajonale të Kulturës Kombëtare (DRKK), Unioni Turistik Shqiptar (UTSH) etj [254],[255],[256]. |
| **Kriteri 2.** Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe | **PO.** Kurrikula në funksion të plotësimit të objektivit kryesor të programit të studimit, është e organizuar me te gjitha kategoritë e lëndëve sipas përcaktimeve ligjore[257],[258] e organizuar në: -lëndë bazë të detyrueshme; - lëndët karakterizuese, - lëndën ndërdisiplinore dhe / ose integruese në një ose më shumë grupe disiplinash, - lëndë me zgjedhje, lëndët plotësuese dhe detyrimet përmbyllëse[259],[260]. |

[249] *Aneks 7. Rregullore e programit të studimi MP GTSH.*
[250] *Aneks 14. Aplikimi MP GTSH*
[251] *Aneks 14. Aplikimi MP GTSH*
[252] *Aneks 14.1. Riorganizimi MP GTSH, 2020.*
[253] *Aneks 14. Aplikimi MP GTSH.*
[254] *Anesksi 16. Studimi i tregut para hapjes së Programit MP GTSH*
[255] *Aneks 17. Studim i tregut te punes pas hapjes se programit*
[256] *Aneks 29. Të dhëna tabelare mbi punësimin real te studentëve të MP GTSH*
[257] *Aneks 59. VKM .41 datë 24.01.2018 "Për elementët e programit të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë*
[258] *Aneks 59.1. Vendim . 879, Datë 18.12.2019 Për Disa Ndryshime Dhe Shtesa Në Vendimin . 41, Datë 24.1.2018, Të Këshillit Të Ministrave*
[259] *Aneks 14. Aplikimi MP GTSH*
[260] *Aneks 14.1 Riorganizimi MP GTSH, 2020.*

| | |
|---|---|
| kërkimit shkencor.. | Kurrikula përbëhet nga 8 lëndë + praktikën profesionale + mikrotezën të cilat sipas planit mësimor të këtij programi studimi janë ndarë në dy semestra. Semestri i parë ka 6 lëndë (34 kredite) ku ndërthuren lëndët bazë, lëndët karakterizuese, integruese dhe plotësuese. Semestri i dytë ka 2 lëndë (26 kredite), praktikën profesionale dhe përgatitjen e mikrotezës. Kjo mënyrë e organizimit të planit mësimor më të gjithë elementët e tij mundëson arritjen e objektivave formuese të programit dhe të rezultateve të pritshme të të nxënit[261],[262].<br>Ky strukturim i programit të studimit jep njohuri dhe rrit aftësimin profesional të studentëve. Programi është në shërbim të formimit të kërkuar të studentëve në fushën e turizmit dhe nevojave të tregut të punës për Guida profesionale në terren[263],[264]. |
| **Kriteri 3.** Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme | **PO.** Programi i studimit Master Profesional GTSH është i strukturuar sipas përcaktimeve ligjore, me kategori të veprimtarive formuese, ku peshën kryesore e kanë lëndët/modulet karakterizuese profesionale, të cilat janë tërësisht në përputhje me profilin e programit[265],[266].<br>Lëndët, modulet dhe emërtimi i tyre në këtë program janë në përputhje me drejtimin dhe profilin e studimit për ciklin e dytë të studimeve Master Profesional në fjalë pasi kanë njohuritë e duhura për ti formuar studentët që e ndjekin.<br>Ngarkesa që ai përmban në orë mësimore (1500 orë) dhe kredite (60 Kredite ECTS), i përmbahen përcaktimeve ligjore për një cikël të dytë studimi[267],[268],[269].<br>Programi i studimit MP GTSH është i përafërt me programe të tjera të ngjashme Kombëtare[270] ndërkombëtare në vendet e BE dhe Rajonit tonë[271].<br>Raporti teori praktikë në kurrikulën e këtij masteri është në përputhje të plotë më plotsimin e objektivave kryesore që ka ky program studimi ku përvec 1( një) lënde të vecantë të nominuar me emrin "praktikë mësimore" edhe secila nga disiplinat në syllabus ka si aspektin teorik ashtu edhe praktikën për ta zhvilluar në terren[272],[273]. Kjo mënyrë organizmi mundëson një formim më të mirë profesional të studentëve duke i pajisur ata me kompetenca dhe aftesi profesionale të thelluara[274],[275]. |
| **Kriteri 4.** Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të | **PO.** Në programin e studimit, Master Profesional në GTSH ndarja e veprimtarive formuese, e cila jepet e detajuar në planin mësimor dhe e përcaktuar në syllabuset e lëndëve e moduleve, është bërë duke ruajtur një raport teori – praktikë të ekuilibruar. Baza e këtij ekuilibri krijon |

261 *Aneks 14. Aplikimi MP GTSH*
262 *Aneks 14.1. . Riorganizimi MP GTSH, 2020.*
263 *Anesksi 16. Studimi i tregut para hapjes së Programit MP GTSH*
264 *Aneks 17. Studim i tregut te punes pas hapjes se programit*
265 *Aneks 14. Aplikimi MP GTSH*
266 *Aneks 14.1. . Riorganizimi MP GTSH, 2020.*
267 *Aneks 53.1. Ligji i Arsimit te larte . 80, 2015*
268 *Aneks 59. VKM .41 datë 24.01.2018 "Për elementët e programit të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë, pika 2.8 Syllabuset.*
269 *Aneks 59.1. Vendim . 879, Datë 18.12.2019 Për Disa Ndryshime Dhe Shtesa Në Vendimin . 41, Datë 24.1.2018, Të Këshillit Të Ministrave*
270 *Aneks 58.1. Programe studimi të ngjashme me MP GTSH që ofrohen nga Insitucionet e Arsimit të Lartë në Shqipëri*
271 *Aneks 58. Programe të përafërta studimi të ngjashme në institucionet ndërkombëtare me master profesiona "Guida Turistike Shqiptare"*
272 *Aneks 19. Silabuset e lendeve ne fazen e Aplikimit fillestar*
273 *Aneks 67. Silabuset e reja me ndryshimet pas riorganizimit nën 20% MP GTSH*
274 *Aneks 14. Aplikimi MP GTSH*
275 *Aneks 14.1. Riorganizimi MP GTSH, 2020.*

| | |
|---|---|
| studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve. | mundësinë për një formim të plotë të studentëve, sipas drejtimit dhe profilizimit dhe objektivave formues të programit, gjë e cila u mundëson atyre transferimin e studimeve në institucione të tjera[276], [277].<br>Ky program studimi peshën e rëndësisë e ka tek veprimtaritë formuese, të cilat përfaqësojnë disiplina të formimit karakterizues, Interdisiplinare dhe Plotësuese (73%) të kurrikulës. |
| **Kriteri 5.** Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.. | **PO.** Syllabuset e Programit të Studimit Master Profesional në GTSH i hapur në vitin akademik 2018-2019, janë hartuar dhe referojnë një literaturë të rifreskuar të 5 viteve të fundit[278], [279], [280].<br>Njëkohësisht në disa lëndë ka koncepte bazë të rëndësishme zbërthimi i të cilave mbështetet në një literaturë themelore më të hershme se 5 vitet e fundit. |
| **Kriteri 6.** Përmbajtja e programit të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara. | **PO.** Programi i studimit Master Profesional në GTSH është një program i plotë dhe në funksion të qëllimit për të cilin është hartuar: dhënia e dijeve, aftësive dhe kompetencave profesionale në guidë turistike studentëve[281]. Programi është ndërtuar dhe ka në përmbajtjen e tij lëndë e module specifike të veprimtarive formuese, ku dominojnë disiplinat e formimit karakterizues, por edhe disiplina interdisiplinore dhe plotësuese, të cilat krijojnë të gjitha kushtet për arritjen e objektivave që synon programi i ciklit të dytë të studimeve Master Profesional[282], [283].<br>Përmbajtja e programit u mundëson dhe u garanton studentëve përfitimin e dijeve, fitimin e aftësive dhe kompetencave profesionale që do tu shërbejnë kur të punësohen në të ardhmen. Këto aspekte përbëjnë synimet kryesore të këtij programi studimi MP GTSH të përcaktuara edhe në Rregulloren e studimeve të programit[284].<br>Përmbajtja e syllabuseve të lëndëve, të cilat japin në mënyrë të detajuar elementet e çdo lënde për formimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave, shprehet nëpërmjet temave që zhvillohen gjatë trajtimit të disiplinave përkatëse[285], [286]. |
| **Kriteri 7.** Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës. | **PO.** Programi Master Profesional në GTSH ofron njohuri të mira në fushën e turizmit, në veçanti për Guidë, duke mundësuar ngritje dhe arritje në karrierën profesionale në nivel rajonalë e kombëtarë [287], [288].<br>Nga zhvillimi i aftësive teknike, ndërpersonale dhe konceptuale studentët e diplomuar[289], [290], [291], [292] mund të punësohen:<br>➢ Në biznese të llojeve dhe dimensioneve të ndryshme të industrisë së turizmit, si: pranë agjensive turistike të sektorit privat: Agjensia Kombëtare e Turizmit (AKT), Shoqata |

[276] *Aneks 14. Aplikimi MP GTSH*
[277] *Aneks 14.1. . Riorganizimi MP GTSH, 2020.*
[278] *Aneks 7. Rregullore e programit të studimi MP GTSH.*
[279] *Aneks 19. Silabuset e lendeve ne fazen e Aplikimit fillestar: Pjesa "Literatura bazë dhe ndihmëse"*
[280] *Aneks 67. Silabuset e reja me ndryshimet pas riorganizimit nën 20% MP GTSH: Pjesa "Literatura bazë dhe ndihmëse"*
[281] *Aneks 7. Rregullore e programit të studimi MP GTSH*
[282] *Aneks 14. Aplikimi MP GTSH*
[283] *Aneks 14.1. Riorganizimi MP GTSH, 2020.*
[284] *Aneks 7. Rregullore e programit të studimi MP GTSH*
[285] *Aneks 19. Silabuset e lëndëve në fazën e Aplikimit fillestar: Pjesa "Temat e Lëndës"*
[286] *Aneks 67. Silabuset e reja me ndryshimet pas riorganizimit nën 20% MP GTSH: Pjesa "Temat e Lëndës"*
[287] *Aneks 19. Silabuset e lendeve në fazën e Aplikimit fillestar: Pjesa "Përmbledhje dhe rezultatet e të nxënit"*
[288] *Aneks 67. Silabuset e reja me ndryshimet pas riorganizimit nën 20% MP GTSH: Pjesa "Përmbledhje dhe rezultatet e të nxënit"*
[289] *Anesksi 16. Studimi i tregut para hapjes së Programit MP GTSH*
[290] *Aneks 17. Studim i tregut te punes pas hapjes se programit*
[291] *Aneks 29. Të dhëna tabelare mbi punësimin real te studentëve të MP GTSH*
[292] *Aneks 12. Regullore Sekt. i Komunikimit, Alumnit & Karrierës*

| | |
|---|---|
| | Shqiptare e Turizmit (ATA), Shoqata Kombëtare e Guidave Turistike të Shqipërisë (NATGA), Unioni Turistik Shqiptar (UTSH), në Tour Operatorët shqiptarë, në hotele që punësojnë guida,<br>➢ Si Freelance.<br>➢ Në sektorin publik si në: Guida profesionale pranë Drejtorive Rajonale të Kulturës Kombëtare (DRKK), Muzetë Arkeologjikë Shqiptarë si: Muzeu Arkeologjik i Durrësit, Muzeu Arkeologjik i Tiranës etj., në Muzetë Historik si: Muzeu Historik Kombëtarë në Tiranë, Muzeu i Pavarsisë në Vlorë, Muzeu Historik i Krujës, Muzeu i Ikonave në Korçë etj. Në Muzetë Etnografik si: Muzeu Etnografik në Durrës, Muzeu etnografik në Shkodër etj.Gjithashtu, studentët që mbarojnë këtë program mund të punësohen në Parqet Arkeologjike si: Parku Arkeologjik i Bitrintit, Parku Arkeologjik i Durrësit, Parku Arkeologjik i Antigoneas, Parku Arkeologjik i Antigoneas, Parku Arkeologjik i Bylisit dhe si guida në monumete të shumta të kategorisë I dhe II që mbrohen nga shteti shqiptarë e vizitohen nga turistët. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi II.5**<br><br>**Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës. | **PO.** Njësia Bazë, në këtë rast Departamenti i Turizmit, në funksion të realizimit të programit të studimit Master Profesional GTSH, ka siguruar dhe garanton pjesëmarrjen dhe angazhimin e studenteve ne panirin e karrierës[293],[294] si dhe në aktivitete të ndërtimit të kapaciteteve apo të ndërveprimit praktik me palët e treta si pjesë e transferimit të njohurive si dhe punësimit të tyre.<br>Në këtë kontekst, gjatë këtyre takimeve departamenti konsultohet dhe merr parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës për të përmirësuar dhe përshtatur kurrikulën e këtij program sa më afër kërkesave të propozuara nga bashkëpunëtorët dhe partnerë të tregut të punës[295],[296],[297],[298]. Në këtë mënyrë, synohet të arrihet një kurrikul sa më cilësore për këtë program studimi |
| **Kriteri 2.** Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe | **PO.** Departamenti i Turizmit, në funksion të përmirësimit të programit të studimit Master Profesional GTSH, ka siguruar dhe garanton |

[293] *Aneks 16. Studimi i tregut para hapjes së Programit MP GTSH*
[294] *Aneks 17. Studim i tregut te punes pas hapjes se programit*
[295] *Aneks 16. Studimi i tregut para hapjes së Programit MP GTSH*
[296] *Aneks 17. Studim i tregut te punes pas hapjes se programit*
[297] *Aneks 29. Të dhëna tabelare mbi punësimin real te studentëve të MP GTSH*
[298] *Aneks 12. Regullore Sekt. i Komunikimit, Alumnit & Karrierës*

| | |
|---|---|
| konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit. | pjesëmarrjen dhe angazhimin e studenteve në diskutime të hapura për të përmirësuar aspektet praktike të lidhura me formimin teorik e tyre[299].<br>Përfaqësues të studentëve që ndjekin këtë program, si kundër edhe në programet e tjera, janë anëtarë të Komisionit të Sigurimit të Cilësisë, Programeve të Studimit dhe Kërkimit Shkencor. Përfaqësuesi i studentëve ka të drejtë të barabartë vote dhe lirie në shprehje mendimesh me stafin akademik, anëtarë të komisioneve. Në këtë mënyrë, synohet shprehja e mendimit të studentëve për të përmirësuar vazhdimisht programin e studimit[300].<br>Institucioni ku zhvillohet ky program studimi, ku bën pjesë edhe Departamenti i Turizmit, që nga vitit akademik 2018-2019, mban kontakte të vazhdueshme me studentët e diplomuar. Kjo gjë realizohet me anë të një database të tyre pas mbarimit të ciklit të parë të studimeve lidhur me Alumnin[301],[302],[303],[304],[305].<br>Gjithashtu, Departamenti i Turizmit dhe UAMD organizojnë vazhdimisht gjatë vitit akademik anketa periodike me pyetësorë edhe me studentët e MP GTSH, për të kuptuar problematikat dhe vështirësitë. Në këtë mënyrë, Departamenti i Turizmit dhe UAMD përpiqen të përmirësojnë vazhdimisht problematikat me të cilat studentët ndeshen kur frekuentojnë programin[306],[307],[308],[309],[310].<br>Pyetësorët për cilësinë e programit dhe stafit akademik e administrativ realizohen nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) në UAMD, institucioni përkatës ligjorë për kontrollin dhe përmirësimin e cilësisë së kurrikulave në UAMD”[311],[312], [313],[314],[315]. NJSBC vepron mbi bazën e rregullores së saj për kontrollin dhe përmirësimin e programit të Studimit[316]. |
| **Kriteri 3.** Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private. | **PO.** Departamenti i Turizmit, pjesë e UAMD, për të realizuar këtë program studimit Master Profesional mban bashkëpunim me institucione kërkimore e shkencore, publike e private, njësitë e pushtetit vendor dhe qendrorë. Në kontakte me këto partnerë, institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programin në koherencë me nevojat që orienton tregu i punës[317]. Ky përditësim realizohet edhe me anë të riorganizimeve nën 20%, sic ndodhi në riorganizimin e bërë në vitin 2019-2020, ku MP GTSH u riorganizua për tju përshtatur më mirë tregut të punës për studentët[318],[319]. |

[299] *Aneks 33. Tabelë përmbledhëse me studentët e trajnuar.*
[300] *Aneks 30. Të dhëna tabelare për njësitë, individët e studentët të angazhuar në Sistemin e Sigurimit të brendshëm të cilësisë*
[301] *Aneks 51. Politika e marketingut te programit te studimit: Pjesa - Alumni.*
[302] *Aneks 51.2. Takim Alumni Turizëm 2018 -2019*
[303] *Aneks 51.3. Takime Alumni 2019-2020*
[304] *Aneks 12. Regullore Sekt. i Komunikimit, Alumnit & Karrierës*
[305] *Aneks 134. Shoqata Alumni UAMD dhe Aktivitetet*
[306] *Aneks 66. Informacion mbi rezultatet e vleresimit te stafit akademik nga studentet, v.a 2021-22*
[307] *Aneks 40. Formati i Pyetesorit për pedagogët nga studentët*
[308] *Aneks 71. Vleresimi i stafit akademik nga studentet, 2021-22*
[309] *Aneks 72. Përmbledhja e pyetësorit Google Form i përdorur me studentët e MP GTSH*
[310] *Aneks 72.1 Modeli i formularit te vleresimit ne Google Form*
[311] *Aneks 2 Statuti i UAMD*
[312] *Aneks 5. Rregullorja e UAMD*
[313] *Aneks 6. Rregullore e Fakultetit të Biznesit, Kreu III , Neni 33.*
[314] *Aneks 6.1. Rregullore e Departamentit Turizmit*
[315] *Aneks 7. Rregullore e programit të studimi MP GTSH.*
[316] *Aneks 8. Rregullore për Funksionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë*
[317] *Aneks 55. Strategjia e Kërkimit Shkencor , Vendim 710, datë 1.12.2017.*
[318] *Aneks 57.1 Shkresa per Senatin Akademik per riorganizimin e MP në GTSH*
[319] *Aneks 57/2 Shkresa e Ministrise se arsimit per miratimin e riorganizimit te MP GTSH*

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | X |

| **Standardi II.6**<br><br>**Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit. | **PO.** Programi i studimit Master Profesional GTSH ka të përcaktuar qartë objektivat kryesore të studimit si edhe prioritetet në kërkimin shkencor duke i përputhur ato me objektivat kryesore të institucionit, Fakultetit të Biznesit dhe Universiteti "Aleksandër Moisiu"[320], [321], [322], [323], [324], [325], [326], [327]. |
| **Kriteri 2.** Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit. | **PO.** Gjatë vitit akademik njësia kryesore stimulon kryerjen e veprimtarive mësimore duke i bashkërenduar ato me veprimtaritë kërkimore shkencore duke respektuar lirinë akademike të personelit dhe nxitjen e zgjerimit të fushave të studimit. Shëmbull i qartë janë konferenca shkencore që organizon Fakulteti i Biznesit, Konferenca Studentore e Fakultetit të Biznesit, leksionet e hapura apo tavolinat e rrumbullakëta me të ftuar ekspert në fushën e Turizmit, stimulon kërkime shkencore individuale të studentëve me anë të projekteve e detyrave të kursit në çdo lëndë, etj.[328], [329], [330], [331], [332]. |
| **Kriteri 3.** Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore. | **PO.** Departamenti i Turizmit, në funksion të përmirësimit të programit të studimit Master Profesional GTSH, ka siguruar dhe garanton pjesëmarrjen dhe angazhimin e studenteve në diskutime të hapura për të përmirësuar aspektet praktike të lidhura me formimin teorik e tyre[333]. Studentët e programit të studimit kanë mundësi të jenë pjesmarrës në konferenca shkencore të organizuar në mënyrë të përvitshme nga institucioni, si Konferenca e Fakultetit të Biznesit dhe Konferenca Studentore[334], [335], [336].<br>Ky program ndonëse është hapur në vitin 2018-2019 ka gjithashtu, në përbërje të Komisionit të Sigurimit të Cilësisë, Programeve të Studimit dhe Kërkimit Shkencor. Në të gjitha këto komisione ndodhet edhe nga një përfaqësues i studenteve në secilin komision, që frekuentojnë |

[320] *Aneks 2 Statuti i UAMD*
[321] *Aneks 5. Rregullorja e UAMD*
[322] *Aneks 6. Rregullore e Fakultetit të Biznesit, Kreu III , Neni 33.*
[323] *Aneks 6.1. Rregullore e Departamentit Turizmit*
[324] *Aneks 7. Rregullore e programit të studimi MP GTSH.*
[325] *Aneks 14. Aplikimi MP GTSH*
[326] *Aneks 14.1. Riorganizimi MP GTSH, 2020*
[327] *Aneks 55 Strategjia e Kërkimit Shkencor, Vendim 710, datë 1.12.2017*
[328] *Aneks 81. Aktivitete te kryera nga lektoret e departamentit të turizmit gjatë viteve 2018-2021*
[329] *Aneks 83. Vendim Dekanati Konferenca studentore 2020*
[330] *Aneks 84. Vendim per grupet e punes ne Konferencen e FB, 2021-2022*
[331] *Aneks 84.1. Rregullore e organizimit të konferencave dhe veprimtarive shkencore në UAMD*
[332] *Aneks 85. Vendim per grupin e punes per konferencen e studenteve 2021*
[333] *Aneks 33. Tabele permbledhese me studentet e trajnuar.*
[334] *Aneks 83. Vendim Dekanati Konferenca studentore 2020*
[335] *Aneks 85. Vendim per grupin e punes per konferencen e studenteve 2021*
[336] *Aneks 84.1. Rregullore e organizimit të konferencave dhe veprimtarive shkencore në UAMD*

| | |
|---|---|
| | programin. Përfaqësuesi i studentëve ka të drejtë të barabartë vote dhe lirie në shprehje mendimesh me stafin akademik, anëtarë të komisioneve. Në këtë mënyrë, synohet shprehja e mendimit të studentëve për të përmirësuar vazhdimisht programin e studimit. |
| **Kriteri 4.** Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme. | **PO.** Institucioni harton projekt buxhetin duke marrë në konsideratë realizimin e objektivave të universitetit, të cilat janë përcaktuar në funksion të përmbushjes së misionit të tij si dhe synimeve dhe objektivave të përcaktuara në programet e studimit. Projekt buxheti i IAL krijon mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e plotë të ciklit të dytë të studimit MP GTSH[337],[338]. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi II.7**<br>**Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor. | **Po.** Fakulteti i Biznesit ka krijuar në cdo njësi bazë, sipas përcaktimeve të Ligjit për arsimin e Lartë[339], grupet lëndore të miratuara në senat në Statutin e UAMD[340], Rregullores së UAMD[341], Rregullores së Fakultetit të Biznesit[342], Rregullores e Departamentit të Turizmit[343].<br>Gjithashtu Fakulteti i Biznesit është pjesë e disa projekteve kërkimore shkencore të cilat stimulojnë kërkimin shkencor dhe bashkëpunimin me organizma të ngjashme ndërkombëtare apo kombëtare[344],[345],[346],[347].<br>Mistral, është një ndër projektet e rëndësishme të Fakultetit të Biznesit i cili ka në fokus Turizmin. Në grupin e punës së këtij projekti është përfshirë Departamenti i Turizmit që menaxhon programin e studimit master profesional GTSH[348],[349],[350],[351]. |
| **Kriteri 2.** Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e | **PO.** Njësia përgjegjëse ka ekspertizën e nevojshme dhe të gjithë hapësirën e duhur për tu përfshirë në analiza, studime dhe projekte shkencore jo vetëm nëpërmjet stafit akademik por edhe me studentët, me qëllim parësor realizimin e objektivave kryesore të programit të studimit. |

[337] *Aneks 49 Veprimtaria financiare për vitin akademik 2018 -2019*
[338] *Aneks 50 Të dhëna nga Plani financimit të programit të studimit*
[339] *Aneks 53.1 Ligji i Arsimit të Lartë, .80, 2015*
[340] *Aneks 2 Statuti i UAMD*
[341] *Aneks 5. Rregullorja e UAMD*
[342] *Aneks 6. Rregullore e Fakultetit të Biznesit.*
[343] *Aneks 6.1. Rregullore e Departamentit Turizmit*
[344] *Aneks 97. Raporti vjetor i UAMD per v.a 2019-2020*
[345] *Aneks 132. Kriteret e vlerësimit të veprimtarisë kërkimore shkencore ne UAMD*
[346] *Aneks 119. Rregullore e Këshillit të Kërkimit Shkencor*
[347] *Aneks 131. Rregullore e mbajtjes së bazës së të dhënave të kërkimit shkencor*
[348] *Aneks 109. Grupet e punës për projektet Mistral dhe Histek*
[349] *Aneks 118. Rregullore për menaxhimin e aktiviteteve kërkimore shkencore*
[350] *Aneks 119. Rregullore e Këshillit të Kërkimit Shkencor*
[351] *Aneks 43.1. Raport për aktivitetin kërkimor shkencor 2018-2019*

| | |
|---|---|
| këtyre objektivave. | Shëmbuj konkretë janë përfshirja e stafit akademik të Departamentit të Turizmit, përgjegjës për programin e studimit MP në GTSH, në shumë projekte ndërkombëtare dhe kombëtare, në studime kërkimore shkencore. Në një pjesë prej tyre, janë përfshirë edhe studentët e Masterit[352], [353], [354], [355], [356]. |
| **Kriteri 3.** Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave. | **PO.** Departamenti i Turizmit në zbatim të programit të studimit[357], në bashkëpunim me FB[358] dhe UAMD, ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucione të tjera homologe brenda vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ ose të huaj për kryerjen e praktikave profesionale të studentëve, e cila është pjesë përbërëse dhe e rëndësishme e kurrikulës të studimeve.<br>Njëkohësisht, bazuar në rregulloren e Konferencave në UAMD, departamenti ka vënë në dispozicion dhe ka mbuluar me personel akademik edhe shumë veprimtari të tjera specifike që janë kryer nga vetë departamenti apo nga institucione te tjera, si konferenca në fushën e turizmit, panaire, etj, ku personeli akademik i ngarkuar ka bashkëpunuar ngushtësisht me studentët për rritur nivelin e pjesemarrjes së studentëve dhe përfshirjen e tyre në këto veprimtari[359], [360], [361], [362], [363], pjesë e të cilave kanë qenë edhe studentët në organizimin e pjesëmarrje aktive. |
| **Kriteri 4.** Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës. | **PO.** Në ciklin e Dytë i Studimeve, Master Profesional në GTSH[364] ofrohet një risi të kërkuar në tregun shqiptar, sidomos atë rajonal pasi programe të tilla Masteri Profesional janë të rralla e me vlerë në fushën e turizmi. Kuadri formues për këtë specialitet synon të ofrojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional në realizimin e objektivave të politikave të guidës në terren, komunikimit me turistët, menaxhimit të tureve, hartimin e një pakete turistike bashkohore, dhënien e njohurive rreth destinacioneve turistike shqiptare etj. Në këtë mënyrë, synohet krijimi i specialistëve profesionistë guidierë me aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional që do të rrisin shërbimin ndaj turistëve që do vizitojnë vendin tonë.<br>Njohuritë, aftësitë, kompetencat dhe formimi i thelluar profesional të studentëve që do frekuentojnë e do mbarojnë këtë program studimi do të ndikoj në rritjen e fitimit të njohurive përtej asaj që kanë marr në ciklin e parë të studimeve. Kjo gjë iu jep mundësi studentëve të jenë origjinalë në zhvillimin e ideve dhe zbatimin e tyre në kontekstin e kërkimit shkencor e në formimin e tyre profesional si një guidë turistike.<br>Studentët që do mbarojnë këtë program studimi do të fitojnë kompentenca në zbatimin e njohurive të fituara dhe do rriten kapacitetet e tyre profesionale për zgjidhjen e probleme të caktuara në |

[352] *Aneks 43. Të dhena për aktivitetet dhe kërkimin shkencor të stafit të DT*
[353] *Aneks 97. Raporti vjetor i UAMD per v.a 2019-2020*
[354] *Aneks 132. Kriteret e vlerësimit të veprimtarisë kërkimore shkencore ne UAMD*
[355] *Aneks 119. Rregullore e Këshillit të Kërkimit Shkencor*
[356] *Aneks 131. Rregullore e mbajtjes së bazës së të dhënave të kërkimit shkencor*
[357] *Aneks 7 Rregullore e programit te studimit MP GTSH.*
[358] *Aneks 34. Marrëveshjet bashkëpunimi te FB .*
[359] *Aneks 81. Aktivitete te kryera nga lektoret e departamentit të turizmit gjatë viteve 2018-2021*
[360] *Aneks 83. Vendim Dekanati Konferenca studentore 2020*
[361] *Aneks 84. Vendim per grupet e punes ne Konferencen e FB, 2021-2022*
[362] *Aneks 84.1. Rregullore e organizimit të konferencave dhe veprimtarive shkencore në UAMD*
[363] *Aneks 85. Vendim per grupin e punes per konferencen e studenteve 2021*
[364] *Aneks 7. Rregullore e programit te studimit MP GTSH*

| | |
|---|---|
| | turizëm brenda konteksteve më të gjëra (ose shumëdisiplinore) që lidhen me fushën e studimit të tyre[365], [366], [367]. |
| **Kriteri** 5 Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesioniste, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës. | N.A |
| **Kriteri** 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (*p.sh. Professional QualificationsDirective, 2005/36/EU*). | **PO.** Programi i studimit Master Profesional në GTSH është strukturuar në ngarkesë të bazuar në normimin juridik të përcaktuar dhe në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Ngarkesa e programit në fjalë pasqyrohet në planin mësimor, tek e cila shprehet e ndarë me orë dhe kredite sipas viteve akademike dhe semestrave përkatës[368], [369], [370], [371].<br>Ky program studimi dhe ngarkesa e tij mësimore është hartuar në përputhje me aktet ligjore e nënligjore përkatëse[372]. Programi i studimit shtrihet në 1 vit akademik, i ndarë në 2 semestra, i organizuar mbi bazën e lëndëve ose moduleve dhe i vlerësuar me kredite (ECTS) çdo lëndë[373], [374].<br>Në programin e studimit Master Profesional në GTSH, siç shikohet te plani mësimorë, gjatë vitit akademik, studentët realizojnë sasinë totale prej 60 kreditesh të grumbulluara, duke përfshirë marrjen e Praktikës Mësimore përpara një komisioni dhe mbrotjen e temës së diplomës Master Profesional në GTSH[375], [376], [377], [378], [379], [380], [381], [382]. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II** | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

## III.MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

[365] *Aneks 19. Silabuset e lëndëve në fazën e Aplikimit fillestar: Pjesa "Temat e Lëndës"*
[366] *Aneks 67. Silabuset e reja me ndryshimet pas riorganizimit nën 20% MP GTSH: Pjesa "Temat e Lëndës"*
[367] *Aneks 26. Të dhëna tabelare për numrin e programve në ciklin I, II, III të studimeve të ofruara nga FB*
[368] *Aneks 2 Statuti i UAMD*
[369] *Aneks 5. Rregullore e UAMD, Kreu III, neni 45.*
[370] *Aneks 6. Rregullore e Fakultetit të Biznesit.*
[371] *Aneks 6.1. Rregullore e Departamentit Turizmit*
[372] *Aneks 6. Rregullore e Fakultetit të Biznesit, Kreu III, neni 33.*
[373] *Aneks 14. Dosja e programit të studimit*
[374] *Aneks 14.1. Riorganizimi MP GTSH, 2020*
[375] *Aneks 14. Aplikimi MP GTSH*
[376] *Aneks 14.1. Riorganizimi MP GTSH, 2020*
[377] *Aneks 15. Model Diplome, Urdhër aprovimi nga MASR*
[378] *Aneks 15.1 MP GTSH Suplementi i Diplomës*
[379] *Aneks 10. Rregullore e Diplomimeve në Fakultetin e Biznesit*
[380] *Aneks 10.1 Rregullore e Tezes se Diplomes ne Fakultetin e Biznesit*
[381] *Aneks 10.2 Rregullore e Mikrotezs dhe Praktikës Profesionale në FB*
[382] *Aneks 10.3 Rregullore e Praktikes ne Fakultetin e Biznesit*

| **Standardi III.1** **Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë: leksionet, seminaret, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni. | **PO.** Transmetimi i dijeve dhe mësimnxënia mbështetet nëpërmjet realizimit të mësimdhënies bazuar në leksionet, seminaret, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e orët e hapura, forma të mësimdhënies që gjejnë pasqyrim dhe në rregullatorët mbështetës ligjorë[383], [384], [385], [386]. Vëmëndje e vecantë i kushtohet aftësimit praktik të studentëve nëpëmjet realizimit të praktikës profesionale, që synojnë thellimin e njohurive teorike dhe zbatimin konkret në praktikë të tyre, për ti aftësuar në ushtrimin e aktivitetit professional.[387], [388] Gjithashtu në focus janë mbajtur dhe organizimi i orëve të hapura nga lektorë të ftuar si dhe lektorimi specific gjatë organizimit të vizitave studimore në terren.[389], [390], [391], [392], [393] |
| ***Kriteri 2.*** *Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.* | **PO.** Personeli akademik mësimdhenës ka alternuar metoda pune në përshtaje me informacionin e lektoruar dhe nevojave të studentëve.[394], [395], [396], [397] Në silabuse te vecanta përfshihet aftësim praktik ( vizita studimore) në ore të vecanta, si dhe duke realizuar orën e detyrave të kursit individuale apo në grupe të vogla pune, duke stimuluar pavarësinë e kërkimit shkencor dhe njëkohësisht dhe metodikën e të punuarit në grup.[398], [399]<br>Autonomia e studentëve permbushet nëpërmjet angazhimit të tyre gjatë mësimdhënies nëpërmjet përfshirjes në detyrat e kursit nëpërmjet punës me grupe kryesisht, realizimit të prezantimeve të gjetjeve të projekteve të realizuara. Marëdhëniet reciproke të respektit vendosen përgjatë një komunikimi verbal efektiv si dhe përgjatë komunikimit elektronik ndërmjet stafit akademik e studentëve përkundrejt mbajtjes së korespondëncës elektronike në adresën e emailit ose faqes së facebook të departamentit e fakultetit.[400] Një tjetër aspekt është dhe përfshirja e tyre në konferencat studentore të organizuara nga njësia kryesore.[401]<br>Përvojë më vete ishte organizimi dhe zhvillimi i mësimdhenies |

[383] *Aneks 2 Statuti i UAMD, Kreu VI, Neni 72, pika 1-4*
[384] *Aneks 5_ Rregullore e UAMD, Neni 60, Neni 61;*
[385] *Aneks6 Rregullore e Fakultetit te Biznesit, Kreu III,Neni 5;*
[386] *Aneks 14 Dosja e aplikimit të programit të studimit, kurilula, plani mesimor, silabuset lëndore*
[387] *Aneks .7 Rregullore e programit te studimit Master Profesional GTSH, Neni 19*
[388] *Aneks 10.3 Rregullore e Praktikes Profesionale ne FB*
[389] *Aneks .91_ Relacion per leksionin e hapur ne Parqet Arkeologjike te Amantias dhe Orikumit*
[390] *Aneks . 92 Relacion mbi udhëtimin studimor Liqenet e Belshit dhe Seferajt*
[391] *Aneks .94 Relacion per leksionin e hapur rreth turizmit historik ne Bunk Art 1*
[392] *Aneks .95 Relacion mbi leksionin e hapur ne Muze*
[393] *Aneks 107 Relacion mbi leksionet e hapura me lektore te huaj*
[394] *Aneks .6 Rregullore e Fakultetit te Biznesit, Kreu III, Neni 51;*
[395] *Aneks .7 Rregullore e programit te studimt Master Profesional GTSH, Neni 17;*
[396] *Aneks 81 Aktivitete te kryera nga lektoret e departamentit te turizmit, 2021-2022*
[397] *Aneks 81.1 Lektorime te hapura nga anetaret e stfit e te ftuar ne ekspediten mesimore te zhvilluar ne terren*
[398] *Aneks 67 Silabuset mesimore pas riorganizimit MP GTSH*
[399] *Aneks 38 dhe 38.1_Analiza vjetore e Departamentit të Turizmit dhe Analiza e Programit te studimit MP GTSH*
[400] *Aneks 106 Njoftime ne mediat sociale per pjesmarrje ne trajnime, mobilitete*
[401] *Aneks 85 Vendim per grupet e pune ne Konferencen Studentore 2021*

| | |
|---|---|
| | bazuar në platformat elektronike si Google Classroom, Zoom, Moodle dhe Teams, përgjatë viteve akademike 2019-2020 dhe 2020-2021 në kushtet e zhvillimit të mësimdhënies në periudhën e pandemisë Covid 19.[402] |
| ***Kriteri 3.*** *Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.* | **PO.** FB mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike, gjë e cila pasqyrohet dhe nga marrëveshjet ndërinstitucionale të bashkëpunimit të nënshkruara me institucione homologe brënda dhe jashtë vendit.<br>Në focus të këtyre marëveshjeve qëndrojnë: shkëmbimet e personelit akademik (pedagog, kërkues) për procesin mësimor dhe veprimtari kërkimore; nxitjen dhe realizimin e projekteve të përbashkëta kërkimore shkencore; organizimin e konferencave, trajnimeve, seminareve, etj.; shkëmbimin e materialeve akademike dhe literaturës shkencore[403], [404],[405] Fale eksperiences se fituar te lektoreve nga perfshirja ne aktivitete shumedimensionale te kryera ne kete kontekst, padyshim performanca e tyre mesimdhenese ka reflektuar ndryshime cilesore pozitive.<br>Në vijmësi stafi akademk i UAMD, si dhe i FB si pjesë institucionale e tij, është përfshirë në mobilitete me fokus kryerjen e mesimdhënies në universitetet pritëse të huaja ashtu dhe përfitime nga aktivitetet trajnuese. [406] Përgjithësisht i gjithë stafi i lektorëve të departamentit i përfshirë në procesin e mësimdhënies në ciklin e studimeve MP GTSH përdorin mjete audio vizive të teknologjisë për realizimin e orëve mësimore. |
| ***Kriteri 4.*** *Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.* | **PO.** Personeli akademik i angazhuar në procesin e mësimdhënies është kompetent sipas profileve që zotëron. Këtë e dëshmojnë dhe cv e stafit akademik si dhe kualifikimet e vazhdueshme të tyre.[407] Institucioni ka përcaktuar politika të qarta të rekrutimit të stafit mësimor me kohë të plotë apo të pjeshëm, referuar dhe Statutit të UAMD.[408] Rekrutimi i përsonelit i nënshtrohet praktikave të përcaktuara pëërkundrejt aplikimit me dosje dhe intervistës së personalizuar me të interesuarit. Vlerësimi i tyre bëhet i njehsuar kundrejt kritereve të përcaktuara. Kriteret percaktohen nga departamenti mbështetur në nevojat që paraqiten për realizimin e procesit mësimor dhe miratohen nga Rektori. Kandidatët vlerësohen dhe përzgjidhen sipas meritave nga komisioni AdHoc i ngritur pranë departamentit.[409] Dëshmi e qartë e kompetencave janë dhe kualifikimet e stafit në fushat e kërkimit të vertetuara nga CV e tyre si dhe nga përvoja e krijuar gjatë thellimit të kërkimit shkencor demostruar nga formularët e kërkimit shkencor në rang departamenti.[410] Krahas përfshirja e |

[402] *Aneks 46.1 Udhëzues për përdorimin e platformave online:Clasroom, Moodle,dhe Mic Teams*
[403] *Aneks 34 Marreveshjet e Bashkepunimit të Fakultetit të Biznesit*
[404] *Aneks 109 Vendimi nga FB për përfshirjen e stafit në projekte (Histek, Interreg etj*
[405] *Aneks 73.1 Tabele permbledhese mbi te dhena te mobiliteteve te stafit akademik te DT*
[406] *Aneks 73 Informacion nga DMPJ ne lidhje me mobilitetet e stafit akademikdhe administrativ*
[407] *Aneks 20 CV e personelit te Departamentit te Turizmit*
[408] *Aneks 2 Statuti i UAMD; KreuV.,Neni 45*
[409] *Aneks 2 Statuti I UAMD, Kreu V, Neni 45, 46, 47*
[410] *Aneks 43 Të dhëna për aktivitetet dhe kërkimin shkencor të stafit të DT*

| | |
|---|---|
| | stafit në trajnime, në mobilitete për mësimdhënie e trajnim është një tjetër tregues i aftësive të tyre menaxhuese e drejtuese të mësimdhenies.[411] Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që janë të angazhuar në realizimin e këtij program studimi kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e tij, sipas përcaktimeve të rregullores së programit të studimit. Në zbatim të akteve ligjore e nënligjore në fuqi FB dhe DT, angazhon si titullarë të lëndëve/moduleve për programet e studimeve të ciklit të dytë Master Profesional,[412] pedagogë akademik që kanë së paku gradën shkencore "Doktor". Personeli akademik me kohë të plotë i përfshirë në këtë program studimi në pjesën më të madhe të tyre janë me tituj akademikë dhe grada shkencore. Nga personeli akademik i v.a 2022-23 që mbulon këtë program studimi, 2(dy) lektorë janë me titull Prof.Dr e Prof. Assoc, 7(shtate) lektorë me gradë Doktor i shkencave. Personeli akademik i përfshirë në këtë program studimi ka një përvojë akademike të gjatë në mësimdhënie dhe në fushën e kërkimit shkencor. Një pjesë e tyre kanë kryer kualifikime e specializime jashtë vendit sipas fushave përkatëse dhe disiplinave që mbulojnë. Personeli akademik me kohë të pjesëshme është përzgjedhur, kryesisht me gradën shkencore Dr dhe në përputhje aktet ligjore e nënligjore dhe me përcaktimet e Rregullores së Burimeve Njërëzore[413]. DT ka të detajuara dhe të përshtatura një bazë të dhënash për personelin akademik që realizon programin. Ai pasqyron të gjitha ndryshimet që ka personeli akademik efektiv dhe me kontratë gjatë vitit akademik ku zbatohet programi i studimit. DT disponon listën e plotë të pedagogëve akademikë për secilin semestër, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe atij administrativ.[414] |
| ***Kriteri 5.*** *Njësia përgjegjëse për ofrimin e progamit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.* | **PO**. UAMD nëpërmjet NJSBC garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve. Në mënyrë periodike, dy herë në vit zhvillohen pyetësorë me studentët për të parë efektivitetin e bashkëpunimit lektor-student, mënyrën e menaxhimit dhe drejtimit të procesit mësimor dhe ndërveprimin e përbashkët, bazuar në nenin 6 te rregullores se NJSBC. Mbështetur ne nenin 83 te rregullores se FB është krijuar mundësia për trajtimin e ankesave të studentëve.[415], [416], [417], [418]. Institucioni synon përmirësimin e |

[411] *Aneks 73.1Tabele permbledhese me te dhena mbi mobilitete per mesimdhenie te stafit akademik te DT*
[412] *Aneks 7. Rregullore e programit të studimit MP GTSH*
[413] *Aneks 11. Rregullore e Zyrës së Burimeve Njerëzore*
[414] *Aneks 24. Të dhëna Tabelore për personelin akademik në programin studimit.*
[415] *Aneks 8 Rregullore për funksionimin dhe organizimin e Sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë*
[416] *Aneks 40 Formati i pyetësorit për pedagogët nga studentët*
[417] *Aneks .66 Informacion mbi Formularin e vlerësimit nga studentët i lektorëve DT*
[418] *Aneks 2Statuti i UAMD*

| | |
|---|---|
| | mëtejshëm të menaxhimit të procesit mësimdhënnies nëpërmjet përdorimit të pyetësorëve të vlerësimit me studentë. [419], [420] Mendimet e sygjerimet e studenteve te dala gjatë përpunimit të pyetësorëve kanë shërbyer si pika referimi të vlerësimit të punës nga stafi angazhuar në mësimdhënie duke respektuar konfidencialitetin e te dhenave.[421] Organizimi i orëve mësimore bazohet në orë mësimore të integruara të leksioneve me seminare duke i dhënë mundësi lektorit të drejtojë orën e mësimit jo vetëm duke u bazuar në shprehjen verbale, por dhe në diskutime të gjeneruara në bazë të pyetjeve të shtruara apo përgjatë diskutimit të rasteve studimore.[422] Njëkohësisht përfshirja e detyrave të kursit ndikon në gjithpërfshirjen e tyre në procesin mësimor. Ndërthurja e mësimdhënies përgjatë zhvillimit të study field në terren[423] përvec gjithpërfshirjes dhe interesit të shtuar të studentëve ndihmon në aftësimin praktik të tyre në mënyrë të drejtpërdrejtë në kontakt me profesionin si specialistë të ardhshëm. Institucioni ka hartuar udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme innovative[424] në ndihmë të mësimdhënies në mbështetje të programeve të studimit, leksione te hapura, trajnime e takime informuese. Gjatë mësimdhënies lektorët ndërthurin lektorimin me prezantime poëer point, video e foto me anë të mjeteve të teknologjisë. |
| ***Kriteri 6.*** *Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.* | **PO.**Institucioni ka struktura organizative në nivel institucional që në bazë të funksioneve dhe përgjegjësive që kanë promovojnë në vazhdimësi përmbushjen e standardeve te cilësisë në mësimdhënie duke koordinuar punën me njësinë kryesore e njësinë bazë për të mundësuar efikasitet në procesin e mesimdhenies. Strukturat përbërëse të sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë në nivel institucional si dhe pergjegjesitë e tyre janë pasqyruar në Nenin 2 te rregullores së NJSBC. [425] Këto struktura janë në koordinim të përhershëm në ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave të tyre me qëllimin e përbashkët koordinimin dhe bashkërendimin e aktiviteteve për te siguruar cilësi të mësimdhënies e kërkimit shkencor. Njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë pranë FB[426], mbështetur dhe në manualin për sistemin e brendshëm të sigurimit të cilësisë[427] ka realizuar raportin e vlerësimit të brendshëm për FB për vitin 2020-2021, ku |

[419] *Aneks 40 Formati i Pyetesorit për pedagogët nga studentë*
[420] *Aneks 66 Informacion mbi Formularin e vleresimit te stafit akademik nga studentet, v.a 2021-22*
[421] *Aneks .51.1 Ligji mbi mbrojtjen e te dhenave personale*
[422] *Aneks .2 Statuti i UAMD, Kreu VI, Neni 72, pika 4/c*
[423] *Aneks .81.1Lektorime te hapura nga anetaret e stafit e të ftuar ne oret mesimore te realizuar ne terreN*
[424] *Aneks 39Trajnim i stafit nga QEV-Udhëzues në nivel institucional për përdorim e metodave të ndryshme në mësimdhënie*
[425] *Aneks 8_rregullore për funksionimin dhe organizimin e Sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësise, Neni 2*
[426] *Aneks 115Vendim- Njësia e Sigurimit te Brendshem te Cilesise per FB*
[427] *Aneks 99 Manual I NJSBC te FB, v.a 2018-2019*

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | analizohet puna e cdo njësie bazë në kontekstin e të tërës të Njësisë kryesore. [428] Ne kuadër të kërkimit shkencor, institucioni ka hartuar një dokument idendifikues të arritjeve në drejtim të punës së kërkimit shkencor e kualifikimeve si individë dhe si njësi bazë e njësi kryesore. Në formë institucionale është realizuar dhe një rankim mbështetur në kritere pikëzimi ku janë idendifikuar e promovuar arritjet e lektorëve të vecantë si dhe njësive bazë në shkallë universiteti.[429] Autoriteti drejtues i FB, Dekani, administron, drejton dhe mbikqyr tere veprimtarinë organizative, mësimore, në fakultet, ne koordinim me zv dekanet e pergj e njesive baze.[430] Përgjegjësi i Njësisë Bazë të DT, ka për detyrë të nxisë, programojë, bashkërendojë, dhe administrojë veprimtarinë e mësimdhënies dhe atë të kërkimit shkencor të departamentit.[431] Përgjegjësi i Njësisë bazë ka përgjegjësi për hartimin, zbatimin, monitorimin e masave të mara për ecurinë dhe zhvillimin e programit të studimit, praktikave profesionale në përputhje me objektivat [432]. Përfshirja e personelit akademik dhe ndihmes akademik krahas dhe studentëve në programin e shkëmbimit Erasmus+ shërbejnë për rritjen e cilësisë të sherbimeve mbeshtetëse dhe padyshim mësimdhënies dhe përmirësimit cilësor të ofrimit të programit të studimit.[433] Ndjekja e cdo komponenti të punës mësimore e kërkimore të departamentit të turizmit, masat e mara per realizimin e veprimtarive të ndryshme, analiza e punës për përmbushjen e qëllimeve dhe objektivave të programit të studimit, rrit përgjegjshmërinë e stafit ndaj cilësisë së ofrimit të programit të studimit.[434] Personeli akademik është përfshirë në vazhdimësi në trajnime të ndryshme , si në kuadër të angazhimit nëpër projekte të ndryshme[435] apo dhe në kuadër të mobiliteteve të kryera në institucione homologe sipas marëveshjeve të nënshkruara me Institucionin[436] të cilat kanë ndikuar në përmirësimin e aftësive të mësimdhënies krahas dhe përdorimit të metodave të reja interaktive të mësimdhënies. Ndarja e mendimit dhe rezultateve kerkimore me studjues e profesioniste te fushes gjatë pjesmarjes në aktivitetevе shkencore kombëtare e ndërkombëtare[437] si dhe përfshirja në grupe pune organizatore të eventeve akademike në rang fakulteti gjithashtu shfaq impakte pozitive të aftësive drejtuese të mësimdhënies dhe të qënurit përherë në koherencë me arritjet e shkencës.[438] | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së** | **Nuk** | **Përmbushet** | **Përmbushet** | **Përmbushet** |

[428] *Aneks 37 Raport vjetor per monitorimin dhe sigurimin e cilesise i FB*
[429] *Aneks 97 Raporti mbi aktivitetin kërkimor shkencor për vitin akademik2017-2018 në UAMD*
[430] *Aneks6 Rregullore e fakultetit të Biznesit, Neni 18,19,20,21*
[431] *Aneks 6.1 Rregullore e Departamenti te Turizmit*
[432] *Aneks7 rregullore e programit të studimit MP GTSH, neni 12*
[433] *Aneks34.1 Tabelë përmbledhëse me institucione bashkëpunnuese, UAMD*
[434] *Aneks38.1 Analiza e programit të studimit MP GTSH*
[435] *Aneks109 Gupet e punes në kuadër të projekteve HISTEK dhe MISTRAL*
[436] *Aneks73 Informacion nga DPMJ ne lidhje me mobilitet e stafit akademik dhe administrative*
[437] *Aneks43 Të dhëna për aktivitetet dhe kërkimin shkencor të stafit të DT*
[438] *Aneks84,84.2 Vendime mbi organizimin e grupeve të punës në Konferencen e FB 2021-22,02023*

| standardit | përmbushet | pjesërisht | kryesisht | plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| Standardi III.2<br>**Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| ***Kriteri 1.*** *Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.* | **PO.**DT, është njësia bazë përgjegjëse për zbatimin e programit të Studimit Master Profesional GTSH. Mbështetur në rregulloren e UAMD,[439] Rregulloren e Fakultetit te Biznesit[440], rregulloren e programit të studimit[441] , ndjek dhe realizon në vijmësi në përputhje me kuadrin mbështetës ligjor procesin e vlerësimit të njohurive e dijeve. Procesi i vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale që studenti ka arritur gjatë vitit bazohet në sistemin e vlerësimit me 10 nota sipas klasifikimit të pikëvë të fituara. Forma e vlerësimt është e ndarë në pjesë: 40% është vlerësimi i ndërmjetëm në përfundim të 7-8 javëve të para të mësimdhënies, vlerësimi përfundimtar që zë në peshë 50% të vlerësimit të përgjithshëm dhe kryhet në përfundim të mësimdhenies dhe vlerësimi me detyrë kursi/projekte që zë 10% të peshës së përgjithshme të vlerësimit total, dhe kryesisht realizohet para kryerjes së provimit përfundimtar. Skema e vlerësimit është pjesë përbërëse e silabuseve mësimore dhe miratohet në fillim të vitit akademik nga përgjegjësi i njësisë bazë. Format kryesore të kontrollit për vlerësimin e nivelit të dijeve që studenti ka përvetësuar gjatë zhvillimit të lëndës janë: testimi i ndërmjetëm/detyrat e kursit/projektet dhe provimi final. Pedagogu i lëndës/modulit i komunikon studentit nëse ka fituar të drejtën për të marrë pjesë në provimin final(perkundrejt rregullores mbi mungesat e kryera) si dhe nivelin e pikëve të fituara nga vlerësimi i ndërmjetëm dhe i detyrës së kursit në orën e fundit të mësimit para hyrjes në provimin përfundimtar. Provimi final, sipas përcaktimeve në syllabus, organizohet me shkrim. Studenti ka të drejtën e hyrjes në provim kur plotëson kushtet e përcaktuara në rregulloret e studimeve, dhe i nënshtrohet provimit final. Studentëve i garantohet vlerësim objektiv bazuar në shkallën e meritës së tyre. [442] |
| **Kriteri 2.** Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e | **PO.** Në fillimi të cdo lëndë titullari i saj informon studentët |

[439] *Aneks 5 Rregullore UAMD, Neni 68;*
[440] *Aneks 6 Rregullore e Fakultetit te Biznesit, Neni 59;*
[441] *Aneks 7 Rregullorja e programit të studimit Master Profesional GTSH, Kreu III, Neni 23;*
[442] *Aneks 21 Rregullore e provimeve ne FB, Neni 2*

| | |
|---|---|
| testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit. | lidhur me programin lëndor, literaturën bazë e ndihmëse si dhe mënyrën dhe sistemin e vlerësimit.[443] . Studentëve ju bëhet me dije struktura e lëndës dhe përqindjet e pikëvë për të gjithë elementët sipas përcaktimeve në sylabuset e lëndëve. Vlerësimi bëhët në dy etapa: Vlerësimi i parë i ndërmjetëm, në fund të javës së shtatë osë të tetë dhe provimi përfundimtar në fund të mbylljes së lëndës, java e 15/16-të. Pjesë e vlerësimit në masën prej 10% të tij zënë dhe detyrat e kursit/projektet e kursit. Dhe në kete cikel studimi jane vene ne praktike sistemi elektronik te testimit dhe vleresimit, të mundësuar nga projekti Clean Score, fale mareveshjes që ka UAMD me AADF.[444] |
| **Kriteri 3.** Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara. | **PO.** Mënyra e kontrollit të dijeve përcaktohet në programin mësimor dhe i bëhet e njohur studentit në fillim të procesit mësimor nëpërmjet prezantimit të silabuseve lëndore. Mbështetur në rregulloret e UAMD, Rregulloren e FB si dhe në rregulloren e e programit te stufdimit MP GTSH, në këto rregullatorë ligjore janë përcaktuar edhe mënyrat dhe format e kontrollit për vlerësimin e nivelit të dijeve dhe aftësive që kanë përvetësuar studentët gjatë zhvillimit të leksioneve teorike dhe aftësimit praktik.<br>Testimi e vleresimi perfundimtar i njohurive, dijeve e aftesive realizohen ne perputhje me bazën ligjore, rregulloret institucionale. Drejtuesi i Njësisë bazë është përgjegjës për krijimin e komisioneve të provimeve me 3 anëtarë) ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit, ndërsa antarët e tjerë pjesë e fushave të studimit të përafërt, ne rastin e sezonit te riprovimeve . Komisioni i provimit ne kete rast përcaktohet nga Përgjegjësi i Departamentit në bashkëpunim me Zv. Dekanin për anën mësimore dhe miratohet nga dekani.[445], [446], [447] Testimi i vlerësimit të dijeve e njohurive zhvillohet me shkrim në prani të një lektori asistues me funksion monitorimin e procesit të testimit, sipas percaktimeve në rregulloren e UAMD dhe Fakultetit të Biznesit.[448], [449], [450].<br><br>Ne rastet e konstatimit te parregullsive, ne kundravajtje me rregulloren e zhvillimit te provimeve, provimi nderpritet e plotesohet procesverbali për parregullsi të provimit. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

[443] *Aneks 6 Rregullore e Fakultetiti te Biznesit, Neni51;*
[444] *Aneks 139 Korespondenca me Clean Score, model vlerësimi*
[445] *Aneks 5 Rregullore UAMD, Neni 69;*
[446] *Aneks 6 Rregullore e Fakultetit te Biznesit, Neni 60;*
[447] *Aneks 21 Rregullore e Provimeve, Neni 4;*
[448] *Aneks 5 Rregullore UAMD, Neni 70, pika 6;*
[449] *Aneks 6 Rregullore e Fakultetit të Biznesit, Neni 61, pika 6;*
[450] *Aneks 88 Model procesverbali per nderprerje te procesit të testimit në rast shkeljeje rregullores, Aneks C i rregullores se FB*

| **Standardi III.3**<br>**Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| ***Kriteri 1.*** *Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.* | **PO.** DT, është njësia bazë përgjegjëse për zbatimin e programit të studimit Master Profesional GTSH. Mbështetur në rregulloren e UAMD,[451] Rregulloren e Fakultetit te Biznesit[452], rregulloren e programit të studimit[453] , ndjek dhe realizon në vijmësi në përputhje me kuadrin mbështetës ligjor procesin e vlerësimit të njohurive e dijeve.<br>Procesi i vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale që studenti ka arritur gjatë vitit bazohet në sistemin e vlerësimit me 10 nota sipas klasifikimit të pikëvë të fituara. Forma e vlerësimt është e ndarë në pjesë: 40% është vlerësimi i ndërmjetëm në përfundim të 7-8 javëve të para të mësimdhënies, vlerësimi përfundimtar që zë në peshë 50% të vlerësimit të përgjithshëm dhe kryhet në përfundim të mësimdhenies dhe vlerësimi me detyrë kursi/projekte që zë 10% të peshës së përgjithshme të vlerësimit total, dhe kryesisht realizohet para kryerjes së provimit përfundimtar. Skema e vlerësimit është pjesë përbërëse e silabuseve mësimore dhe miratohet në fillim të vitit akademik nga përgjegjësi i njësisë bazë.<br>Format kryesore të kontrollit për vlerësimin e nivelit të dijeve që studenti ka përvetësuar gjatë zhvillimit të lëndës janë: testimi i ndërmjetëm/detyra e kursit/projekt dhe provimi final.<br>Pedagogu i lëndës/modulit i komunikon studentit nëse ka fituar të drejtën për të marrë pjesë në provimin final(perkundrejt rregullores mbi mungesat e kryera) si dhe nivelin e pikëve të fituara nga vlerësimi i ndërmjetëm dhe i detyrës së kursit në orën e fundit të mësimit para hyrjes në provimin përfundimtar.<br>Provimi final, sipas përcaktimeve në syllabus, organizohet me shkrim.<br>Studenti ka të drejtën e hyrjes në provim kur plotëson kushtet e përcaktuara në rregulloret e studimeve, dhe i nënshtrohet provimit final. Studentëve i garantohet vlerësim objektiv bazuar në shkallën e meritës së tyre. [454],[455] |
| **Kriteri 2.** Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën. | **PO.** Në këtë cikël studimi është vënë në zbatim edhe sistemi elektronik i testimit dhe vleresimit, në bazë të praktikës së mirë të bashkëpunimit dhe përgjegjshmërisë së kryerjes së procesit nga ana e AADF nëpërmjet projektit të Clean Score.[456] |
| **Kriteri 3.** Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi. | **PO.** Testimi e vleresimi perfundimtar i njohurive, dijeve e aftesive realizohen ne perputhje me bazën ligjore, rregulloret institucionale. Drejtuesi i Njësisë bazë është përgjegjës për |

---

[451] *Aneks 5 Rregullore UAMD, Neni 68;*
[452] *Aneks 6 Rregullore e Fakultetit te Biznesit, Neni 59;*
[453] *Aneks 7 Rregullore e Master Profesional GTSH, Kreu III, Neni 23;*
[454] *Aneks 21 Rregullore e provimeve ne FB, Neni 2*
[455] *Aneks 138 Vendim Dekanati për monitorim të procesit të vlerësimit dhe relacioni përkatës*
[456] *Aneks 139 Model vleresimi studenti elektronikisht nepermjet Clean Score*

| | |
|---|---|
| | krijimin e komisioneve të provimeve me 3 anëtarë) për sezonin e riprovimeve ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit, ndërsa antarët e tjerë pjesë e fushave të studimit të përafërt. Komisioni i provimit ne kete rast përcaktohet nga Përgjegjësi i Departamentit në bashkëpunim me Zv. Dekanin për anën mësimore dhe miratohet nga dekani.[457], [458], [459] .<br><br>Testimi i vlerësimit të dijeve e njohurive zhvillohet me shkrim në prani të një lektori asistues me funksion monitorimin e procesit të testimit, sipas percaktimeve në rregulloren e UAMD dhe Fakultetit të Biznesit.[460], [461]. Ne rastet e konstatimit te parregullsive, ne kundravajtje me rregulloren e zhvillimit te provimeve, provimi nderpritet e plotesohet procesverbali për parregullsi të provimit.[462] |
| **Kriteri 4.** Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen. | **PO.** Vlerësimi i njohurive e dijeve shoqërohet me komente e feedback në forme sqaruese e këshillash rekomanduese për përmirësimin e punës së studentit në drejtim të të nxënit. Në auditor ky process reflektimi realizohet orën pasardhëse pas kryerjes së testimit, ku studentët njihen me pasaktësistë në drejtim të zgjidhjes së ushtrimeve të caktuara të testit si dhe njëkohësisht dhe me zgjidhjen e saktë. [463], [464], [465] Stafi akademik bën korigjimin në fletët e testit si dhe shënime përkatëse sipas rasteve, krahas dhe komenteve verbale në kryerjen e vlerësimit të detyrës së kursit/projektit, si dhe sqarimin e paqartësive që mund të lindin gjatë kryerjes së procesit. Kundrejt rregulloreve studentët kanë një periudhë të caktuar për ankimim, ku perkundrejt kërkesës së paraqitur me shkrim pranë zëv.dekanit për anën mësimore, përgj departamentnit ngre një komision për të shqyrtuar ankimimin e studentit. Komisioni në fund të procesit del me një vendim që iu bëhët prezent palëve si studentit ashtu dhe lektorit përkatës. |
| **Kriteri 5.** Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra. | **PO.** Stafi akademik mbështetur në rregullatorët ligjorë përkatës në nivel institucional dhe më gjërë zbaton me korrektësi dhe përgjegjshmëri efikase bazën ligjore lidhur me tolerancë zero në kopjimin në provime si dhe ndjeshmeri e lartë ndaj plagjaturës ndaj produkteve të kerkimit të realizuara nga studentët. Përkundrejt cilësimit në aktet ligjore përkatëse, studentët lejohen të hyjnë e të zhvillojnë provimet vetëm duke pasur prezent mjet idendifikimi personal. Në mungesë të këtij mjeti idendifikues, studentët nuk mund të lejohen të kryejne provimin. Ambientet ku zhvillohet provimi asistohen nga nje lector ndihmës asistues i pedagogut të lëndës. Në mungesë të pedagogut asistues provimi |

[457] *Aneks 5 Rregullore UAMD, Neni 69;*
[458] *Aneks 6 Rregullore e Fakultetit te Biznesit, Neni 60;*
[459] *Aneks 21Rregullore e Provimeve, Neni 4;*
[460] *Aneks 5 Rregullore UAMD, Neni 70, pika 6;*
[461] *Aneks 6 Rregullore e Fakultetit të Biznesit, Neni 61, pika 6;*
[462] *Aneks 88 Model procesverbali per nderprerje te procesit të testimit në rast shkeljeje rregullores, Aneks C i rregullores se FB*
[463] *Aneks 6 Rregullore e Fakultetit Biznesit, neni 60, pika7*
[464] *Aneks 5 Rregullore e UAMD, Neni 69, pika 7*
[465] *Aneks 21 Rregullore e provimeve, Pika 4*

| | |
|---|---|
| | nuk autorizohet të filloje, deri në momentin e zëvendësimit të tij me një pedagog tjetër. Në ambientet e provimit nuk lejohen të hyjnë personel tjetër i pa autorizuar me përjashtim të autoriteteve drejtuese që mund të ushtrojnë funksione vëzhguese të zhvillimit të provimit. Nëse studntët janë në kundravajtje ligjore me atë c'ka citojnë rregulloret për mbarëvajtjen normale të provimit, pedagogët përjashtojnë studentin nga kryerja e provimit. Në këtë rast plotësohet një procesverbal bashkëlidhur me fletën e provimit të studentit që vertëton kundravajtjen ligjore dhe justifikon masën e marrë për përjashtim nga provimi. Gjatë kryerjes së provimit studentët ndalohen të mbajnë celularë në ambientet ku kryhet provimi. [466], [467], [468] |
| **Kriteri 6.** Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen ne meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse. | **PO.** Procesi i kontrollit të dijeve bazohet në vlerësimin e njohurive e dijeve në bazë të meritës. [469] Cdo pedagog lë gjurmë në fletën e testit të studentëve, duke bërë shënimet përkatëse për cdo ushtrim që përmban fleta e tezës. Vëmëndje i kushtohet larmisë së llojeve të pyetjeve që teza përmban duke ruajtur një raport të drejtë të pikëzimit të pyetjeve brënda tezës. Tezat nënshkruhen nga përgjëgjësi i departamentit dhe nga lektori i lëndës. Në rastet e provimeve 1000 pike, teza nënshkruhet nga komisioni dhe pergjegjesi i departamentit. Në të përfshihet materiali i zhvilluar lëndor. Rezultatet e provimit pasqyrohen në procësverbalet përkatëse jo më vonë së pesë ditë për provimin e parë të ndërmjetëm dhe brenda 72 oresh për provimin përfundimtar. Provimet zhvillohen me shkrim.[470], [471], [472] |
| **Kriteri 7.** Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. | **PO.** Pas vlerësimit të provimit, me studentët realizohet procesi i transparencës në auditor, ku cdo student njihet me vleresimin dhe konsulton fletën e testit me pedagogun përkatës për t'u sqaruar më shumë mbi gabimet e bëra dhe zgjidhjen e drejtë të duhur.[473], [474], [475] Pas kësaj etape vlerësimet pasqyrohen në sistemin Pitagora nga ku gjenerohen dhe procesverbalet. Në rast pakënaqësie të studentit kundrejt procesit të vlerësimit nga pedagogu, studenti ka të drejtën e ankimimit ndaj vlerësimit të bërë. Mos dhënia në kohë e rezultateve të provimit sikundër parashikohet në rregullore ngarkon me përgjegjësi pedagogun e lëndës. Provimet dorëzohen në sekretarinë mësimore ku ruhen për afat kohor kundrejt rregullores. Një kopje e procesverbaleve ruhet pranë departamentit për cdo provim të kryer. |
| **Kriteri 8.** Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë | **PO.** Në rast se studenti nuk është i kënaqur me vlerësimin, ka të drejtën e ankimimit sipas akteve ligjore rregullatore. Pas paraqitjes se kërkesës ankimuese ne perputhje me rregulloren e |

[466] *Aneks 5 Rregullore UAMD, Neni 70;*
[467] *Aneks 6 Rregullore e Fakultetit Biznesit, neni 61*
[468] *Aneks 21 Rregullore e Provimeve ne Fakultetin e Biznesit, Pika 5*
[469] *Aneks 5 Rregullore UAMD, neni 69;*
[470] *Aneks 6 Rregullore e Fakultetit te Biznesit, neni 69;*
[471] *Aneks 7 Rregullore e programit te studimit Master Profesional GTSH, neni 26, 27;*
[472] *Aneks 21 Rregullore e provimeve ne fakultetin e Biznesit, Pika 4*
[473] *Aneks _5 Rregullore UAMD, neni 71;*
[474] *Aneks 6 Rregullore e Fakultetit te Biznesit, neni 62,*
[475] *Aneks 21 Rregullore e provimeve ne Fakultetin e Biznesit, pika 6*

| | |
|---|---|
| transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arshivohet. | kryerjes se provimeve drejtuesit të Njësisë Kryesore, fillon e ndiqet procedura specifike.<br><br>Ne rastet kur gjykohet, ankimimi i percillet përgjegjësit të njësisë bazë i cili ngre një komision për rivlerësim të tezës dhe bën me dije rezultatet studentit dhe pedagogut. Ne rast ndryshimesh, ato pasqyrohen në një procesverbal të dytë. Procedura e ndjekur për zgjidhjen e ankimimit depozitohet në dekanat dhe në arkivën e departamentit. [476], [477], [478] |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi III.4**<br>**Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese te studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore te studentët** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të vecanta shkencore të studentëve. | **PO.** Kurikula e studimit master profesional GTSH është hartuar në mënyrë të tillë që të thellojë dijet dhe njohuritë në fushën guides/udherrefimit turistik si dhe të aftësojë profesionalisht studentët.[479] Në këtë kurikul janë parashikuar lëndë/module ku i mundësohet studentëve të marrin njohuri të thelluara në lidhje me: njohjen e burimeve natyrore, kulturore, arkeologjike bashkëlidhur dhe me njohuritë menaxhuese dhe marketuese të destinacioneve turistike, duke krijuar premisa për udhërrëfyes të formuar me aftesi e kompetenca per të operuar në territorin shqiptar. Aftesimi nëpërmjet praktikes profesionale dhe ushtrimi terminologjise se fushes në gjuhë te huaj, pajisin studentin me njohuritë e nevojshme për të konkurruar në tregun turistik.[480]<br><br>Këto lëndë/module synojnë të formojnë ekspertë dhe specialistë të mirëfilltë si guide turistike të pajisur me shprehitë dhe aftësitë e interpretimit të vlerave të trashëgimise natyrore krahas dhe ato kulturore e shpirtërore të vendit tonë, duke rritur mundësitë për karrierë profesionale në drejtim të guidimit të tureve dhe formimit të udherrefyeseve profesionistë turistik. Zhvillimi i aftësive teknike, ndërpersonale dhe konceptuale bën të mundur punësimin e specialistëve guida/udhërrëfyes të ardhshëm në biznese të llojeve dhe dimensioneve të ndryshme të industrisë së turizmit, si: guida turistike profesionale pranë agjensive turistike të sektorit |

[476] *Aneks 5 Rregullore UAMD, Neni 71;*
[477] *Aneks 6 Rregullore e Fakultetit te Biznesit, Neni 62,*
[478] *Aneks 21 Rregullore e provimeve ne FB, Neni 6 ;*
[479] *Aneks 57 Urdheri i MASR per Hapjen e Programit te Studimit Viti 2018*
[480] *Aneks 63Plani mësimor i programit te studimit MP GTSH i riorganizuar nen 20%*

| | |
|---|---|
| | privat, Agjensia Kombëtare e Turizmit (AKT), Shoqata Shqiptare e Turizmit (ATA), Shoqata Kombëtare e Guidave Turistike të Shqipërisë (NATGA), Guida profesionale pranë Drejtorive Rajonale të Kulturës Kombëtare (DRKK), Unioni Turistik Shqiptar (UTSH), guida në muze si dhe profesioniste freelancer.<br>Praktika profesionale synon thellimin e njohurive teorike e profesionale të studentëve në drejtim të menaxhimit e guidimit të turieve, mundësive për krijimin e itinerave turistike etj. Nëpërmjet marjes së informacionit bazë teorik në nivel të thelluar të ndërthuruar dhe me aftësimin e kompetencave profesionale synohet formimi i specialistëve të aftë në nivel vendimarrje për drejtimin e tureve turistike, si udhërrëfyes e interpret profesionistë. [481] |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, të komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj). | **PO.** Programi i studimit Master Profesional GTSH i ka kushtuar vemëndje dhe formimit të studentëve me njohuri nga fusha humane e sociale, e komunikimit dhe ndërveprimit, zbatimit të teknologjisë dhe informacionit. Programi i studimit në planin e tij mësimor përmban lëndë: Komunikim dhe marketing i turizmit, Teknika dhe planifikimi i guidave turistike, Guida Natyrore e Kulturore e Shqiperise, Trashegimia Natyrore e Kulturore dhe menaxhimi saj, Gjuhe e huaj, etj. Këto lëndë i mundësojnë dhe aftësojnë studentët të jenë më konkurues në tregun e punës, të krijojnë aftësi komunikative të mira, të aftësohensi guida të ardheshme profesionistë, të rrisin kompetencat e të punuarit në grup etj.[482] |
| **Kriteri 3.** Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre si dhe për detyrimet përmbyllëse. | **PO.** Në përfundim të cdo lënde aftësitë e kompetencat e fituara nga studentët gjate realizimit të saj analizohen dhe shqyrtohen në analizën vjetore të punës së departamentit ku elementet reflektues i referohen nivelit të kalueshmërisë dhe cilësisë së arritur në përfundim të kurseve.[483]<br>Reflektime ndaj pasurimit të informacioneve të përfshira në literaturën e përdorur bazë dhe mbështetëse si dhe perditësime krahasuar me literaturën bashkohore të fushës realizohen nga cdo pedagog në fillim të cdo viti akademik duke reflektuar ndryshime pozitive në silabuse e përzgjedhjen e literaturës së përdorur duke synuar rritjen e efektivitetit të mësimdhenies dhe aftësim kompetencash më të mira të studentëve. Ndaj në cdo fillim viti akademik literatura e përditësuar firmoset nga përgjegjësi i njësisë bazë e lektori përkatës që zhvillon lëndën. [484], [485]<br><br>Në përfundim të realizimit të mësimdhenies së lëndës/modulit pedagogu orienton studentët duke vënë në pah cështjet më të |

[481] *Aneks 64 Shembuj te kryerjes se Praktikave Profesionale nga studente të MP GTSH;*
[482] *Aneks 63 Plani mesimor i programit te studimit MP GTSH i riorganizuar nen 20%;*
[483] *Aneks 38.1_Analiza per programin e studimit MP GTSH*
[484] *Aneks 67 Silabuset mesimore pas riorganizimit te MP GTSH*
[485] *Aneks 6 Rregullore e Fakultetit te Biznesit, Neni 53*

| | |
|---|---|
| | rëndësishme të literaturës bazë dhë ndihmëse, në formën e ushtrimeve, diskutimeve, analizës së studimeve të rastit. Këto zakonisht ose realizohen në formën e ores se perseritjes në formatin e përmbledhjes së temave kryesore apo cështjeve specifike, ose në forme përmbledhese gjate realizimit të cdo ore mësimore duke i orientuar me pyetje përgjithësuese analizuese. Analizimi në këtë kontekst i programit lëndor bëhët me qëllim evidentimin e problematikave të hasura dhe orentimi drejt provimit të ndërmjetëm/përfundimtar.[486] |
| Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve. | **PO.** Organizimi i planit mësimor të programit të studimit MP GTSH, lëndët që përbëjnë strukturën e tij janë të ndërtuara në mënyrë të atillë që ti aftësojnë studentët dhe me kompetenca per t'iu pergjigjur më së miri nevojave të tregut të punës. Studentëve u jepet mundësia që njohuritë e marra në auditor nëpërmjet udhëtimeve studimore të realizuara t'u jepet mundësia e zbatimit të tyre në praktikë.Ne v.a 2021-22 mesimdhenia u aplikua në kushte auditori e kombinuar me vizita studimore një ditore duke respektuar rregullat anti Covid, ndërkohe përgjatë dy viteve më të hershme akademike 2019-2020 dhe 2020-2021 mësimdhënia është realizuar në kushte restriktuese sipas neneve të Kushtetutës së Shqipërisë për fatkeqësitë natyrore (tërmeti, nëntor 2019) dhe më pas në kushtet e pandemisë globale Covid 19, ndaj është realizuar tërësisht online në semestrin e dyte te v.a 2019-2020 dhe tërësisht online në gjithë vitin akademik 2020-2021. Praktika mësimore si pjesë aktive e mësimdhenies nëpërmjet demostrimmit të aftësive praktike menaxhuese e drejtuese drejtpërdrejtë në kontakt me profesionin e ngushtë u jep mundësinë studentëve për ti perfeksionuar më tej aftësitë e kompetencat praktike të fituara.[487] Anëtarët e asamblesë të departamentit të turizmit kanë praktika të mira pune komunikuese lidhur me diskutimin e problematiakve dhe nivelin e vendimarrjes per menaxhimin sa me efikas te procesit të organizimit dhe drejtimit të mësimdhenies në këtë cikël studimi si dhe bërjes sa me eficient të ketij programi studimi.[488], [489]<br><br>Stafi i lektorëve të departamentit të turizmit është gjithnjë bashkëpunues i ngushtë me studentet dhe promovues i mire i perpjekjeve pozitive të tyre dhe ideve kreative në përfshirje aktivitetesh kreative dhe inisiativave per tu thelluar në kërkimin shkencor nëpërmjet pjesmarjes në konferencat e përvitshme studentore të organizuara nga fakulteti i Biznesit.[490], [491], [492]<br><br>Perfshirja e studentëve në programe mobilitetesh është një ndër |

486 *Aneks 67 Silabuset mesimore pas riorganizimit te MP GTSH*
487 *Aneks 63 Plani mësimor i programit te studimit MP GTSH pas riorganizimit nen 20%*
488 *Aneks 6 Rregullore e Fakultetit te Biznesit*
489 *Aneks 82 Mbledhje departamenti, procesverbale te ndryshme*
490 *Aneks 85 Vendim per grupet e punes per konferencen e studenteve te FB, 2021*
491 *Aneks 106 Njoftim ne media sociale per pjesmarrje ne trajnime mobilitete per studentet*
492 Aneks107Relacion mbi leksionet e hapura nga lektorët e huaj

| | |
|---|---|
| | prioritetet e punës së stafit të departamentit të turizmit, në kuadër të përpjekjeve institucionale të bëra dhe nga FB dhe UAMD në tërësi. [493]<br><br>Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre. [494], [495] [496], Per te mundesuar orientimin e tyre, studentet jane mbajtur në kontakt të vazhdueshëm si nëpërmjet rrjeteve sociale fb te FB e DT, ashtu dhe nëpërmjet kontakteve elektronike me email dhe konsultimeve fizike në auditor. [497], [498].<br><br>Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës, që nga viti 2010 ka implementuar dhe ka në përdorim një sistem të integruar të menaxhimit të studentëve. Ky sistem i mundëson një menaxhim të integruar të dhënave për programet akademike dhe kurrikulat përkatëse, stafin akademik dhe studentët. Në nivel UAMD, institucioni shumë më herët ka përdodur teknologjinë e sistemit Aula[499] e implementuar në UAMD që prej vitit 2010. Prej vitit 2012/2013 marrëveshje me AADF i shtohet alternativa e korrigjimit të tezave nëpermjet sistemit CLEANSCORE[500]. Më tej kanë pasur ndryshime për zonën online të pedagogëve duke kaluan nga sistemi Aula tek sistemi Pitagora-RASH[501], zbatuar së fundmi në vitin 2019. Çdo student dhe lektor ka një llogari elektronike, që e vet-administron dhe organizon regjistrimin online të kurseve, orarin preferencial, ndërsa lektorët administrojnë regjistrat, evidencat e studentëve dhe hedhjen e notave të provimeve.<br><br>U-Library (EBSCO) është një tjetër mundësi e përdorimit të librarisë online nga stafi akademik, e mundësuar në 2019, krahas dhe bibliotekes fizike te UAMD[502]. **EBSCO** ofron: - mbi 170,000 Libra elektronikë nga Oxford University Press, MIT Press, State University of Neë York Press, Cambridge University Press, University of California Press, McGill-Queen's University Press, Harvard University Press dhe shumë të tjera.)<br>- mbi 6,600 periodike dhe revista<br>- mbi 6,000 periodike peer-reviewed<br>- mbi 4,000 periodike te Web of Science or Scopus<br>Lektorët e departamentit zhvillojnë leksionet e tyre duke përdorur platforma të ndryshme virtuale, video, të cilat ndihmojnë studentët në qasjen më të shpejtë të njohurive, por |

[493] *Aneks 73 Informacion nga DMPJ në lidhje me mobilitetet e stafit akademik dhe administratv dhe studenteve*
[494] *Aneks 10 Rregullore e Diplomimeve ne Fakultetin e Biznesit*
[495] *Aneks 10.1 Rregullore e tezës së Diplomës në FB*
[496] *Aneks7 Rregullore e programit të studimit MP GTSH, Neni 20*
[497] *Aneks114 Korespondecë me email me studentët e MP GTSH mbi procesin e diplomimit, praktikes profesionale*
[498] *Aneks 113 Njoftimet ne rrjetet sociale te Fakultetit te biznesit dhe departamentit per studentet*
[499] *Aneks 46 Udhëzues për përdorimin e Strukturës së Teknologjisë (Pitagora, Manual Aula http://aula.uamd.edu.al/ https://www.uamd.edu.al/index.php/sq/2019/02/20/cleanscore-firmoset-memorandumi-i-mirekuptimit-me-aadf-ne-2/*
[500] *Aneks 34 Marrëveshjet e bashkëpunimit te fakultetit te Biznesit*
*https://www.uamd.edu.al/index.php/sq/2019/02/20/cleanscore-firmoset-memorandumi-i-mirekuptimit-me-aadf-ne-2/*
[501] *Aneks39.1 Sistemi Pitagora-RASH (pitagora@rash.al)*
[502] Aneks 45.3 Link i librave per turizmin

| | |
|---|---|
| | nga ana tjetër ata angazhojnë studentët të hulumtojnë në kohë reale me përdorimin personal të aparatëve digjital duke e bërë studentin një bashkëveprues dhe hulumtues në të njëjtën kohë. |
| **Kriteri 5.** Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjsë brenda/jashtë strukturës së programt të studimit. | **PO.** Programi i studimit Master profesional GTSH është në vitin e katert të implementimit.Mbështetur dhe në rekomandimet e ekspertit të MASR, në sygjerimet e bëra, janë realizuar ore leksioni të hapur në auditor me specialistë të fushës të ftuar për trajtimin e tematikave të vecanta të zhvillimeve dinamike tw kwtij profesioni. Njëkohësisht, gjatë ekspeditës studimore në terren të realizuar janë kryer lektorime të hapura të lektorëve të departamentit si dhe specialistëve të ftuar nga institucionet pritëse bashkëpunuese. Kjo formë mësimdhënie rrit aftësinë komunikuese profesionalisht të studentëve në lidhje me menaxhimin e situatave të ndryshme praktike drejtpërdrejt në kontakt me profesionin e tyre të ardhshëm.[503], [504], [505] |
| **Kriteri 6.** Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato. | **PO.** Autoriteti drejtues i FB, Dekani, administron e drejton veprimtarinë mësimore kërkimore në institucion.[506].<br><br>Përgjegjësi i Njësisë Bazë të DT, ka për detyrë të nxisë, programojë, bashkërendojë, dhe administrojë veprimtarinë e mësimdhënies dhe atë të kërkimit shkencor të departamentit.[507]<br><br>Përgjegjësi i Njësisë bazë ka përgjegjësi për hartimin, zbatimin, monitorimin e masave të mara për ecurinë dhe zhvillimin e programit të studimit, praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij[508]. FB ka mareveshje bashkepunimi me institucione te huaja homologe, biznese e institucione publike të cilat mundësojnë përvec të tjerave dhe kryerjen e praktikave profesionale pranë tyre të studentëve.[509] Përvec, departamenti turizmit angazhon lektore të ftuar per mbajtjen e leksioneve të hapura me studentët në varësi të specifikave të lendeve. Lektoret e ftuar përzgjidhen sipas praktikës së përcaktuar nga rektorati.[510] Përfshirja e personelit akademik dhe ndihmes akademik krahas dhe studentëve në programin e shkëmbimit Erasmus+ shërbejnë për rritjen e cilësisë të mësimdhënies dhe përmirësimit të programit të studimit.[511], [512], [513] |

[503] *Aneks 81 Aktivitete të kryera nga lektorët e departamentit të turizmit 2021-2022*
[504] *Aneks 95 Relacion mbi leksion i hapur ne Muze*
[505] *Aneks 92 Relacion mbi leksion i hapur në organizimin e eventeve(ekspozite në bashkëpunim me muzeun Arkeologjik Durrës*
[506] *Aneks 6_Rregullore e Fakultetit te Biznesit*
[507] *Aneks 6.1 Rregullore e Departamentit te Turizmit*
[508] *Aneks 7 Rregullore e programit të studimit MP GTSH*
[509] *Aneks 32 Tabelë përmbledhëse me institucione bashkëpunuese për programin e studimit*
[510] *Aneks 76 Vendim i Rektores per perzgjedhjen e lektoreve te ftuar per mbajtjen e leksioneve te hapura me studente*
[511] *Aneks 34 Marëveshje bashkëpunimi të Fakultetit te Biznesit*
[512] *Aneks 73.1T abele permbledhese me mobilitete te stafit te DT*
[513] *Aneks 107 Relacion mbi leksionet e hapura nga lektore te huaj*

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | Institucioni mbështet e promovon idete inovative, perfshirjen në studime të avancuara të mundësuar nëpërmjet dhe bashkëpunimit te krijuar me institucione bashkepunuese në kuadër të programeve te studmit Credit Mobility Erasmus+ apo Ceepus. Organizimi i pervitshëm i konferencave studentore te fakultetit te Biznesit është një mundësi shumë e mirë promovimi drejt thellimit të kërkimit shkencor si dhe promovimi me stimuj inkurajues i punimeve më të mira të studentëve nën mbështetjen dhe të pedagogëve mbështetës janë forma pune që stimulojnë aktivizimin shumë dimensional të studentëve drejt formimit profesional të tyre. | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi III.5**<br>**Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet pwrmbyllwse, para realizimit tw tyre dhe I bwn atop unlike dhe e bwn atw publike. | **PO.** Diplomimi studentëve pranë FB bëhet me mbrojtjen e një punimi diplome. Bazuar në Rregulloren e Diplomimeve në FB[514], dhe në rregulloren e Tezes se Diplomes[515], në rregulloren e programit të studimit MP GTSH[516], institucioni harton procedurë të posaçme për realizimin e mbrojtjes së diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike në faqen e website të FB-së, [517]si dhe në njoftimet fizike te vendosura në stendat e sekretarisë mësimore përgjegjëse për ciklin e dytë të studimeve. |
| **Kriteri 2.** Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse. | **PO.** Departamenti i Turizmit si strukturë përgjegjëse për realizimin e këtij programi studimi, nëpërmjet personelit akademik dhe administrativ asistojnë studentët për të mundesuar kryerjen me sukses të mbrojtjes së diplomës. Për të përmbushur këtë qëllim nëpërmjet anëtarëve të stafit akademik, DT ve në dispozicion të studentëve të gjithë matërialet dhe informacionet e duhura, udhëzime e orientime sic dhe parashikohen ne rregullatorët përkatës ligjorë. [518] [519] |
| **Kriteri 3.** Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike. | **JO.** Nuk parashikohet provim final për mbrojtjen e diplomës në këtë cikël studimi. Mbrojtja e diplomës bëhet nëpermjet realizimit të punimit të temës së diplomës. |

[514] *Aneks 10 Rregullore e Diplomimeve ne Fakultetin e Biznesit, Neni 5,8,9*
[515] *Aneks 10.1 Rregullore e Tezës Diplomës në FB, Neni 5-11*
[516] *Aneks 7 Rregullore e Master Profesional GTSH*
[517] *Aneks 78 Link informues nga web site i FB dhe DT per njoftim per mbrojtjen e praktikave dhe mikrotezes per ciklin e dyte te studimeve*
[518] *Aneks 10 Rregullore e Diplomimeve ne FB, neni 4,5*
[519] *Aneks 10.1 Rregullore e Tezës së Diplomës në Fakultetin e Biznesit, neni 1,2,3*

| | |
|---|---|
| ***Kriteri 4.*** *Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.* | **PO.** Bazuar në Rregulloren e Mikrotezes dhe Diplomimeve, udhëheqësi i punimit të diplomës udhëzon dhe ndihmon studentin në përgatitjen e temës së diplomës.[520], [521]<br>Për te realizuar kete proces, udhëheqësi bashkëpunon me studentin duke caktuar dhe afate per kryerje të detyrave. Studenti me përgjegjshmërinë e tij duhet të respektojë afatet e vendosura për të mundësuar kryerjen me sukses të mbrojtjes së temës në sezonin e caktuar për mbrojtjen e diplomës. Udhëheqësi në bazë të një grafiku konsulton dhe kontrollon punën e bërë sipas planifikimit. Lektorët e DT kanë shprehur gadishmëri maksimale për mbështetje të studentëve.<br>Personeli akademik i departamentit ndihmon studentët me sqarime në lidhje me organizimin e materialit, sipas fushave që ata mbulojnë.<br>Lektori udhëheqës asiston dhe ndihmon studentin në përpunimin e të dhënave të punës kërkimore të realizuar prej tij dhe në bashkëpunim me të, ndihmon në nxjerrjen e rezultateve dhe pergjithësimet në formen e konkluzioneve, si dhe ndihmon teknikisht për formatin e tezës së diplomës në përputhje me kriteret teknike të miratuara. Studentët të cilët kanë kaluar me sukses provimet lëndore dhe kanë mbrojtur praktikën autorizohen të kryejnë punimin e temës së diplomës që mundëson dhe diplomimin e tyre.<br>Udhëheqësi në bashkëpunim me studentin harton strukturën e temës së diplomës, përzgjedh metodikën e studimit mbi realizimin e temës. Bashkëpunimi student –pedagog reflektohet përgjatë konsultimeve mbi ecurinë e punës. Studenti asistohet prej udhëheqësit që prej fillimit të kërkimit e deri në shkrimin e punimit të diplomës duke garantnuar për cilësinë e punimit dhe origjinalitetin e saj.<br>Lektori udhëheqës në përfundim të punimit harton një raport përmbledhës nëpërmjet të cilit ai miraton ose jo punimin e diplomës të studentit kundrejt dhënies së argumentave. Këtë raport ia paraqet komisionit së bashku me punimin e temës së diplomës.[522], [523] |
| ***Kriteri 5.*** *Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.* | **PO.** Lektorët e Departamenti të Turizmit në përputhje dhe me fushat e studimit dhe kualifikimit që zotërojnë asistojnë studentët për përmbledhjen dhe përunimin e të dhënave sipas fushës së interesit dhe kërkimit që studentët janë fokusuar për realizimin e temës së diplomës.[524], [525] |
| ***Kriteri 6.*** *Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me* | **PO.** Në përfundim të procesit të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë nga komisioni. Nota përfundimtare |

[520] *Aneks 10 Rregullore e Diplomimeve ne Fakultetin e Biznesit*
[521] *Aneks 10.2 Rregullore e kryerjes se mikrotezes per ciklin e studimeve MP dhe MSH në FB*
[522] *Aneks 10 Rregullore e Diplomimeve ne Fakultetin e Biznesit, neni 4-5*
[523] *Aneks 10.1 Rregullore e Tezes se Diplomes ne FB. Neni 1-3*
[524] *Aneks 10 Rregullore e Diplomimeve ne Fakultetin e Biznesit, neni 4-5*
[525] *Aneks 10.1 Rregullore e Tezes se Diplomes ne FB. Neni 1-3*

| | |
|---|---|
| *notë.* | llogaritet si mesatare e të gjitha vleresimeve të anëtarëve të komisionit.[526], [527] |
| ***Kriteri 7.*** *Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.* | **PO.** Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga MAS. Për programin e studimit të ciklit të dytë "Master Profesional" referuar nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve lëshohet diplomë "Master Profesional" në "Guidë Turistike Shqiptare" në Fakultetin e Biznesit, të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës.[528], [529], [530]<br><br>Sudentit në përfundim të studimeve i mundësohet kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar, kundrejt kërkesës së tij. Për këtë studenti ndjek standardin e rregullores së miratuar. [531], [532] |
| ***Kriteri 8.*** *Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.* | **PO.** Ne perputhje me rregullatoret ligjore institucioni kryen praktikat e duhura per ruajtjen e dokumentacionit, arshivimin dhe dhenien e informacioneve kur kerkohen nga të interesuarit[533], [534], [535], [536] |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi III.6**<br>**Institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| ***Kriteri 1.*** *Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përftimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizmin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.* | **PO.** Njësitë përgjegjëse UAMD/FB/DT, në funksion të mësimdhënies dhe përftimit të njohurive, garantojnë mjedise të përshtatshme për realizmin e praktikës profesionale në bashkëpunim dhe me institucione mbështetëse në bazë të marëveshjeve të bashkëpunimit të nënshkruara institucionalisht. [537], [538] Studentët i nënshtrohen për një periudhë 3 mujore kryerjes së praktikës në institucione publike apo biznese private ku aftësohen sipas specifikave në menaxhimin e drejtimin tureve, hartimin e itinerareve turistike, apo dhe si udhërrëfyes turistik [539]. |

[526] *Aneks 10 Rregullore e Diplomimeve ne Fakultetin e Biznesit, Neni 11*
[527] *Aneks 10.1 Rregullore e Tezës Diplomës në FB, Neni 10*
[528] *Aneks 10 Rregullore e Diplomimeve ne Fakultetin e Biznesit, Neni 12*
[529] *Aneks 10.1 Rregullore e tezes se Diplomes, Neni 10*
[530] *Aneks 15 Regjistrimi i Formës së Diplomes në MP GTSH*
[531] *Aneks 10 Rregullore e Diplomimeve ne Fakultetin e Biznesit*
[532] *Aneks 15 Regjistrimi i Formës së Diplomes në MP GTSH*
[533] *Aneks 9 Regullore e sekretarise ne FB, Neni 27*
[534] *Aneks 6 Rregullore e Fakultetit Biznesit, Neni 74*
[535] *Aneks 5 Rregullore e UAMD, Neni 84,89,90*
[536] *Aneks 54 Rregullore per qarkullimin dhe arkivimin e dokumentacionit në UAMD, Neni 17,18*
[537] *Aneks 32 Tabelë përmbledhëse me institucionet bashkëpunuese për programin e studimit dhe për praktikën profesionale*
[538] *Aneks 34 Marreveshjet e Bashkepunimit të Fakultetit të Biznesit,*
[539] *Aneks 35 Raporti periodik i përfitimeve nga marëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimeve*

| | |
|---|---|
| | UAMD në kuadër të përmirësimit të infrastrukturës në dihmë të procesit të mësimdhënies, vitet e fundit, ka investuar në blerjen e mjeteve të ndryshme audiovizive e kompjutera të cilat i shërbejnë përmirësimin të rrjetit të brendshëm të IT dhe në përdorim për realizimin e mësimdhënies mbështetur në përdorimin e teknologjisë. [540], [541] FB në bazë të marëveshjeve të bashkëpunimit me kompaninë Crystal ka mundësuar pajisjen e dy sallave laboratorike kompjuterike në funksion të mësimdhënies.[542] |
| ***Kriteri 2.*** *Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.* | **PO.** Institucioni në bashkëpunim me partnerët[543] mundëson realizimin e praktikave profesionale duke berë të mundur aftësimin praktik të studentëve me kompetencat dhe aftësi menaxheriale e drejtuese qe duhet të zotërojnë për të mënaxhuar më së miri dhe në përputhje me interesat dhe kërkesat ndaj tregut të operatorëve turstike. Nëpërmjet kesaj periudhe praktike njohja dhe aftësimi me kompetencat profesionale bëhet në kontakt te drejtperdrejte me sektore të vecantë të operatoreve turistike duke u perfeksionuar dhe në përdorimin e mjeteve teknologjike apo programe specifike në ndihmë të zbatimit të proceseve te vecanta.[544], [545] |
| ***Kriteri 3.*** *Praktikat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.* | **PO.** Praktika profesionale e zhvilluar gjate programit të studimit MP GTSH[546] në përputhje më rregullatorët ligjjorë,[547],[548] me kohezgjatje 3 mujore e vlerësuar me notë kundrejt dhe fitimit të 3 krediteve, bashkëshoqërohet me dokumentacionin përkatës të mentorëve mbi aktivizimin e studenteve dhe kompetencat profesionale te fituara gjatë kësaj periudhe. [549],[550] |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

---

[540] *Aneks 42 Të dhëna të plota për Infrastrukturën në funksion të programit të studimit Sallat/Laboratorët/biblioteka/hapësirat ndihmëse*
[541] *Aneks 42.1 Agjencia Kombetare e Informacionit,UAMD mareveshje e rinovimit te Licencave*
[542] *Aneks 74 Foto të ambienteve të punës ku zhvillohet veprimtaria mësimdhënies për programin MP GTSH*
[543] *Aneks 34 Mareveshjet e bashkepunimit te Fakultetit te Biznesit*
[544] *Aneks 35 Raporti periodik i përfitimeve nga marëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimeve*
[545] *Aneks 64 Shembuj te kryerjes se praktikave nga studentet MP GTSH*
[546] *Aneks 10.3 Rregullore e Praktikes ne FB*
[547] *Aneks 6 Rregullore e Fakultetit te Biznesit, neni 52/8,*
[548] *Aneks 7 Rregullore e Master Profesional GTSH, Neni 19*
[549] *Aneks 10.3 Rregullore Praktike ne Fakultetin e Biznesit*
[550] *Aneks 64 Shembull praktike ne MP GTSH*

## IV.BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

| **Standardi IV.1**<br><br>**Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij. | **PO.** Departamenti i Turizmit është njësi strukturore e Fakultetit të Biznesit, të UAMD-së. Detyrat dhe kompetencat e kësaj Njësie Bazë janë të përcaktuara në Statutin e UAMD[551], në Rregulloren e Njësisë Kryesore[552] dhe në Rregulloren e Departamentit të Turizmit[553]. Ai parashikon organizimin në grupe mësimore kërkimore-shkencor, në përputhje me drejtimin e programit të studimit[554].<br>Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që janë të angazhuar në realizimin e këtij program studimi kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin dhe zhvillimin e mësimdhënies, sipas përcaktimeve të rregullores së programit të studimit.<br>Në zbatim të akteve ligjore e nënligjore në fuqi FB dhe DT, angazhon si titullarë të lëndëve/moduleve për programet e studimeve të ciklit të dytë Master Profesional pedagogë akademik që kanë së paku gradën shkencore "Doktor"[555]. Personeli akademik me kohë të plotë i përfshirë në këtë program studimi per v.a 2022-23 janë më tituj akademikë dhe grada shkencore "Doktor" si më poshtë[556]:<br>• 7 (Shtatë) me gradën shkencore "Doktor"<br>• 2 (Një) me Titull Akademik professor<br>DT ka të detajuara dhe të përshtatura një bazë të dhënash për personelin akademik që realizon programin. Ai pasqyron të gjitha ndryshimet që ka personeli akademik efektiv dhe me kontratë gjatë vitit akademik ku zbatohet programi i studimit. DT disponon listën e plotë të pedagogëve akademikë për secilin semestër, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe atij administrativ.[557]<br>Personeli akademik që mbulon këtë program studimi ka kryer kualifikime brenda dhe jashtë vendit, në specialitete përkatëse në fushën e turizmit. Pothuajse të gjithë janë janë me grada shkencore. Fushat akademike dhe kërkimore, të përgjithshme dhe specifike të tyre, janë në përputhje me drejtimin e përcaktuara të programit të studimit MP GTSH [558] [559]. |

[551] *Aneks 2 Statuti i UAMD, Neni 10,*
[552] *Aneks 6 Rregullore e Fakultetit të Biznesit Neni 15, pika e*
[553] *Aneks 6.1 Rregullore e Departamentit të Turizmit*
[554] *Aneks 6.1, Rregullore e Departamentit të Turizmit, Kreu III, Neni 13,Neni 14.*
[555] *Aneks 7. Rregullore e Programit të Studimit MP GTSH*
[556] *Aneks 24. Të dhëna tabelare për personelin akademik në programin studimit*
[557] *Aneks 23. Të dhëna Tabelare për personelin akademik në Njësinë kryesore*
[558] *Aneks 7. Rregullore e programit të studimit MP GTSH*

| | |
|---|---|
| | Kualifikimi i personelit akademik që mbulon këtë program studimi dhe fushat akademike e kërkimore tyre i përgjigjen natyrës dhe specifikave të lëndëve e moduleve që ata zhvillojnë dhe që në pjesën më të madhe të tyre kanë një përvojë të gjatë pune në këtë drejtim.Niveli i kualifikimit që ka stafi akademik i përfshirë në këtë program studimi pasqyrohet në veprimtarinë e gjërë botuese, kërkimore e shkencore sipas fushave specifike që mbulojnë dhe këtë gjë e vërtetojnë edhe CV akademike të tyre[560] [561]. |
| **Kriteri 2.** Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. | **PO.** Programi i studimit Master Profesional në GTSH është strukturuar në ngarkesë të bazuar në normimin juridik të përcaktuar dhe në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore në fuqi.[562] Ky program studimi dhe ngarkesa e tij mësimore është hartuar në përputhje me aktet ligjore e nënligjore përkatëse[563].<br>Ngarkesa e programit në fjalë pasqyrohet në planin mësimor, tek e cila shprehet e ndarë me orë dhe kredite sipas viteve akademike dhe semestrave përkatës.[564],[565]<br>Programi i studimit shtrihet në 1 vit akademik, i ndarë në 2 semestra, i organizuar mbi bazën e lëndëve ose moduleve dhe i vlerësuar me kredite (ECTS) çdo lëndë[566].<br>Ngarkesa mësimore dhe shpërndarja e saj dëshmon për një anagazhim optimal të personelit akademik për plotësimin e objektivave të programit të studimit në MP GTSH [567],[568]. |
| **Kriteri 3.** Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore. | **PO.** Departamenti i Turizmit ka një staf akademik me ngarkesë të plotë mësimore, e cila mbulon të gjitha programet e studimit që zhvillohen në Departament, në Fakultetin e Biznesit [569], [570]<br>Stafi akademik i cili mbulon këtë program studimi është staf full-time i kontraktuar sipas akteve ligjore në fuqi për rekrutimin e personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë. Universiteti realizon të gjitha detyrimet ligjore që i lindin nga Kontrata e Punës midis institucionit dhe stafit akademik specifikisht në termat e pagesës së sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore . [571], [572], [573],<br>Ky staf akademik ka një historik punësimi jo më pak se 5 vjet dhe të paisur me gradën "Doktor", cka garantojnë qëndrueshmërinë dhe cilësinë e personelit akademik në raport me programin e studimit.[574] [575] |
| **Kriteri 4.** Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere | **PO.** UAMD i ka të përcaktuara në dokumentacionin bazë që rregullon veprimtarinë e tij, parimet, kriteret dhe proçedurat për |

*[559] Aneks 11. Rregullore e Zyrës së Burimeve Njerëzore, Rregullore për Rekrutimin e Stafit akademik, Nidhmës dhe Administrativ në UAMD*
*[560] Aneks 20. CV e stafit akademik.*
*[561] Aneks 23. Të dhëna Tabelore për personelin akademik në programin studimit.*
*[562] Aneks 93 Udhezimi i MASR 29 "Për ngarkesën mësimore vjetore"*
*[563] Aneks 59 VKM 41 datë 24.01.2018 "Për elementët e programit të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë*
*[564] Aneks 5. Rregullorja e studimeve UAMD, Kreu III, neni 45.*
*[565] Aneks 63 Plani mësimor I programit të studimit MP GTSH*
*[566] Aneks 63 Plani mësimor I programit të studimit MP GTSH*
*[567] Aneks 93 Udhëzim i MASR, 29, datë 10.09.2018 „Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në Institucionet e Arsimit të Lartë.*
*[568] Aneks 25 Të dhëna tabelare për ngarkesën e plotë mësimore të stafit akademik në programin e studimit*
*[569] Aneks 24. Të dhëna tabelare për personelin akademik në programin studimit*
*[570] Aneks 25 Të dhëna tabelare për ngarkesën e plotë mësimore të stafit akademik në programin e studimit*
*[571] Aneks 53.1 Ligji .80/2015"Për Arsimin e Lartë", Nenet 64 dhe 66*
*[572] Aneks 11 Rregullore e Zyrës së Burimeve Njerëzore.*
*[573] Aneks 110 Procedura dhe formularët e përdorur për rekrutimin e personelit akademik në UAMD*
*[574] Aneks 110.1 Kontrata e punës së stafit akademik përgjegjës në programin e studimit*
*[575] Aneks 110.2 Vertetim mbi pagesen e sig.shoqerore dhe shendetesore te stafit akademik*

| | |
|---|---|
| të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit. | punësimin e personelit akademik efektiv me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme[576]. Kriteret shpallen publikisht në WEB zyrtarë të UAMD dhe përzgjedhja bëhet me konkurs. Zyra e burimeve njerëzore mban dhe ruan një bazë të plotë dhe të qartë të raporteve të rekrutimit të stafit akademik, njoftimeve për punë, konkurseve, etj.[577]<br>Në realizimin e programit të studimit Master Profesional në GTSH sipas planit mësimor të miratuar, janë të përfshirë 7 punonjës personel akademik me kohë të plotë [578] Rekrutimi i tyre është bërë sipas kuadrit ligjor në fuqi dhe në zbatim të rregullave të përcaktuara në Rregulloren e Zyrës së Burimeve Njerëzore, në UAMD.<br>Personeli akademik me kohë të plotë i angazhuar në realizimin e këtij programi studimi, plotëson të gjitha kërkesat ligjore në fuqi në lidhje me kualifikim dhe pranimin e tyre[579]. |
| **Kriteri 5.** Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit. | **PO.** Fakulteti i Biznesit si njësi kryesore, pjesë e të cilit është Departamenti i Turizmit, përmbushin të gjithë detyrimet ligjore dhe nënligjore lidhur me organizimin dhe strukturën akademike të tyre për personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, siç është i përcaktuar në aktet nënligjore[580] dhe rregulloret e studimit[581].<br>Departamenti i Turizmit, i cili është njësia përgjegjëse për zbatimin e këtij program studimi, përmbush të gjithë detyrimet ligjore dhe nënligjore lidhur me organizimin dhe strukturën akademike dhe ndihmëse të tij për realizimin e proçeseve mësimore laboratorike dhe praktika mësimore[582], [583].<br>Mbështetur në natyrën specifike të këtij programi studimi, personeli ndihmës akademik angazhohet në kryerjen e praktikave mësimore në terren, sipas detajimit të programit mësimor të përcaktuar në syllabuset e lëndëve/moduleve[584] dhe të përcaktuara në planet kalendarike sipas javëve.<br>Personeli ndihmës akademik i departamentit që është i përfshirë në zbatimin e këtij programi studimi, kanë një nivel të kënaqshëm kualifikimi[585] (në pjesën më të madhe të tyre kanë kryer ciklin e dytë të studimeve Msc.). |
| **Kriteri 6.** Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe | **PO.** Institucion në mënyrë të vazhdueshme mbledh, ruan dhe përditëson të dhënat e personelit akademik që angazhohet në programin e studimit master professional GTSH duke ndjekur ecurinë akademike dhe ngarkesën e tyre mësimore në funksion të rritjes së cilësisë dhe ruajtjes së standarteve akademike në mësimdhënie. [586],[587],[588] |

[576] *Aneks 11. Rregullore e Zyrës së Burimeve Njerëzore.*
[577] *Aneks 110 Procedura dhe formularët e përdorur për rekrutimin e personelit akademik në UAMD*
[578] *Aneks 23. Të dhëna Tabelore për personelin akademik në programin studimit.*
[579] *Aneks 11. Rregullore e Zyrës së Burimeve Njerëzore.*
[580] *Aneks 2. Statuti i UAMD, Kreu V neni 52.*
[581] *Aneks 6. Rregullore e Fakultetit të Biznesit, Kreu II, neni 22.*
[582] *Aneks 7. Rregullore e Programit të Studimit Master Profesional "Guida Turistike Shqiptare"*
[583] *Aneks 22. CV e stafit ndihmës akademik..*
[584] *Aneks 67. Syllabuset mësimore pas riorganizimit, pjesa praktike.*
[585] *Aneks 22. CV e stafit ndihmës akademik .*
[586] *Aneks 25. Të dhëna tabelare me ngarkesën e plotë mesimore të stafit akademik të programit te studimit MP GTSH*
[587] *Aneks 73. Informacion nga DPMJ në lidhje me mobilitetet e stafit akademik dhe administrativ*
[588] *Aneks 131 Rregullore e mbajtjes së bazës së të dhënave të kërkimit shkencor*

| | |
|---|---|
| administrativ. | |
| **Kriteri** 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit. | **PO.** Universiteti në funksion të Fakultetit të Biznesit dhe programeve që ofron ky institucion ka lidhur nnjë numër të konsiderueshëm marrëveshjë bashkëpunimi më institucione homologe, me aktorë të biznesit, vendas apo të huaj të cilët ofrohen për kryerjen e praktikave profesionale të studentëve. [589]<br>Departamenti i Turizmit në zbatim të programit të studimit, në bashkëpunim me FB, ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucione të tjera homologe brenda vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ ose të huaj për kryerjen e praktikave profesionale të studentëve, e cila është pjesë përbërëse dhe e rëndësishme e kurrikulës të studimeve.[590],[591],[592]<br>Njëkohësisht, departamenti ka vënë në dispozicion dhe ka mbuluar me personel akademik edhe shumë veprimtari të tjera specifike që janë kryer nga vetë departamenti apo nga institucione te tjera, si konferenca në fushën e turizmit, panaire, etj, ku personeli akademik i ngarkuar ka bashkëpunuar ngushtësisht me studentët për rritur nivelin e pjesemarrjes së studentëve dhe përfshirjen e tyre në këto veprimtari[593]. |
| **Kriter 8.** Personeli mbikëqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës, si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale. | **PO.** Ndërtimi i programit të studimit MP GTSH është organizuar në mënyrë të tillë që çdo student realizon në semestrin e dytë[594], praktikë profesionale e vleresuar me 3 kredite, (kjo e përcaktuar në programin e studimit)[595],[596],[597] e cila mbrohet përpara një komisioni vlerësimi i krijuar çdo vit nga Përgjegjësi i Njësisë Bazë mbasi është kryer procesi I vlerësimit të praktikës nga ana e personelit mbikqyrës. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi IV.2** | |
|---|---|
| **Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit.** | |
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |

[589] *Aneks 129 Marrëveshjet e bashkepunimit UAMD*
[590] *Aneks 31. Tabelë përmbledhëse me institucionet bashkëpunuese për programin e studimit MP GTSH*
[591] *Aneks 34. Marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione të ndryshme për programin e studimit MP GTSH*
[592] *Aneks 35. Raport periodic analitik I përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit.*
[593] *Aneks 81. Aktivitete te kryera nga lektoret e departamentit të turizmit gjatë viteve 2018-2021*
[594] *Aneks 5.Rregullorja e Studimeve UAMD, Kreu III , Neni 45.*
[595] *Aneks 63 Plani mësimor i programit të studimit MP GTSH*
[596] *Aneks 7, Rregullore e programit të studimit.*
[597] *Aneks 64 Shëmbull i kryerjes së praktikës profesionale në programin e studimit MP GTSH*

| | |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse. | **PO.** UAMD gjithnjë ka synuar krijimin e hapësirave të posaçme të cilat ndikojnë në zhvillimin efikas studimor-kërkimor por edhe atë social për stafin dhe studentët. Për të arritur këtë synim janë bërë përpjekje për të rritur hapësirat ndërtimore duke ulur densitetin e studentëve për metër katror[598],[599], si edhe duke parashikuar si të drejtën e tyre përdorimin e infrastrukturës që i'u vihet në dispozicion të procesit mësimor, si edhe të përfitojnë nga shërbimet mbështetëse që ofrohen nga Fakulteti[600] .<br>UAMD , ku bën pjesë FB dhe Departamenti i Turizmit, ka përmirësuar e vënë në dispozicion ambjente të reja dhe komode me pajisje teknologjie të nevojshme për realizimin e studimit e qëndrimit të lektorëve e studentëve të tij.<br>Institucioni ka zgjeruar dhe përmirësuar vit pas viti ambjentet universitare, duke ndërtuar godina të reja me qëllim zgjerimin dhe modernizimin e ambjeteve ku zhvillohet mësimdhënia universitare. Ky zgjerim dhe modernizim ka lehtësuar në pasjen e shumë sallave, laboratorëve, e auditorëve me pajisje me mjete didaktike moderne për t'u përdorur nga pedagogët të cilat ndikojnë drejt përmirësimit të vazhdueshëm të proçesit mësimor. |
| **Kriteri 2.** Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies -mësimnxënies. | **PO.** Departamenti i Turizmit, pjesë e UAMD, ka mjedise të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike brënda auditorëve, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse. Kjo gjë dëshmohet me auditorët në kampusin universitarë në Spitallë, një ambjent studimor modern me kushte e kapacitete mjaft të mira për synimet kërkimore-mësimore.<br>Përmirësimi i brendshëm i infrastruturës së auditorëve, mjediseve të punës për zhvillimin individual të studentëve dhe të leksioneve bashkëkohorë ka mundësuar studimin dhe përdorimin e teknologjisë brenda kampusit[601],[602]. Këto mjedise janë të mjaftueshme për numrin e studentëve në përputhje me specifikën që kanë lëndët dhe modulet e zhvilluara brenda auditorëve.<br>Për mirëfunksionimin dhe rritjen e nivelit të mësimdhënies dhe mësimnxënies, Departamenti i Turizmit ka krijuar mundësinë dhe ka të pajisur të gjitha mjediset e tij mësimore si: laboratorin e auditorët, me pajisje moderne elektronike për përdorimin e teknologjisë së informacionit (mjete audio-vizive), internetit në auditore për lektorët. Ato lehtësojnë aplikimin e metodave të reja ndërvepruese dhe komunikuese me studentët, duke u ndërthurur me kurrikulën lëndore (syllabus)[603].<br>Departamenti Turizmit ka në dispozicion të zhvillimit të kurseve për programin e masterit, ambjente komode e të mjaftueshme që planifikohen nga dekanati dhe paraqiten për miratim në njësinë bazë. Ndërkaq DT disponon dy laboratore të pajisur me mjete të teknologjisë digjitale i cili do të ndihmojë procesin cilësor të mësimdhënies dhe hulumtimit individual të studentëve me risitë që nevojiten në aspektin formues professional të studentëve që do të |

[598] *Aneks 3 Strategjia e Zhvillimit të Universitetit UAMD, 2016-2020, Kreu V, f.39-41*
[599] *Aneks 3.2 Plani I Zhvillimit Strategjik të UAMD 2020-2025*
[600] *Aneks 6 Rregullore e Fakultetit të Biznesit, Kreu IV, Neni 80, pika d.*
[601] *Aneks 3.2 Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD 2020-2025*
[602] *Aneks 42.1 Marrëveshjet e bashkepunimit ndërmjet UAMD me Agjensinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, Prot 2829, Dt.28.05.2019*
[603] *Aneks 6 Rregullore e Fakultetit të Biznesit, Neni 48.*

| | |
|---|---|
| | ndjekin programin e studimit MP GTSH.<br>Auditorët ku zhvillohet mësimi kanë tryeza\banka dhe karrige kudo ulen studentët. Sallat kanë kapacitet që të zhvillojnë mësim njëkohësisht 40, 60 dhe 70 studentë. Po ashtu, sallat kanë dërrasë, foltore për pedagogët dhe tryezën e karrige për pedagogët.[604]<br>Mjediset e Godinës 2, Kampus, Durrës, ku është pozicinuar Departamenti të Turizmit dhe do të zhvillohet mësimi për studentët që do të ndjekin programin e studimit MP "Guidë Turistike Shqiptare" janë të pajisura me sisteme kondicionimi në auditore dhe në zyrat e stafit akademik, të sekretarisë dhe ambjete shplodhëse me qëllim krijimin e kushteve sa më të përshtatshme të studentëve, stafit akademik dhe atij administrativ[605].<br>Mjediset e Departamentit të Turizmit ndodhen në katin e dytë të Godinës nr. 2 në Kampusin Universitarë. Ky department disponon tri zyra të cilat janë të shpërndara në mënyrë që të punojnë individualisht lektorët. Ato janë të pajisura me tryeza pune, kompjuter, printera, skaner, fotokopje, videoprojektorë, rafte, dollape dhe karrige zyre |
| **Kriteri 3.** Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi. | **PO**. Laboratorët që përdoren për mësimdhënie e kërkim shkencorë në programin MP GTSH kanë nisur të përdoren që në hapjen e këtij program studimi.<br>Këto laboratorë gjendet në katin e tretë të godinës nr.2, pranë Fakultetit të Biznesit[606] në Spitallë. Ato i shërbejë stafit akademik dhe atij studentor për realizimin e mësimdhënies profesionale dhe kërkimit shkencorë. Laboratorët jënë të pajisura me xhama dhe janë të veshura me leter jotransparente. Ato kanë dalje në një ballkon të gjatë pjesë e strukturës së laboratorit. [607]<br>Secili nga ato është i pajisur me 30 tavolina teke, me 5 dalje prizash dhe me një kapacitet prej 30 pc dhe me lidhje ëireless dhe eternet. Në vijim departamenti do të vijojë me vendosjen e programeve të caktuara të programeve mësimore që do të ndikojnë në cilësinë e mësimdhënies dhe ndërveprimin online në grupet e punës e hulumtimit online. |
| **Kriteri 4.** Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron. | **PO.** Siç e përmendëm pak më sipër, Departamenti i Turizmit ka në përdorim 2 laboratorë të teknologjisë së informacionit[608]. Ato janë të pajisura me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit, të instaluar në secilin PC ku studentët ulen, me lidhje direkte me PC e lektorit që do e hapi dhe përdori programin.<br>Natyrisht, ende nuk janë të instaluara të gjitha programet profesionale sipas natyrës së programit të studimit për shkak të kostove të larta që disa programe kanë për tu blerë dhe përdorur. Pavarisht kësaj, institucioni po bën përpjekje çdo vit që të shtoj më shumë programe studimi, mbështetur në politikën institucionale të UAMD për të rritur cilësinë akoma dhe më shumë.. |
| **Kriteri 5.** Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të | **PO**. Departamenti i Turizmit i ka kapacitete e materiale të mjaftueshme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe mësimeve praktike në terren, mbështetur në bashkëpunimin me institucione dhe |

[604] *Aneks 74 Ambjentet e mësimdhënies në Fakultetin e Biznesit, foto*
[605] *Aneks 42 Të dhëna për infrastrukturën ne funksion te programit te studimit*
[606] *Aneks 42 Të dhëna për infrastrukturën ne funksion te programit te studimit*
[607] *Aneks 74 Ambjentet e mësimdhënies per programin MP GTSH, ne Fakultetin e Biznesit, foto*
[608] *Aneks 42 Të dhëna për infrastrukturën ne funksion te programit te studimit*

| | |
|---|---|
| posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatore me kapacitetet e nevojshme. | subjekte të tjera private e shtetërore që operojnë në sektorin e Turizmit. [609]<br>Departamenti Turizmit për të pasur bashkëpunime dypalëshe që i shërbejnë dijes, praktikës dhe takimeve të ndryshme shkencore e sociale ka nënshkruar dhe aktualizuar shumë nga marrëveshjet me subjekte private dhe turistike, si edhe me institucione qeverisëse siç janë: Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare, Durrës, (DRKK), CEAPAL dhe Risi Albania. Me DRKK Durrës, MuzehLab, QZHDI, etj.[610] Departamenti Turizmit ka ofruar konsulta dhe ka zhvilluar mjaft takime[611] për mendim-marrje në drejtim të zhvillimit dhe njohjes së trashëgimisë kulturore e menaxhimin e siteve arkeologjike.[612]<br>Në të njëtën kohë, nga bashkëpunimet me subjekte private e qeverisëse janë kryer e mundësuar edhe veprimtari të tjera si paktika mësimore, e leksione jashtë auditorit të kryera me sukses gjatë 4 viteve të ekzistencës së këtij programi studimi. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi IV.3**<br><br>**Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme)** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit. | **PO.** Programi i Studimit Master Professional GTSH mbështetet nga literaturë bazë dhe ndihmëse e përcaktuar kjo në syllabuset e lëndëve përkatëse nga stafi akademik dhe I miratuar nga përgjegjësi i njësisë bazë. [613]<br><br>Literatura bazë në mënyrë specifike ofrohet në gjuhën e programit të studimit , në gjuhën shqipe, dhe ju vihet në dispozicion studentëve në format të printuar ose on line nëpërmjet komunikimit me email.<br><br>Ndërsa, literature ndihmëse, në vartësi të temave të ndryshme të syllabusit, ju vihet ne dispozicion në gjuhen shqipe por edhe ne gjuhë të huaj, kryesisht në anglisht.<br><br>Si literatura bazë edhe ajo ndihmëse janë element të rëndësishëm dhe ndikojnë drejtpër drejtë në pasurimin e dijeve dhe njohurive bazë të nevojshme për studentët që frekuentojnë këtë program studimi. |

[609] *Aneks 34. Marrëveshjet e bashkëpunimit te FB*
[610] *Aneks 31. Tabelë përmbledhëse me institucionet bashkëpunuese për programin e studimit MP GTSH*
[611] *Aneks 92 Relacion mbi udhetimin studimor ne liqenet e Belshit dhe Seferaj*
737 *Aneks 80 Vendim Dekani "Për ngritje e komisionit për mbrojtjen e Mikrotezës dhe te praktikes per MP GTSH", 2021-2022*
738 *Aneks 136 Urdher Rektori per ngritje grupi pune per promovimin e UAMD .*

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | Departamenti ndihmon në përhapjen e informacionit në kategorinë e bizneseve të interesuara duke kontaktuar ata drejtëpërdrejtë pas fushatës së marketingut.<br>Për programin e studimit ndiqen politika marketing të cilat e bëjnë atë transparent për studentët dhe publikun e interesuar[739],[740]. | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi V.3**<br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit | **PO** Fakulteti i Biznesit, nëpërmjet zyrave përkatëse, sistemit të menaxhimit të informacionit dhe sekretarisë së Masterit, informon studentët në lidhje me: strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.<br>Në Rregulloren e Brendshme të studimit në programin e studimit MP GTSH, Rregulloren e Fakultetit të Biznesit përcaktohen qartë struktura dhe kohëzgjatja e programit të studimit. Dekanati së bashku me Shefat e Departamenteve organizojnë prezantime me studentët e interesuar për elementë më të hollësishëm. [741],[742],[743],[744]. Ditën e parë të fillimeve të studimeve, është realizuar një takim informues mes studentëve pjesëmarrës dhe përgjegjëses së departamentit të turizmit së bashku me prezantimin e lektorit të orës së parë .<br>Këto informacione publikohen në mënyrë të hollësishme dhe në faqen zyrtare të ëebsite të UAMD-së si dhe shpërndahen nga Zyra e Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës[745],[746]. |
| **Kriteri 2.** Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese. | **PO** Fakulteti i Biznesit, nëpërmjet zyrave përkatëse, sistemit të menaxhimit të informacionit dhe sekretarisë së Masterit, vendos në dispozicion të studentëve kurrikulat dhe gjithë informacionin e nevojshëm ku mbështetet gjithë programi i studimeve si dhe veprimtarirë formuese që lidhen me programin[747],[748],[749].<br>Rregullorja e Fakultetit të Biznesit, Rregullore e Programit të studimit janë dokumentacioni themelor ku përcaktohen qartë informacionet e nevojshme. [750],[751],[752].<br>Pergjegjësi i Departamentit udhëzon studentët për çdo informacion të |

[739] *Aneks 51 Politika e Marketingut te Programit te studimit.*
[740] *Aneks 51.2 Takim Alumni për prezantim Programin e Studimit MP GTSH 2018-02019*
[741] *Aneks 6. Rregullore e Fakultetit të Biznesit,Neni 33.*
[742] *Aneks 7. Rregullore e Programit të studimit MP GTSH Neni 19; Neni 20, Neni 21; Neni 22; Neni 23*
[743] *Aneks 9. Rregullore e Sekretarise Mësimore në Fakultetin e Biznesit Neni 6; Neni 7; Neni8; Neni 9; Neni 10; Neni 11; Neni 12*
[744] *Aneks 10. Rregullore e Diplomimeve në Fakultetin e Biznesit, Neni 5; Neni 6; Neni 7; Neni 8; Neni 9; Neni 10; Neni 11; Neni 12; Neni 13.*
[745] *Aneks 51.2 Takim Alumni për prezantim Programin e Studimit MP GTSH*
[746] *Aneks 12. Regullore Sekt. i Komunikimit, Alumnit & Karrieres, Neni 9, Neni 10, Neni 11*
[747] *Aneks 6. Rregullore e Fakultetit të Biznesit, Neni 51, Neni 52, Neni 53, Neni 54, Neni 55, Neni 56, Neni 57*
[748] *Aneks 7. Rregullore e Programit të studimit MP GTSH, Neni 19, Neni 20, Neni 21, Neni 22*
[749] *Aneks 10.3. Rregullore Praktike ne Fakultetin e Biznesit*
[750] *Aneks 10.1. Rregullore e Mikrotezës në Fakultetin e Biznesit Neni 1, Neni 2,Neni 3,Neni4, Neni 5, Neni 6, Neni .; Neni 9, Neni 10*
[751] *Aneks 9. Rregullore e Sekretarisë Mësimore në Fakultetin e Biznesit*
[752] *Aneks 50. Të dhëna nga plani i financimit të programit të studimit*

| | |
|---|---|
| | nevojshëm në takime të posacme me ta[753], [754], [755][756], [757], [758]. |
| **Kriteri 3.** Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës. | **PO** Fakulteti i Biznesit dhe kryesisht Departamenti i Turizmit, gjatë vitit akademik informon dhe mbështet studentët për orientimin e tyre profesional dhe mundësinë e punësimit[759].<br>Gjithashtu, Zyra e Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës me objektiv kryesor mbështetjen dhe orientimin e studentëve në tregun e punës, realizon evidentimin e të dhënave të studentëve dhe gjurmimin e tyre në tregun e punës[760], [761].<br>Stafi i Departamentit të Turizmit, në lidhje të ngushtë me biznesin turistik orientojnë studentëve drejt mundësive të punësimit në rajonin e Durrësit, por jo vetëm[762],[763]. Kordinatori i Masterit Profesional GTSH, mban kontakte të vazhdueshme me bizneset dhe së bashku me lektorët ndërmjetësojnë proçesin e kryerjes së praktikave mësimore[764], [765], [766].<br>Informacione mbi mundësitë e punësimit publikohen dhe në faqen zyrtare të website të fakultetit si dhe në rrjetet sociale të departamentit [767]. |
| **Kriteri 4.** Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e proçesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. | **PO** Fakulteti i Biznesit, nëpërmjet zyrave përkatëse, sistemit të menaxhimit të informacionit dhe sekretarisë së Masterit, vendos në dispozicion të studentëve kurrikulat dhe gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor. [768] Pedagogët shpërndajnë kurrikulën,syllabuset në prezantimin e parë me studentët por dhe informacionet në lidhje me literaturën, rastet studimore, vizitat studimore etj[769].<br>Në faqen zyrtare të Fakultetit ë Biznesit, gjenden të publikuara të dhënat për pedagogë dhe fushat e tyre të studimit, të cilat mund të konsultohen nga studentët dhe në realizimin e temave të diplomave[770], [771], [772], [773].<br>Studentët njihen gjithashtu edhe me infrastrukturën dhe logjistikën e zhvillimit të programeve të studimit. Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës disponon kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për zhvillimin e proçesit mësimor. Informacioni lidhur me logjistikën dhe infrastrukturën apo shërbime të tjera të nevojshme për realizimin e programit të studimit janë të aksesueshme nga studentët[774], [775]. [776], [777], [778]. |

[753] *Aneks 14. Aplikimi i progrmait MP GTSH*
[754] *Aneks14.1. Dosja e plotë e riorganizimit të Programit të studimit MP GTSH*
[755] *Aneks 19. Syllabuset e lëndëve në fazë aplikimi*
[756] *Aneks 67. Silabuset e reja me ndryshimet pas riorganizimit nen 20% MP GTSH*
[757] *Aneks 47. Të dhëna nga faqja zyrtare UAMD*
[758] *Aneks 48. Stretegjia e Komunikimit UAMD*
[759] *Aneks 6. Rregullore e Fakultetit të Biznesit, Neni 45, Neni 46, Neni 47, Neni 48*
[760] *Aneks 12. Regullore Sekt. i Komunikimit, Alumnit & Karrieres*
[761] *Aneks 29. Të dhëna tabelare për punësimin real të studentëve të programit MP GTSH*
[762] *Aneks 32. Tabelë përmbledhëse me institucionet bashkëpunuese për pragramin e studimit*
[763] *Aneks 105. Njoftim bizneseve turistike dhe shoqatave të sektorit për hapjen e MP GTSH*
[764] *Aneks 34. Marreveshje Bashkëpunimi te FB*
[765] *Aneks 33. Tabelë përmbledhëse për trajnimet profesionale për studentët*
[766] *Aneks 35. Raporti analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit*
[767] *Aneks 106. Njoftime në mediat sociale për pjesëmarrje në trajnime, mobilitete, vende pune*
[768] *Aneks 6 Rregullore e Fakultetit të Biznesit Neni 45, Neni 46, Neni 47, Neni 48*
[769] *Aneks 7 Rregullorja e Programit të Studimit MP GTSH*
[770] *Aneks 19 Syllabuset e lëndëve në fazë aplikimi*
[771] *Aneks 67. Silabuset e reja me ndryshimet pas riorganizimit nën 20% MP GTSH*
[772] *Aneks 24. Të dhëna tabelare për personelin akademik në programin e studimit*
[773] *Aneks 65. Fushat e studimit të lektorëve të Departamentit të Turizmit*
[774] *Aneks 42. Të dhëna për infrastrukturën në funksion të programit të studimit*
[775] *Aneks 46. Udhëzues për përdorimin e strukturës së teknologjisë së informacionit*
[776] *Aneks 47. Të dhëna nga faqja zyrtare WEB e UAMD*

| | |
|---|---|
| **Kriteri 5.** Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance. | **PO** Informacioni në lidhje me programin e studimit është i aksesueshëm jo vetëm nga studentët që janë të pranishëm në Fakultet por edhe nga ata në distancë, kjo e përcaktuar si në Rregulloren e Masterit GTSH, Rregulloren e sekretarisë mësimore dhe Rregulloren e Fakultetit[779],[780],[781],[782].Universiteti realizon veprimtarinë e tij bazuar në një infrastrukturë teknologjike në nivele të larta. Përmes sistemit të brendshëm të menaxhimit të informacionit studentëve u ofrohet informacion i detajuar lidhur me programin e studimit, i aksesueshëm edhe në distancë. [783]Gjithashtu, përdorimi edhe i rrjeteve sociale dhe formave të tjera të komunikimit si email-i, Fakulteti i Biznesit dhe Departamenti i Turizmit u mundësojnë studentëve informacion në distancë.<br>Të dhëna mbi informacionin e nevojshëm publikohen herë pas here, në udhëzues dhe faqen zyrtare të UAMD-së.<br>Studentët në distancë kontaktohen si nga sekretaria mësimore ashtu dhe nga Drejtuesja e Departamentit në lidhje dhe me procedurat e diplomimit. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi V.4**<br>**Instituticioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit. | **PO** Fakulteti i Biznesit nëpërmjet sistemit të brendshëm të menaxhimit të informacionit, disponon dhe mban statistika vjetore për çdo program studimi.Njësi të ndryshme si Zyra e Këshillimit dhe Karrierës dhe Sekretaria Mësimore e Fakultetit të Biznesit mbajnë statistika vjetore lidhur me numrin e studentëve aktualë dhe atyre të diplomuar në programin e studimit,[784],[785],[786].<br>Programi i studimit MP GTSH synon të sigurojë mbajtjen e të dhënave si një kërkesë e normuar në aktet rregullatore të universitetit, të cilin fillon ta zbatojë me diplomimin e brezit të parë të masterit në vitin akademik 2019-2020[787],[788],[789]. |
| **Kriteri 2.** Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo | **PO** Fakulteti i Biznesit nëpërmjet sistemit të brendshëm të menaxhimit të informacionit, disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve të rregjistruar në programin e studimit, si dhe largimet para përfundimit të studimeve apo mospërfundimin |

[777] *Aneks 48. Strategjia e Komunikimit - UAMD*
[778] *Aneks 51. Politika e Marketingut të programit të studimit*
[779] *Aneks 6. Rregullore e Fakultetit të Biznesit*
[780] *Aneks 7. Rregullorja e Programit të Studimit MP GTSH*
[781] *Aneks 9. Rregullore e Sekretarisë Mësimore në Fakultetin e Biznesit*
[782] *Aneks 48. Strategjia e Komunikimit - UAMD*
[783] *Aneks 9. Rregullore e Sekretarisë Mësimore në Fakultetin e Biznesit*
[784] *Aneks 2. Statuti UAMD, Neni 91,Neni 92*
[785] *Aneks 6. Rregullore e Fakultetit të Biznesit*
[786] *Aneks 7. Rregullorja e Programit të Studimit MP GTSH*
[787] *Aneks 27. Të dhëna tabelare mbi rregjistrimin, ecurinë, diplomimin e studimeve, nota mesatare*
[788] *Aneks 48. Strategjia e Komunikimit - UAMD*
[789] *Aneks 51. Politika e Marketingut të programit të studimit*

| | |
|---|---|
| mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve. | me sukses të vitit akademik në programin e Master Profesional GTSH. Këto të dhëna përpunohen dhe përditësohen përmes Sekretarisë Mësimore të Fakultetit të Biznesit[790]. |
| **Kriteri 3.** Të dhënat statistikore të studenëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar. | **PO** Fakulteti i Biznesit nëpërmjet sistemit të brendshëm të menaxhimit të informacionit disponon dhe mban statistika për ecurinë e studentëve gjatë gjithë periudhës së studimeve[791]. Këto të dhëna regjistrohen dhe menaxhohen nga Sekretaria Mësimore.[792]<br>Të dhënat statistikore ku përfshihen rregjistrimet, ecuria, diplomimi, nota mesatare në hyrje dhe dalje janë konfidenciale dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar ku bëjnë pjesë punonjës akademikë dhe administrativë të cilët gëzojnë të drejtën e menaxhimit të informacionit.[793], [794], [795], [796], [797], [798]. |
| **Kriteri 4.** Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse. | **PO** Universiteti "Aleksandër Moisiu" ka të rregulluar me akte ligjore të gjithë funksionimin dhe mbajtjen e te dhënave statistikore në lidhje me studentët në hyrje dhe në dalje. Mbajtja,menaxhimi dhe siguria e tyre është një kërkesë ligjore e normuar nga aktet rregullatore të universitetit.[799], [800], [801]. |
| **Kriteri 5.** Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studenëve, si dhe shkallën e cilësisë të punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve | **PO** Fakulteti i Biznesit dhe Departamenti i Turizmit hartojnë raporte analitike mbi profilin e studentëve në hyrje dhe hartojnë raportin vjetor të arritjeve akademike në fund të vitit. Në analizën mësimore vjetore në nivel departamenti vlerësohet cilësia në hyrje dhe dalje e studentëve[802], [803]. Raporti vjetor i departamentit, i kalohet Fakultetit të Biznesit, i cili e përfshin atë në Raportin Vjetor të Vlerësimit të Cilësisë.[804]<br>Gjithashtu, kontaktet e vazhdueshme të Departamentit të Turizmit dhe Zyrës së Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës me studentët e diplomuar mundësojnë përpilimin e tabelave me të dhëna mbi cilësinë e punësimit[805]. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |
| | | | | |

**Standardi V.5**

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e**

[790] *Aneks 27. Të dhëna tabelare mbi rregjistrimin, ecurinë, diplomimin e studimeve, nota mesatare*
[791] *Aneks 27. Të dhëna tabelare mbi rregjistrimin, ecurinë, diplomimin e studimeve, nota mesatare*
[792] *Aneks 6. Rregullore e Fakultetit të Biznesit*
[793] *Aneks 5. Rregullore e UAMD Neni 83, Neni 89*
[794] *Aneks 2. Statusi i UAMD, neni 93*
[795] *Aneks 6. Rregullore e Fakultetit të Biznesit Neni 73, Neni 74, Neni 80*
[796] *Aneks 7. Rregullorja e Programit të Studimit MP GTSH*
[797] *Aneks 9. Rregullore e Sekretarisë Mësimore në Fakultetin e Biznesit Neni 3, Neni 4,Neni 6,Neni 11,Neni 27*
[798] *Aneks 51.1. Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale*
[799] *Aneks 54. Rregullore për Qarkullimin dhe Arkivimin e dokumentacionit në UAMD*
[800] *Aneks 5. Rregullore e UAMD Neni 83, Neni 89*
[801] *Aneks 2. Statusi i UAMD, neni 93*
[802] *Aneks 38.1. Analiza vjetore e Departamentit për Programin e studimit MP GTSH*
[803] *Aneks 38. Analiza vjetore e Departamentit të Turizmit 2020-2021*
[804] *Aneks 37. Raporti Vjetor për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë FB*
[805] *Aneks 29. Të dhëna tabelare për punësimin real te studentëve të MP GTSH*

| |
|---|
| **këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.** |
| |

| Kriteret | Vlerësimi |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit. | **Po.** UAMD parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe akteve rregullatore ku bëjnë pjesë: Ligji 20/2015 "Për Arsimin e Lartë",Statutin e UAMD-së, Rregulloren e UAMD[806],[807].<br>Studentët e UAMD-së marrin pjesë në përfaqësimin e organeve drejtuese të Universitetit si Senati, në nivel fakulteti në Komisionin e Etikës apo Komision për Sigurimin e Cilësisë dhe Këshillat Studentore[808]. |
| **Kriteri 2.** Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme. | **Po.** UAMD si institucion i arsimit të lartë, bazuar në Statutin e saj dhe aktet e tjera normative garanton përfshirjen e studentëve në organet vendimmarrëse dhe konsultative që ajo ka si mekanizma të mbarëvajtjes së punës. Kështu Senati Akademik në UAMD përbëhet nga 21 anëtarë, ku 2 prej tyre janë student [809].<br>Studentët përfaqësues në organet e mësipërme, shprehin opinionin e tyre për çështje të cilësisë në programin e studimit, etikës së studentëve, stafit akademik, praktikave mësimore etj. Studentët përfaqësues shprehin opinionin e tyre për shumë tema si programet mësimore, planet mësimore dhe aktivitete të ndryshme të këshillave studentore, të cilat financohen nga buxheti i universitetit[810], [811].<br>Institucioni përdor paralelisht si mekanizem efikas për përfshirjen e studentëve në këshillimin apo vlerësimin mbi procesin akademik pyetësorët mbi procesin dhe stafin akademik. Përpunimi dhe rezultatet e nxjerra nga këta pyetësor reflektohen në raportet vjetore të institucionit dhe në marrjen e masave për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies[812], [813], [814], [815]. |
| **Kriteri 3.** Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj. | **Po.** Departamenti mbështetur në bazën ligjore garanton përfshirjen e studentëve në proceset e përmirësimit të programeve të studimit duke reflektuar pritshëritë e tyre në hartimin e programeve të reja. [816], [817], [818]<br>Masteri Profesional GTSH është në funksion që nga viti akademik 2019-2020 e në vazhdim. Në kontekstin e përmirësimit të programit të studimit, si një nga objektivat kryesore të Departamentit, janë pregatitur pyetësore për studentët të dhënat e të cilëve janë përpunuar dhe marr në konsideratë. [819], [820] |

---

806 *Aneks 2. Statuti i UAMD-së Neni 14, pika 4, 6, 7; Neni 22, pika 3; Neni 79, pika 2; Neni 89, pika 1, shkronja c; Neni 90;*
807 *Aneks 5. Rregullore e UAMD, Neni 12, pika 2; Neni 16, pika 3; Neni 17, pika 3; Neni 20, pika 3; Neni 28, pika 1; Neni 115, pika 1, shkronja b dhe c*
808 *Aneks 6. Rregullore e Fakultetit të Biznesit, Neni, 84, Neni85, Neni 22, pika 1; Neni 84, pika 1, shkronja b dhe c; Neni 88*
809 *Aneks 13. Perfshirja e studenteve ne organet vendimarrese te UAMD*
810 *Aneks 7. Rregullorja e Programit të Studimit MP GTSH, Neni 37, pika 1, shkronja b dhe c*
811 *Aneks 28. Memo për krijimin e GVB*
812 *Aneks 97.1. Raporti vjetor i UAMD për vitin akademik 2019-2020*
813 *Aneks 71. Vleresimi i stafit akademik I FB nga studentët, 2021-22*
814 *Aneks 66. Informacion mbi rezultatet e vleresimit te stafit akademik nga studentet, v.a 2021-22*
815 *Aneks 37. Raport vjetor per monitorimin dhe sigurimin e cilesise ne FB*
816 *Aneks 6.1. Rregullore e Departamentit të Turizmit*
817 *Aneks 7. Rregullore e Programit të Studimit MP GTSH, Neni 37, pika 1, shkronja b dhe c*
818 *Aneks 6. Rregullore e Fakultetit të Biznesit, Neni, 84, Neni85, Neni 22, pika 1; Neni 84, pika 1, shkronja b dhe c; Neni 88.*
819 *Aneks 72.1. Model i formularit të vlerësimit të studentëve në google form*

| | |
|---|---|
| **Kriteri 4.** Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës | **Po.** Çdo student në Universitetin "Aleksandër Moisiu", Durrës mund të japë opinionin e tij lidhur me proçesin e vlerësimit dhe kontrollit të dijeve. Kjo realizohet përmes plotësimit të pyetësorit të studentit dhe ndjekjes së proçedurave të ankimimit.[821]<br>Studentëve të cilët janë pjesë e programit të studimit në GTSH, u kërkohet nga ana e departamentit të turizmit, të shprehin mendimet e tyre, në mënyrë të pavarur dhe të fshehtë mbi barazinë e ndershmërinë e kryerje së proçesit të vlerësimit të dijeve[822], [823], [824], [825]<br>Proçesi realizohet nëpërmjet anketimit në fund të çdo semestri, duke krijuar mundësinë që dhe anëtarët e departamentit të mund të reflektojnë[826]. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi V.6**<br>**Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1** Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit. | **Po.** UAMD ka procedura të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjor si dhe akte rregullatore të cilat janë në funksion të proçesit[827].<br>Rregulloret e studimeve, Rregullore e Fakultetit të Biznesit, Rregullore e Programit të Masterit, Rregulloret e Sekretarive Mësimore, Rregullorja e Provimeve, janë të pajisura me element në shërbim të studentëve në lidhje me çdo lloj problematike të mundshme që mund të hasin gjatë studimeve akademike bazuar dhe në aktet e nxjerra nga Senati Akademik[828],.[829], [830], [831], [832], [833], [834], [835], [836]. |
| **Kriteri 2.** Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për | **Po.** Bazuar në ligjin e Arsimit të lartë dhe aktet e tjera rregullatore, UAMD ka marrë masat për krijimin e sistemit të informimit, |

[820] *Aneks 72. Përmbledhja e pyetësorit Google Form i përdorur me studentët e MP GTSH*
[821] *Aneks 40. Formati i Pyetësorit për pedagogët nga studentet*
[822] *Aneks 6. Rregullore e UAMD-së Neni 69, pika 7; Neni 71; Neni 115, pika 1, shkronja dh; Neni 120*
[823] *Aneks 7. Rregullore e Fakultetit të Biznesit, Neni 60, pika 7; Neni 62; Neni 83; Neni 84, pika 1, shkronja dh*
[824] *Aneks 8. Rregullore e Departamentit të Turizmit*
[825] *Aneks 7 Rregullore e Programit të Studimit MP GTSH Neni 17, pika 13; Neni 19; Neni 37, pika 1, shkronja f*
[826] *Aneks 66 Informacion mbi rezultatet e vleresimit te stafit akademik nga studentet, v.a 2021-2022*
[827] *Aneks 2. Statuti UAMD, Kreu VI*
[828] *Aneks 5 Rregullore e UAMD*
[829] *Aneks 6. Rregullore e Fakultetit të Biznesit*
[830] *Aneks 8. Rregullore e Departamentit të Turizmit*
[831] *Aneks 7. Rregullore e Programit të Studimit MP GTSH*
[832] *Aneks 10. Rregullore e Diplomimeve në Fakultetin e Biznesit*
[833] *Aneks 12. Regullore Sekt. i Komunikimit, Alumnit & Karrierës*

[835] *Aneks 47. Të dhëna nga Faqja zyrtare ËEB e UAMD*
[836] *Aneks 51. Politika e marketingut të programit të studimit, format, transparenca me publikun*

| | |
|---|---|
| informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit | këshillimit dhe ndjekjen e studentëve në lidhje me çështjet e procesit mësimor dhe programit të studimit.[837]<br>Në fillim të vitit akademik publikohen njoftimet përkatëse dhe këshillohen studentët nga Zyra e Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës në lidhje me programet mësimore.[838]<br>Përgjegjësi i Departamentit dhe Kordinatori i Programit informojnë studentët në mënyrë më të hollësishme për programin e studimit.[839] [840], [841], [842], [843], [844], [845]<br>Gjithashtu për të siguruar një komunikim të drejtëpërdrejtë, të shpejtë por dhe të sigurtë është krijuar sistemi i deklarimit të rezultateve Pitagora[846] së bashku me manualin e përdorimit të tij. Të gjitha të dhënat për rezultatet e studentëve ruhen në bazë të ligjit të konfidencialitetit.[847] |
| **Kriteri 3. .** Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës. | **Po.** Në funksion të akteve ligjore dhe në përgjigje të kërkesës së studentëve, UAMD ka krijuar Zyrën e Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës e cila si funksion parësor të saj ka ofrimin e mundësive për vende pune, trajnime dhe intershipe për studentët aktual dhe për ata të cilët janë diplomuar pranë Universitetit A. Moisiu.[848]<br>Zyra zhvillon aktivite me studentët duke i afruar me tregun e punës, ndihmuar në përgatitjen CV-ve, letrave të interesit dhe përgatitjet për intervista pune.[849], [850], [851] |
| **Kriteri 4.** Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse. | **Po.** Zyra e Komunikimit, Aluminit dhe Karrierës funksionon si zyrë statistikash, duke përpunuar të dhënat statistikore, mbi numrin e studentëve aktualë, atyre të cilët diplomohen. Gjithashtu Zyra e Karrierës, orienton dhe informon personat e interesuar për të vazhduar studimet në Universitetin A. Moisiu, mbi ciklet, programet e studimit që ofron Universiteti, duke përfshirë dhe Programin e Masterit Profesional " GTSH" [852] |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve ë fushës V** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|

[837] *Aneks 75. Struktura e UAMD, Prill 2019*
[838] *Aneks 12. Rregullore e Zyrës së Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës , Kreu III, Neni 10, Neni 11; Neni 12, Neni 13*
[839] *Aneks 2. Statuti UAMD, Neni 24, pika h; Neni 90*
[840] *Aneks 6. Rregullore e UAMD-së Neni 21; Neni 121*
[841] *Aneks 7. Rregullore e Fakultetit të Biznesit, Neni 88*
[842] *Aneks 8. Rregullore e Departamentit të Turizmit*
[843] *Aneks 10. Rregullore e Diplomimeve në Fakultetin e Biznesit*
[844] *Aneks 12. Rregullore e Zyrës së Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës*
[845] *Aneks 46. Udhëzues për përdorimin e teknologjisë së informacionit*
[846] *Aneks 46. Udhëzues për përdorimin e teknologjisë së informacionit* https://uamd.pitagora.rash.al/login
[847] *Aneks 51.1 Ligji "Për mbrojtjen e të dhënave personale".*
[848] *Aneks 12. Regullore Sekt. i Komunikimit, Alumnit & Karrierës*
[849] *Aneks 12. Regullore Sekt. i Komunikimit, Alumnit & Karrierës, Kreu III, Neni 10, Neni 11; Neni 12, Neni 13*
[850] *Aneks 111. Njoftime për studentët në faqen zyrtare të ËEB të UAMD*
[851] *Aneks 134. Shoqata Alumni UAMD dhe aktivitetet*
[852] *Aneks 12. Regullore Sekt. i Komunikimit, Alumnit & Karrierës, neni 12*

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT

| Standardi VI.1<br><br>**Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| ***Kriteri 1.*** *Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.* | **PO**. Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës ka si objektiv zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies dhe të të nxënit si dhe promovimin e kulturës së rritjes së vazhdueshme.Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës i kushton rëndësi shumë të madhe këtyre metodave dhe përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies sipas Rregullores së NJBSC të shprehur në *Nenin 1, dhe Nenin 5* të kësaj Rregulloreje.[853]<br>Neni 1 ka qëllimin dhe bazën ligjore për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë përmes rregullimit dhe standartizimit të vlerësimit të proceseve në insitucion.<br>Neni 5 ka standartet kryesore për sigurimin e brendshëm të cilësisë,e përbërë nga 10 standarte kryesore.<br>DKSC-së informacionet përkatëse, duke u konsultuar edhe paraprakisht me të, në rastet kur gjykohet e nevojshme. |
| ***Kriteri 2****. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik* | **PO.** Strukturat përgjegjëse përdorin forma nga më të ndryshmet për monitorimin dhe vlerësimin në mënyrë periodike të aftësive mësimdhënëse të personelit akademik dhe ndihmës akademik, mbështetur në Nenin 1 dhe 5 të Rregullores NJSBC.[854]<br><br>Disa nga mekanizmat që përdoren për monitorimin e këtyre aftësive janë: formularët e vetëvlerësimit[855] dhe CV e përditësuara të stafit akademik; formularët e vlerësimit të cilët plotësohen nga drejtuesi i njësisë bazë dhe më pas nga Dekani.<br><br>Dega mësimore angazhohet për matjen e performancës së mësimdhënies, në bazë të vlerësimit të studentëve për performancën e lektorëve. Edhe ky proces kryhet në mënyrë të automatizuar përmes projektit CleanScore, duke maksimalizuar vërtetësinë e gjetjeve[856]. |

[853] *Aneks 8 Rregullore për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë*
[854] *Aneks 8 Rregullore për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë*
[855] *Aneks 68. Formular i vetëvlerësimit të performancës së pedagogut*
[856] *Aneks 40 Formati I pyetësorit nga studentët për pedagogët*

| | |
|---|---|
| ***Kriteri** 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.* | **PO.** Studentët luajnë një rol shumë të rëndësishëm në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, dhe kjo gjë realizohet me anë të formularëve që plotësojnë çdo fund semestri si dhe me të drejtën e tyre për ankimime të shprehur në Rregulloren e UAMD-së. Gjithashtu format e përmirësimit të mësidhënies janë të specifikuara në Nenin 6 të NJSBC. [857]<br><br>Sistemi i sigurimit të cilësisë merr në konsideratë kontrollin që ndjek veprimtarinë e Universitetit përmes vlerësimit të brendshëm.[858] Zhvillimi i modeleve të vlerësimit të brendshëm në sistemin e sigurimit të cilësisë përfshin një sërë kriteresh të tilla si: vetë-analizën; treguesit e cilësisë; vlerësimin e pedagogëve nga ana e studentëve; vlerësimin e studentëve, vlerësimin e programeve mësimore; vlerësimin e pjesëmarrjes në veprimtarinë kërkimore; vlerësimin në zhvillimin e aktiviteteve konbetare, rajonale dhe më gjerë; pjesëmarrjen në zgjidhjen e problemeve të komunitetit [859]<br><br>Një nga mënyrat që përdoret për vlerësimin e cilësisë është organizimi dhe marrja e informacionit nga ana e studentëve me anë të pyetësorëve të hartuar për këtë qëllim.[860 ; 861 862;863] Në fund të çdo semestri apo para sezonit të provimeve, në UAMD organizohet anketimi i studentëve me anë të pyetësorit studentor. Ky pyetësor për të siguruar cilësinë e mësimdhënies për modulet e çdo programi studimi. Përmes zbatimit të pyetësorëve dhe përmes mbledhjeve të hapura në të cilat marrin pjesë studentët por edhe bashkëpuntorë dhe ekspertë të tjerë të jashtëm, ndërgjegjëson studentët dhe personelin për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimit të cilësisë në Universitet dhe nevojën e përmirësimit të vazhdueshëm të saj.[864] |
| ***Kriteri** 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.* | **PO.** Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, në UAMD, bëjnë publike rezultatet e vlerësimit të pyetësorit të kryer për çdo semestër akademik.[865]<br><br>Rezultatet e përftuara i vihen në dispozicion strukturave vendimmarrëse të fakultetit, si dhe në mënyrë individuale të gjithë anëtarëve të Stafit Akademik, të vlerësuar. Gjithnjë e më shumë UAMD po merr masa nga më të ndryshmet për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. |

[857] *Aneks 8 Rregullore e NJSBC -UAMD*
[858] *Aneks3 Plani Strategjik i UAMD-së 2016-2020, pika 3 & 4, prioriteti 1 & 8*
[859] *Aneks 3.2 Plani Strategjik I Fakultetit te Biznesit*
[860] *Aneksi 40 Formati I pyetësorit nga studentët për pedagogët*
[861] *Aneks 71 Vlerësim I stafit akademik te FB nga studentët,2021-22.*
[862] *Aneks 72.1 Modeli i formularit te vlerësimit në Google form*
[863] *Aneks 5 Rregullore e UAMD, neni 20*
[864] *Aneks 40 Formati I pyetësorit nga studentët për pedagogët*
[865] *Aneks 66 Informacion mbi rezultatet e vlerësimit të stafit akademik nga studentët, v.a 2021-2022*

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| *Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.* | **PO.** UAMD, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjeserisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | X |

**Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.**

| Kriteret | Vlerësimi |
|---|---|
| ***Kriteri 1.*** *Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.* | **Po.** Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.[866]<br>UAMD-ja ka krijuar strukturat e nevojshme për sigurimin e cilësisë. Njëkohësisht, duke hartuar një politikë të qartë UAMD-ja ndjek procedurën e vlerësimit periodik të efikasitetit të veprimtarive që kryen për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të studimeve që ofron. Të gjitha reflektohen në rregullores për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, vendimet për komisionet për vlerësimin e brendshëm të cilësisë.[867]<br>**Bazuar në nenin 103 të Ligjit për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin shkencorë në Republikën e Shqipërisë [868]:** "Institucionet e arsimit të lartë janë përgjegjëse për hartimin e politikave dhe proçedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Struktura dhe funksionimi i njësisë së sigurimit të brendshëm të cilësisë përcaktohen në statutin e institucionit të arsimit të lartë."<br>NjBSC janë si më poshtë[869]:<br>Misioni kryesor i NjBSC është planifikimi i përmirësimit të vazhdueshëm të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës (UAMD) dhe realizimi i proceseve që e garantojnë këtë përmirësim. Procesi i përmirësimit të vazhdueshëm mundësohet nga angazhimi i të gjitha palëve të përfshira në SSB.<br>***Fakulteti i Biznesit,*** nëpërmjet punës së Komisionit për Sigurimin e Cilësisë së Programit të Studimit dhe Kërkimit Shkencor, harton strategji dhe ndërton politika dhe procedura për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë për programet e studimit që mbulon ky fakultet. FB ka në strukturën e tij NJSBC ne nivel fakulteti i cili kryen funksione që lidhen kryesisht me kualifikimin shkencor dhe garantimin e standardeve të cilësisë të Fakultetit dhe programeve të studimit.[870] Ai monitoron në mënyrë të vazhdueshme dhe vlerëson, periodikisht, rezultatet e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore shkencore, e cila ka sjellë cilësi dhe përmbushje të standardeve edhe në programin e studimit "Master Profesional GTSH.[871] |
| **Kriteri 2.** Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen | **Po.** Institucioni ka ngritur një sistem të sigurimit të brendshëm të cilësisë I cili funcksionon në bazë të elementëve të mëposhtëm.<br>**UAMD ka te ngritur** NjBSC-në e cila kryen funksionet e mëposhtme[872]:<br>**Mbështet dhe ofron ekspertizë.** NjBSC kryen takime pune me çdo fakultetet dhe çdo departament dhe ftohet nga ana e tyre që të ofrojë ekspertizë në zhvillimin e proceseve të sigurimit të cilësisë, si dhe në asistimin e NjBSC në rang fakulteti. Ekspertiza duhet të përqendrohet |

[866] *Aneks 2 Statuti i UAMD, kreu VII "Sigurimi i Cilësisë" nenet në vazhdim*
[867] *Aneksi 8 Rregullore për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, pjesa e tretë "Misioni, Funksionet dhe Roli i NJSBC, neni 9 "Roli dhe Funksionet e NJSBC", pika 1/a*
[868] *Aneks 53.1 Ligji i Arsimit tw Lartw 80,2015*
[869] *Aneks 8 Rregullore për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë , pjesa e tretë "Misioni, Funksionet dhe Roli i NJSBC, neni 9 "Roli dhe Funksionet e NJSBC", pika 1/a*
[870] *Aneks 115 Komisioni për Vlerësimin e Brendshëm të Cilësisë në Fakultetin e Biznesit*
[871] *Aneksi 37 Raport vjetor per monitorimin dhe sigurimin e cilesisëFB , standarti i cilesise*
[872] *Aneksi 8 Rregullore për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, neni 2 "Strukturat e Brendshme të Sigurimit të Cilësisë dhe Përgjegjësitë e tyre".*

| | |
|---|---|
| studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm. | rreth aplikimit të mekanizmave për sigurimin e cilësisë për të vlerësuar në mënyrë eksplicite procesin e mësimdhënies, të nxënit, si dhe metodave moderne të vlerësimit të studentëve me qëllim promovimin e një qasjeje interaktive me në qendër studentin.<br>**Bashkërendon.** NjBSC në nivel institucional, kur procesi i delegohet NjBSC-së pranë fakulteteve, kryen një rol bashkërendues dhe mund të shtrihet edhe në njësi të tjera në universitet kur NjBSC-ja konsiderohet e lidhur me funksione të tjera si zhvillimi i personelit dhe mbledhja/analiza e të dhënave institucionale.<br><br>**Interpreton** detyrimet kombëtare dhe ato ndërkombëtare të sigurimit të cilësisë. Ajo është përgjegjëse dhe ka për detyrë të interpretojë detyrimet kombëtare dhe europiane të sigurimit të cilësisë dhe t'i përshtasë ato në kontekstin institucional të UAMD-së. NjBSC-ja garanton që këto detyrime të njihen dhe përfshihen nga IAL.<br><br>**Monitoron.** NjBSC-së ofron udhëzime, mbledh informacione, evidenton probleme. Zgjidhjet e propozuara nga NJBSC-ja mbi problematikat e evidentuara, në varësi të nivelit të problemit, përmes Rektorit, mund t'i kalojnë për shqyrtim dhe miratim Senatit Akademik ose KPGSC-së.<br><br>**Administron dokumentacione.** NjBSC-ja administron, organizon dhe përgatit vizitatë vlerësimit të jashtëm. Ajo përpunon pyetësorët në nivel institucional për matjen e cilësisë në disa nivele.<br><br>**Lehtëson**: NjBSC-ja duhet të lehtësojë krijimin e një mjedisi të favorshëm me studentin në qendër, për arsimim cilësor dhe zhvillimin e stafit akademik për të përvetësuar njohuritë dhe teknologjitë e nevojshme për një proces me pjesëmarrje aktive gjatë mësimdhënies dhe mësimnxënies.<br><br>**Siguron** informacion për cilësinë tek aktorët e brendshëm dhe të jashtëm të universitetit. NjBSC-ja siguron shpërndarjen e informacionit lidhur me treguesit e cilësisë së institucionit për aktorët e brendshëm dhe të jashtëm në zbatim të legjislacionit Shqiptar.<br><br>Gjithashtu, për të realizuar funksionet e saja institucionale NjBSC-ja duhet:<br><br>➢ Të hartojë dhe zbatojë një manual procedurash që përshkruajnë strukturën e institucionit dhe proceset për sigurimin e cilësisë;<br>➢ Të specifikoje kriteret për përzgjedhjen dhe formatet e treguesve, të standardeve dhe të objektivave;<br>➢ Të përgatisë formularët standardë për çështje të tilla si pyetesorët per studentët, administratën dhe stafin akademik, si dhe atyre alumni;<br>➢ Të këshillojë mbi procedurat operative për planifikimin dhe zbatimin e proceseve të cilësisë;<br>➢ Të mbledhë dhe të ruajë sistematikisht raportet mbi ecurinë, përfshirë të dhënat mbi treguesit dhe objektivat që do të kërkohen |

| | |
|---|---|
| | për analizën dhe raportimin e cilësisë së standardeve dhe kurrikulave.[873]<br>Në strategjinë që Institucioni harton për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë janë të përfshirë dhe student, kështu në përbërjen e Komisionin për Sigurimin e Cilësisë së Programit të Studimit dhe Kërkimit Shkencor, sipas përcaktimeve ligjore është anëtar edhe një student.[874] |
| ***Kriteri 3.*** *Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.* | **Po** UAMD përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit në bashkëpunim me ASCAL.<br><br>Llojet e akreditimit, afatet dhe procedurat shprehen qartësisht në pjesën gjashtë të rregullores për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.[875] UAMD ju nënshtrua në vitin 2016 procesit të Akreditimit Institucional dhe u vlerësua me një Akreditim për 5 vite akademike ndërkohë që i është nënshtruar Akreditimit të Ri institucional edhe gjatë vitit akademik 2020-2021. Fakulteti i Biznesit harton raportet e vlerësimeve, të kryera nga njësia për sigurimin e brendshëm të cilësisë të cilat përdoren si burim për vlerësimin e jashtëm dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë[876]<br><br>Programi i studimit Master Profesional GTSH, nuk i është nënshtruar akreditimeve të mëparshme, mbasi është hapur për herë të parë në vitin akademik 2018-2019. Kjo është hera e parë që aplikohet për procesin e vlerësimit të cilësisë dhe akreditimin e këtij programi studimi. [877] |
| ***Kriteri 4.*** *Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin e gjëndjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.* | **PO.** Në fund të çdo semestri javën e 13 dhe javën e 14 Drejtoria e Kurrikulave dhe Standardeve të Cilësisë organizon anketimin nga studentët mbi stafin akademik.<br>Njësia e sigurimit të cilësisë vlerëson,periodikisht,rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore. NjSBC realizon pyetësorin studentor për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi. Sigurimi i brëndshëm i cilësisë është vlerësimi dhe garantimi i cilësisë së ushtrimit të veprimtarisë akademike, administrative dhe financiare të institucionit. Sistemi i brëndshëm i sigurimit të cilësisë mbështetet në garantimin e transparencës, në vlerësimin dhe rritjen e përdorimit të metodave bashkëkohore të mësimdhënies dhe të nxënit në promovimin e kulturës së rritjes së vazhdueshme, në respektimin e legjislacionit për arsimin e lartë dhe për kërkimin shkencor.<br>Në funksion të sigurimit dhe përmirësimit të cilësisë së programeve të studimeve që ofron UAMD dhe strukturat e saj si NjBSC; Komisioni i Përhershëm i Sigurimit të Cilësisë dhe Koordinatorët e programeve përgatisin raporte periodike (3-mujorë, 6-mujorë dhe vjetorë) të |

[873] *Aneks 8 Rregullore e Sistemit të Brendshëm të Cilësisë UAMD, pjesa e tretë "Misioni, Funksionet dhe Roli i NJSBC, neni 9 "Roli dhe funksionet e NJSBC", pika 1/a*

[874] *Aneksi 115 Komisioni për Vlerësimin e Brendshëm të Cilësisë në Fakultetin e Biznesit*

[875] *Aneks 8 Rregullore për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, Pjesa gjashtë nenet 17, 19*

[876] *Aneks 37 Raport vjetor per monitorimin dhe sigurimin e cilesisëFB*

[877] *Aneks 57 Vendimi i MASR për hapjen e programit te studimit MP GTSH+Vendim Senaati mbi riorganizimin nën 20% te programit+Miratim i ministrise per riorganizimin*

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | vetëvlerësimit të cilët i propozohen Senatit Akademik për miratim. Gjithashtu DKSC realizon Raportin e vetëvlerësimit për çdo vit akademik.<br>NjBSC monitoron dhe vlerëson procedurat dhe standardet e fakulteteve dhe njësive të tjera të institucionit, sipas sistemit dhe mekanizmit të krijuar, duke analizuar dhe krahasuar rezultatet në bazë të treguesve të cilësisë, në bazë të kritereve dhe standardeve të paracaktuara në Kodin e Cilësisë dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore.[878] | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | X |
| | | | | |

| **Standardi VI.3**<br><br>**Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| ***Kriteri 1.*** *Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.*<br><br>*Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.* | **PO**. UAMD bazuar në rregulloret përkatëse, ka përcaktuar metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve. Në mënyrë të herëpashershme institucioni përdor mekanizma përmes të cilave mbikqyr programet e studimit.[879],[880],[881]<br>Me një sistem të sigurimit të cilësisë (dhe modelet e cilësisë në përgjithësi), UAMD përcakton marrëveshjet e saj, direktivat e zhvillimit, objektivat dhe fushat e përmirësimit dhe përcakton gjithashtu proceset e saj kryesore të sigurimit të cilësisë. Ky proces i brendshëm i cilësisë përbëhet nga një procedurë ku zhvillohen aktivitete të rregullta monitoruese dhe përmirësuese. Në funksion të sigurimit dhe përmirësimit të cilësisë së programeve të studimeve që ofron UAMD dhe strukturat e saj si NjBSC.<br>Sigurimin e cilësisë së programeve UAMD e ka realizuar nëpërmjet monitorimeve të përvitshme dhe publikimit të raporteve të analizës mësimore të cilat përfshijnë në pjesë të tyre dhe raporte për sigurimin e cilësisë[882;883;884]<br>Përveç monitorimit të rregullt (çdo vit dhe pjesërisht edhe çdo |

[878] *Aneks 8 Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë neni 9*
[879] *Aneks 2 Statuti i UAMD, kreu VII "Sigurimi i Cilësisë" nenet në vazhdim.*
[880] *Aneks 8 Rregullore e Sistemit të Brendshëm të Cilësisë UAMD Pjesa Gjashtë nenet 9 e ne vazhdim*
[881] *Aneks 6 Rregullore e Fakultetit të Biznesit*
[882] *Aneks 37 Raport vjetor për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë FB*
[883] *Aneks 38 Analiza vjetore e vitit akademik 2021-2022, Departamenti Turizmit*
[884] *Aneks 40 Formati i pyetësorit për pedagogët nga studentët*

| | |
|---|---|
